



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË



RAPORT VJETOR

Gjendja e Sektorit të Energjisë dhe Veprimtaria e ERE-s gjatë Vitit 2011

Fjala e Kryetarit

Në ditët e sotme, sektori energjetik është një nga sektorët më të rëndësishëm me një ndikim të drejtpërdrejt në jetën e çdo qytetari dhe biznesi në kuadër të zhvillimit ekonomik dhe social të vendit.

Objektivi kryesor i një enti publik si Enti Rregullator i Energjisë, është sigurimi i furnizimit me cilësi, të qëndrueshëm me kosto të arsyeshme për konsumatorët shqiptarë, që respekton edhe politikat mjedisore në vend. Me qëllim arritjen e këtij objektivi, institucioni ynë në veprimtarinë e tij është bazuar edhe këtë vit sikurse edhe më parë në krijimin dhe zhvillimin e një tregu kompetitiv, financiarisht të fortë dhe transparent për të siguruar rregullimin dhe mbikëqyrjen e këtij tregu. Në ushtrimin e përgjegjësisë së tij ky ent në përputhje me ligjin nr.9072 datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar, dhe ligjit nr .9946 datë 30.06.2008 “Për sektorin e gazit natyror”, ka synuar ekuilibrimin e interesave të konsumatorëve të energjisë elektrike, investitorëve dhe shtetit duke marrë në konsideratë edhe politikën e qeverisë shqiptare për furnizimin pa ndërprerje me energji elektrike të konsumatorëve shqiptarë.

Ky raport, përveç informacionit të detajuar lidhur me veprimtarinë e ERE-s për rregullimin e sektorit të energjisë jep një vështrim të përgjithshëm të këtij sektori në Republikën e Shqipërisë duke përfshirë edhe informacion mbi zhvillimet më të fundit, sfidat e sektorit të energjisë në mënyrë të veçantë pas privatizimit të sektorit të shpërndarjes së energjisë elektrike, rikonfigurimit të tregut, si dhe ndarjes financiare dhe funksionale të aktiviteteve të gjenerimit, transmetimit dhe shpërndarjes.

Gjate vitit 2011 u shënua gjithashtu një progres i rëndësishëm në një nga shtyllat kryesore të veprimtarisë së rregullatorit, atë të mbrojtjes së konsumatorëve duke përcaktuar për herë të parë rregulla për Standardet Minimale të Cilësisë së Shërbimit të Shpërndarjes dhe Shitjes së Energjisë Elektrike.

Viti 2011, shënoi hapa të rëndësishëm në kuadër të angazhimeve të vendit në kuadër të traktatit të Komunitetit të Energjisë për Vendet e Evropës Juglindore sidomos lidhur me liberalizimin e tregut të kapaciteteve të energjisë elektrike dhe orientimin e tij drejt kompeticionit të pjesëmarrësve të tregut në ankandet e alokimit të kapaciteteve të interkonjeksionit.

Me mjaft rëndësi është edhe liberalizimi i tregut të furnizimit me pakicë të energjisë elektrike i reflektuar në ndryshimet në fund të vitit të Ligjit nr.9072 datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”. Përmes ndryshimeve në këtë ligj, të gjithë konsumatorët të lidhur në Tension të Lartë (110 kV e lart) dhe ato me një konsum mbi 50 milion kWh në vit, do të furnizohen nga furnizuesit e kualifikuar të licencuar nga ERE.

Me qëllim rritjen e sigurisë së furnizimit dhe në kuadër të një klime promovuese të Qeverisë Shqiptare për investime të reja në sektor, ERE ka kryer licencimin e shoqërive vendase dhe të huaja mbështetur në kritere dhe procedura që sigurojnë trajtim të barabartë, transparent dhe në kohë të të gjithë investitorëve në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në sektorin e gazit natyror ERE në paralel me zhvillimet rajonale dhe Evropiane të këtij sektori me rëndësi edhe për Shqipërinë, ka punuar në drejtim të vendosjes së rregullave të qarta, transparente të kuadrit rregullator të nevojshëm për realizimin e projekteve konkrete të furnizimit dhe diversifikimit me gaz të vendit dhe të rajonit. Në mënyrë të veçantë është punuar lidhur me projektin TAP si një nga mundësitë për furnizimin me gaz të ekonomisë së vendit dhe lidhjen e vendit tonë me rrjetin rajonal të gazit, i cili ka si synim final minimizimin e kostove të energjisë për konsumatorët shqiptare.

Në realizimin dhe kryerjen e detyrave dhe përgjegjësive më të cilat ligji ngarkon këtë institucion, ERE është asistuar në mënyrë të vazhdueshme edhe gjatë këtij viti nga institucionet ndërkombëtare, në mënyrë të veçantë Sekretariati i Komunitetit të Energjisë dhe USAID, ndihma e të cilëve ka konsistuar në mbështetjen institucionale në përballimin e sfidave të zhvillimit të sektorit dhe forcimin e kapaciteteve institucionale.

Me besimin se raporte të tilla shërbejnë jo vetëm për të dhënë një pasqyrë të situatës aktuale të sektorit, por edhe për të mundësuar njohjen me politikat dhe vizionet përgjegjëse për sektorin e energjisë, shpresojmë se ky raport do të jetë i dobishëm për publikun dhe të gjithë palët e interesuara.

Sinqerisht,

Sokol Ramadani

Adresa:Rruga “Gjergj Fishta”10
Tirane
E-mail erealb@ere.gov.al

3 /175

Tel/Fax +355 42 22 963
Tel +355 42 69 590
www.ere.gov.al

Përmbajtja e Lëndës

HYRJE.....	12
PJESA I	17
Kapitulli I	17
Rregullimi në Tregun e Energjisë Elektrike	17
1. Tregu i Energjisë Elektrike	18
2. Prodhimi i Energjisë Elektrike	21
2.1 Prodhimi Publik i Energjisë Elektrike.....	21
2.2 Mbi Kriteret e Shfrytëzimit të Rezervës Hidroenergjetike në Kaskadën e Lumit Drin.....	28
2.3 Prodhimi i Energjisë Elektrike nga TEC-i i Vlorës.....	31
2.4 Prodhimi nga HEC-et Private të Energjisë Elektrike	32
2.5 Efiçenca e Prodhimit të Energjisë Elektrike	39
3. Konsumi i Energjisë Elektrike	42
3.1 Kërkesa për Energji Elektrike	42
3.2 Struktura e Konsumit të Energjisë Elektrike	47
3.3 Profili i Konsumit të Energjisë Elektrike	51
3.4 Importi i energjisë elektrike.	53
3.5 Efiçenca e Konsumit të Energjisë Elektrike.	58
4. Operatori i Sistemit të Transmetimit	63
4.1 Projektet kryesore të përfunduara gjatë vitit 2011	64
5. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes	69
5.1 Struktura e Sistemit të Shpërndarjes	70
PJESA II	72
Kapitulli I	72
Rregullimi i Sektorit të Gazit Natyror	72

1.	Prioritetet e ERE-se për Sektorin e Gazit Natyror gjate Vitit 2011	73
2.	Përmbledhje e Shkurtër e Zhvillimeve me të Rëndësishme ne lidhje me Projektet e Gazit Natyror .73	
2.1	Zhvillime Specifike të TAP gjate 2011	75
2.2	Trajtimi nga ERE i Aplikimit të Paraqitur prej Kompanisë TAP-AG për Përjashtim prej të Drejtës së Hyrjes së Palëve të Treta të Projektit TAP	75
2.3	Vështirësitë e Hasura në Koordinimin e Përpjekjeve për Trajtimin e Aplikimit të TAP, prej Autoriteteve Përkatëse të Vendeve që Përshkohen prej Projektit TAP.	77
3.	Kontributi i ERE-së në Grupin e Punës për Gazin të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë	78
	PJESA III	79
	Kapitulli I	79
	Aktiviteti i Entit Rregullator te Energjise.....	79
1.	Çmimet dhe Tarifat e Energjise.....	80
1.1	Çmimet dhe Tarifat e Energjisë Elektrike për periudhen 2012-2014	80
1.1.1	Metodologjite dhe Procedurat e Percaktimit te Çmimeve e Tarifave.....	81
1.1.1.1	Tarifa e Prodhimit të Energjise Elektrike për KESH sh.a.	81
1.1.1.2	Tarifa e Prodhimit të Energjisë Elektrike për Periudhën 2012-2014 për “HEC Ulez Shkopet” sh.a.; “HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2”sh.a. “HEC Lanabregas”sh.a.....	82
1.1.2	Tarifa e Shërbimit të Shitjes me Shumice të Energjise Elektrike nga Furnizuesi Publik me Shumicë.	82
1.1.3	Çmimi i Energjise Elektrike per HEC-et Ekzistues deri ne 10 MË	83
1.1.4	Çmimi i Energjise Elektrike per HEC-et e rinj deri 15 MË.....	84
1.1.5	Tarifa e Shërbimit të Transmetimit të Energjisë Elektrike	85
1.1.6	Tarifa e Shërbimit të Shpërndarjes dhe e Furnizimit me Pakicë të Energjisë Elektrike për Konsumatorët Fundorë për Periudhën 2012-2014.....	85
1.2	Shqyrtimi i Studimit mbi Nivelin e Borxhit të Keq në Arkëtimet e Faturave të Energjisë Elektrike....	89
1.3	Çmimet dhe Tarifat e Energjisë Elektrike në Vendet e Rajonit, viti 2011.....	92

Kapitulli II	94
Licensimi dhe Monitorimi i Veprimtarive në Tregun e Energjisë Elektrike.....	94
1.1 Liçensimet në Veprimtarinë e Prodhimit të Energjisë Elektrike gjatë Vitit 2011.....	96
1.2 Licensimi në Aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike	98
1.3 Liçensimi në Aktivitetin e Furnizuesve të Kualifikuar të Energjisë Elektrike.....	99
1. Monitorimi i Tregut të Energjisë Elektrike	101
2.1 Parimet e Monitorimit të Tregut të Energjisë Elektrike.....	101
2.2 Monitorimi i KESH Sh.a.	104
2.3 Monitorimi i OST Sh.a.	104
2.4 Monitorimi i CEZ Shpërndarje Sh.a.	104
Kapitulli III	106
Aktiviteti i ERE në Zhvillimin e Legjislacionit Sekondar dhe ndryshimet e tjera ligjore të ndodhura gjatë vitit 2011	106
1. Aktet Nënligjore të Miratuara nga ERE	108
1.1 Rregullat dhe Proçedurat e Shitjes së Energjisë Elektrike.....	108
1.2 Udhëzuesi për Aplikimin dhe Tarifat e Lidhjes së Re apo Modifikimit të Lidhjes Ekzistuese në Rrjetin Elektrik të OST.....	109
1.3 Rregullat për Alokimin e Kapaciteteve të Interkonjeksioneve.....	110
1.4 Metodologjia e Llogaritjes dhe Faturimit të Dëmit Ekonomik.....	111
1.5 Miratimi i Kontratës TIP për Shërbimin e Verifikimit, Kontrollit Fillestar dhe Periodik të Matësave të Energjisë Elektrike.....	112
1.6 Rishikimi i Kontratës së Furnizimit me Energji Elektrike të Klientëve Tariforë	113
1.7 Rregullorja për Standartet Minimale të Cilësisë së Shërbimit të Shpërndarjes dhe Shitjes së Energjisë Elektrike.	114
1.8 Rishikimi i Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike.	115
1.9 Rishikimi i Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s, të miratuara me vendimin nr. 21, datë 18.03.2009, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s	115

1.10	Për disa ndryshime në Rregulloren për Organizimin dhe Funkcionimin e Brëndshëm të Entit Rregullator të Energjisë.....	116
1.11	Rregullorja për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë ose të Pjesshëm, Heqjen dhe Rinovimin e Liçensave në Sektorin e Gazit Natyror.	116
1.	Aktet e Rregullatorit në Kuadërtë Tregut të Energjisë Elektrike.....	117
2.1	Kontrata për Furnizimin me Energji Elektrike ndërmjet Shoqërisë KESH sh.a (Furnizuesi Publik me Shumicë) dhe Shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a (Furnizuesit Publik me Pakicë) për periudhën 01.01.2011 deri më 31.12.2011, vendim nr. 31, datë 31.03.2011	117
2.2	Marrëveshja e Transmetimit të Energjisë Elektrike midis OST sh.a dhe CEZ Shpërndarje sh.a.....	118
2.3	Kontrata e Negociuar nga Shoqëria CEZ Shpërndarje sh.a për Prokurimin e Energjisë Elektrike për Mbulimin e Humbjeve në Sistemin e Shpërndarjes për vitin 2012.	118
2.4	Mbi Dhënien e Statusit të Klientit të Kualifikuar.....	119
2.	Amendimet në Legjislacionin Primar në Sektorin e Energjisë Elektrike	120
3.	Trajtimi i Proçeseve Gjyqësore	122
	Kapitulli IV	124
	Veprimtaria e ERE në fushën e Mbrojtjes së Konsumatorit	124
1.	Trajtimin dhe Zgjidhjen e Ankesave të Konsumatoreve	125
2.	Proçesi i Miratimit të Kontratës së Furnizimit të Klientëve Tarifore dhe Rregullores për Standardet Minimale të Shërbimit të Shpërndarjes dhe Furnizimit të Energjisë Elektrike.....	131
3.	Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve midis të Licensuarve	132
4.	Seancat Dëgjimore	133
5.	Monitorimi në vend i problematikave	133
6.	Mbrojtja Konsumatore në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjise	134
7.	Marrëdhëniet me Publikun.....	135
7.1	Proçedurat e Informimit Publik.....	135
7.2	Komunikimi nëpërmjet ngjarjeve dhe aktiviteteve	135
7.3	Komunikime me Pjesëtarët e Tregut	136

7.4	Komunikime ne Web.....	136
7.5	Marrëdhëniet me Median e Shkruar dhe Vizive.....	137
	Kapitulli V.....	138
	Marrëdhëniet Ndërinstitucionale dhe Ndërkombëtare të ERE-s	138
	Kapitulli V	Error! Bookmark not defined.
	Marrëdhëniet Ndërinstitucionale dhe Ndërkombëtare të ERE-s	Error! Bookmark not defined.
1.	Veprimtaria Ndërinstitucionale dhe Ndërkombëtare e ERE-s	139
2.	Marrëdhëniet e ERE-s me Kuvendin e Shqipërisë.....	139
3.	Marrëdhëniet e ERE-s me METE-n.....	140
4.	Marrëdhëniet e ERE-s me Ministrinë e Integritetit.....	141
5.	Marrëdhëniet e ERE-s me Autoritetin e Konkurrencës	141
6.	Marrëdhëniet e ERE-s me Avokatin e Popullit.....	142
7.	Marrëdhëniet Ndërkombëtare	142
8.	Aplikimi i ERE-s në Projektin IPA:	143
9.	Marrëdhëniet Multilaterale te ERE-s:.....	144
10.	Marrëdhëniet Bilaterale te ERE-s.....	145
11.	Pjesëmarrja në Konferenca dhe Aktivitete Ndërkombëtare	145
	Kapitulli VI	146
	Administrimi i Burimeve Financiare dhe Burimeve Njerëzore të ERE-s	146
1.	Administrimi i Burimeve Financiare të ERE-s.....	148
	PJESA IV	150
	Kapitulli I	150
	Raporti i Auditimit nga Eksperti Kontabël për Vitin 2011	150
	Shtojca 1 Rregjistri i Vendimeve të ERE-s për Vitin 2011	156
	Shtojca 2 Rregjistri i Licensave	168

Treguesi i Figurave

Figure 1 Struktura e Modelit Shqiptar të Tregut	19
Figure 2 Skema e Sistemi Elektroenergjitik	20
Figure 3 Prodhimi Energjisë Elektrike gjatë Vitit 2011, si dhe krahasimi i tij me periudhën 2007-2011	23
Figure 4 Prodhimi i Energjisë Elektrike ne Shqipëri 1985 - 2011	24
Figure 5 Historiku i Prodhimit të Energjisë Elektrike nga H/C-et E Kaskadës së Drinit	26
Figure 6 Prodhimi nga H/C-et 2005-2011	26
Figure 7 Orët e Punës në H/C-et e Kaskadës së Drinit	27
Figure 8 Niveli i liqenit të H/C Fierza në fund të çdo muaji të vitit 2011, prurjet ditore në m3/sek	28
Figure 9 Sasia e ujit nga prurjet në liqenin e H/C Fierza gjatë vitit 2011, Prurjet Mesatare mujore 1948-2011	29
Figure 10 Rezerva energjetike në Kaskadën e Drinit në fund të muajve 2011	30
Figure 11 Prodhimi bruto nga TEC-Vlora 2011	31
Figure 12 Ecuria e Prodhimit nga HEC-et e vegjël të dhënë me koncesion dhe private	34
Figure 13 Të ardhurat nga shitja e energjisë elektrike	34
Figure 14 Çmimeve e HEC-eve private, me Koncesion dhe koncesionet e reja	36
Figure 15 Prodhimi nga impiantet prodhuese private dhe me koncesion gjatë vitit 2011	38
Figure 16 Shkarkimet e Ujit nga H/C-et e Kaskadës së Drinit (2002-2011)	40
Figure 17 Energji e shitur me cmime tregu dhe eksportuar gjatë vitit 2011	41
Figure 18 Konsumi i përgjithshëm në vite	43
Figure 19 Konsumi i energjisë elektrike 2007-2011 (<i>Burimi ERE</i>)	44
Figure 20 Bilanci Energjitik viti 2011 (<i>Burimi ERE, OST, KESH, CEZ</i>)	44
Figure 21 Piku i ngarkesës gjatë muajve të vitit 2011	45
Figure 22 Prodhimi, Importi dhe Kërkesa 2011	45
Figure 23 Prodhimi, Importi dhe Konsumi 2002-2011	46
Figure 24	47
Figure 25 Energjia disponibël në rrjetin e OSSH gjatë vitit 2011	48
Figure 26 Konsumi i Energjisë sipas Tensioneve	49
Figure 27 Konsumi familjar kundrejt konsumit total në vite	50
Figure 28 Grafikët ditor me ngarkesën maksimale dhe minimale të vitit 2011	51
Figure 29 Grafiku i ngarkesave mesatare mujore gjatë vitit 2011	52
Figure 30 Bilanci Imp/Eksp i energjisë elektrike në vite	53

Figurë 31 Importi Energjisë Elektrike (në hyrje) 2007-2011	54
Figurë 32 Ecuria e treguesve të prodhimit vendas dhe importit të energjisë elektrike gjatë viteve 2002 – 2011	55
Figurë 33 Ecuria e importeve të energjisë elektrike gjatë viteve 2002-2011	56
Figurë 34 Çmimet e importit të energjisë elektrike gjatë viteve 2002 – 2011.	56
Figurë 35 Grafiku i vlerës së importit	57
Figurë 36 Arkëtimet, Humbjet dhe Efektiviteti i shitjes 2011.....	58
Figurë 37 Ecuria e humbjeve në sistemin e shpërndarjes	59
Figurë 38 Humbjet totale kundrejt energjisë së futur në rrjet	60
Figurë 39 Faturimi/Arkëtimi 2002-2011	61
Figurë 40 Ecuria e furnizimit me energji elektrike përkundrejt ndalesave të energjisë për periudhën 2002-2011	62
Figurë 41 Struktura e Sistemit të Transmetimit Shqiptar	68
Figure 42 Çmimet e miratuara nga ERE për periudhën 2008-2014	89
Figure 43 Çmimet e energjisë elektrike të konsumatorëve jo familjarë në vendet e rajonit	92
Figure 44 Çmimet e energjisë elektrike të konsumatorëve familjarë në vendet e rajonit	93

Treguesi i Tabelave

Table 1 Struktura e Centraleve Elektrike të Prodhimit Publik	21
Table 2 Sasitë e prodhuara nga secili hidrocentral	25
Table 3 Koha e punës vjetore për çdo agregat të secilit central.....	27
Table 4 Prodhimi i Energjisë Elektrike nga Subjektet Private/Koncesion për vitin 2011	33
Table 5 Prodhimi nga impjantet prodhuese private dhe me koncesion gjatë vitit 2011 (Burimi ERE).....	37
Table 6	40
Table 7 Eksporti i energjisë elektrike për vitin 2011	41
Table 8 Energjia Elektrike aktive/reaktive e shitur 2011	48
Table 9 Ndarja Administrative e Rrjetit të Shpërndarjes	70
Table 10 Te dhenat mbi Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes	71
Tabela 11 Tarifat e shërbimeve dhe të shitjeve me pakicë të energjisë elektrike për vitet 2012-2014.....	88
Tabela 12 Liçensimet e kryera, sipas aktiviteteve	95
Tabela 13 Të Liçensuarit në aktivitetin e Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Kontratat e Konçensionit gjatë 2011	96
Tabela 14 Të liçensuarit në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike për vitin 2011	98

Tabela 15 Furnizuesit e kualifikuar të energjisë elektrike të liçensuar gjatë vitit 2011	99
Tabela 16 Impiantet e kualifikuara si burime të rinovueshme energjie gjatë vitit 2011	100
Tabela 17 Modifikimi i Liçensave	101
Table 18 Pasqyra e ankesave për vitin 2011 dhe mënyra e trajtimit të tyre nga ERE	130
Table 19 Rregjistri i vendimeve te ERE-s per vitin 2011	156
Table 20 Rregjistri i Licensave	168

HYRJE

Enti Rregullator i Energjisë (ERE), është një ent publik i cili funksionon në mbështetje të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, dhe ligjit nr.9946, datë 30.06.2008 “Për Sektorin e Gazit Natyror”. Në përputhje me këtë kuadër ligjor ERE funksionon si një person juridik publik me seli në Tiranë i përbërë nga Bordi i Komisionerëve dhe stafi teknik. Bordi i Komisionerëve emërohet nga Kuvendi i Shqipërisë dhe është organi vendim-marrës i institucionit. Në përputhje me këtë ligj, ERE ka përgjegjësinë për të raportuar rregullisht brenda datës 31 mars të vitit përkatës mbi analizën e gjendjes së sektorit të energjisë dhe veprimtarinë e ERE-s për vitin paraardhës.

Veprimtaria e ERE-s si një institucion i pavarur në sektorin e energjisë konsiston në keto drejtime kryesore:

- Në licensimin e shoqërive që kryejnë veprimtari në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror.
- Në përcaktimin e tarifave të shitjes me pakicë ose me shumicë të energjisë elektrike si dhe të tarifave për lidhjen dhe hyrjen në rrjetet e gazit natyror dhe të hapësirave të depozitimit apo të instalimeve të gazit natyror të lëngët.
- Në mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në sektorët e energjisë elektrike dhe të gazit natyror.
- Në monitorimin dhe kontrollin e kontratave dhe shërbimeve të të licensuarve dhe sigurisë së furnizimit në sektorët e energjisë.
- Në miratimin e kodeve të funksionimit të rrjeteve dhe të matjes si dhe të rregulloreve apo akteve të tjera nënligjore në sektorët e energjisë.
- Në nxitjen e efijencës, konkurrencës dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit në sektorët e energjisë.

I. Struktura organizative e ERE-s

ERE për përmbushjen me kompetencë dhe përgjegjshmëri të detyrave dhe funksioneve të parashikuara në ligj është e organizuar në tre njësi themelore:

- a- Bordi i Komisionerëve
- b- Stafi teknik
- c- Stafi mbështetës

Struktura aktuale organizative e ERE-s reflekton vendimin e Kuvendit të Shqipërisë Nr. 181 datë 5.5.2008.

Struktura organizative dhe kompetencat e ERE-s janë të ngjashme dhe me ato të institucioneve rregullatore homologe të vendeve të rajonit dhe më gjerë. Gjithsesi, vlen të theksohet nevoja për plotësimin dhe rritjen e numrit të stafit të ERE-s, me qëllim përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësisve që janë gjithmonë në rritje në kuadër të zhvillimeve në sektorin e energjisë, si dhe konkretisht në tregun e energjisë elektrike dhe gazit natyror, forcimit të rolit të rregullatorit në drejtim të monitorimit të të licencuarve, standardeve të shërbimit që ato ofrojnë si dhe në kuadër të realizimit të angazhimeve të vendit tonë me synim final integrimin në Bashkimin Evropian.

II. Bordi i Komisionerëve

Në strukturën e Bordit të Komisionerëve bëjnë pjesë Kryetari dhe 4 anëtarë, të cilët emërohen nga Kuvendi i Shqipërisë me një mandat 5 vjeçar. Bordi i Komisionerëve të ERE-s është njësia vendim-marëse për të gjitha veprimtaritë e rregulluara në tregun e energjisë elektrike dhe gazit natyror.

Bordi shprehet në trajtimin e gjithë problematikës që trajton, me vendime, të cilat merren në mbledhje të hapura për publikun. Njoftimi për ditën dhe orën e mbledhjes bëhet në faqen e internetit dhe në tabelën e njoftimeve të ERE-s. Mbledhjet e Bordit regjistrohen në audio.

Komisionerë	5
Staf teknik dhe mbështetës	27

Gjatë vitit 2011 Bordi i Komisionerëve ka zhvilluar 44 mbledhje formale, në të cilat janë marrë 162 vendime. Veç mbledhjeve formale Bordi ka zhvilluar edhe takime informuese dhe konsultative çdo herë që ka qenë e nevojshme. Në shtojcat e këtij raporti janë paraqitur vendimet për çështjet kryesore të vendosura gjatë vitit 2011.

Stafi Teknik:

Në përbërjen e stafit teknik të ERE-s janë punësuar ekspertë me nivel arsimimi sipas fushave të paraqitura në tabelën më poshtë:

Nr.	Arsimimi në degët (Inxhinjeri, Ekonomik, Juridik)	Numri i Punonjësve
1	Studime Master	7
2	Studime Universitare	17

Stafi teknik është i organizuar në tre drejtori dhe një sektor:

1. Drejtoria e Çmimeve dhe Tarifave të Energjisë Elektrike, me 5 punonjës.
 2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit, me 7 punonjës.
 3. Drejtoria e Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, me 5 punonjës.
 4. Sektori i mardhënieve me jashtë me 1 punonjës.
- Gjithësej 18 punonjës.

Stafi mbështetës është i organizuar në Drejtorinë e Administratë-Financës dhe Burimeve Njerëzore me gjithësej 7 punonjës.


Të gjithë punonjësit zotërojnë gjuhën angleze dhe një pjesë e konsiderueshme të paktën edhe një gjuhë tjetër të huaj.

Nga 27 punonjës administrativo – teknik, 16 prej tyre ose, 55% janë femra. Në pozicionin vendim-marrës, femrat zënë 20% të vendim-marësve, ndërsa në pozicionet drejtuese ato zënë 50 %, të personelit drejtues. 3 nga punonjësit e ERE-s bëjnë pjesë në jetën akademike universitare si pedagogë të jashtëm.

I tërë personeli vendim-marrës i është nënshtruar trajnimeve në shkollat e specializuara europiane të rregullimit në fushën e energjisë. Të njëjtat parime janë respektuar edhe për personelin drejtues dhe punonjësit e tjerë, duke ndjekur të njëjtat shkolla, por me programe për nivele të ndryshme që nga fillestarët dhe deri te personeli më përvojë.

Financimet për kualifikimin dhe trajnimin e personelit pjesërisht janë mbuluar nga buxheti i ERE-s kurse pjesa tjetër është sponsorizuar nga shoqatat europiane dhe amerikane të rregullatorëve si ERRA, NARUK, MEDREG, me të cilët kemi marrëdhënie bashkëpunimi. E tërë baza logjistike e ERE-s është e ndërtuar sipas koncepteve dhe teknologjisë bashkëkohore, po kështu edhe mjediset e punës janë të pajisura dhe të ndërtuara në mënyrë që të krijojnë kushte optimale për realizimin e detyrave nga çdo punonjës.

Organograma e ERE-s



PJESA I

Kapitulli I

Rregullimi në Tregun e Energjisë Elektrike

1. Tregu i Energjisë Elektrike

Tregu i energjisë elektrike në Shqipëri funksionon në bazë të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike i miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.338, datë 09.03.2008, të ndryshuar. Ky model është hartuar në zbatim të Direktivave të Bashkimit Evropian për energjinë elektrike si dhe të kërkesave të Traktatit të Komunitetit të Energjisë të vendeve të Evropës Juglindore, për krijimin e Tregut Rajonal të Energjisë Elektrike.

Modeli Shqiptar i Tregut është konceptuar për të çuar përpara politikat e Qeverisë Shqiptare për reformimin e sistemit elektroenergjetik dhe veçanërisht për privatizimin e sektorit të shpërndarjes së energjisë elektrike në një periudhë afatshkurtër. Ai ka për qëllim gjithashtu të krijojë një treg të thjeshtë të rregulluar, transparent dhe të balancuar të energjisë elektrike, mbi bazën e kontratave dypalëshe.

Një parim i rëndësishëm i Modelit të Tregut, i cili mbron në mënyrë të drejtëpërdrejt klientët tariforë dhe rrit sigurinë e furnizimit të tyre me energji elektrike, është parimi i përdorimit të prodhimit të energjisë elektrike prej burimeve hidro në favor të klientëve tariforë. Ky parim është specifik për kushtet e Shqipërisë, ku mbi 95% e prodhimit vendas të energjisë elektrike realizohet nga HEC-et ekzistues me kosto shumë të ulët.

Objektiva të tjera të rëndësishme që synon të arrijë Modeli i Tregut janë edhe përmirësimi i eficiencës së energjisë si dhe qëndrueshmërisë financiare të sektorit elektroenergjetik nëpërmjet sigurimit të një shkalle të lartë informacioni tregu si dhe të një strukture të qartë për transaksionet e tregut elektroenergjetik.

Në figurën -1- është paraqitur bllok-skema e strukturës së tregut të energjisë elektrike.

Për të pasur një ide më të qartë grafike, mbi skemën parimore elektrike të furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve dhe kufijt e juridiksionit të secilës shoqëri publike që operon në sistemin elektroenergjetik të vendit tonë, KESH-Gen.sh.a, OST sh.a. dhe CEZ-Shpërndarje sh.a, (ose gjenerimi, transmetimi dhe Shpërndarja), në figurën -2- është paraqitur një skemë parimore ilustrative.




Figure 1 Struktura e Modelit Shqiptar të Tregut

(Burimi ERE)

SKEMA E SISTEMIT ELEKTRO-ENERGJITIK




Figure 2 Skema e Sistemi Elektroenergjitik

(Burimi ERE)

2. Prodhimi i Energjisë Elektrike

Prodhimi i energjisë elektrike realizohet nga shoqëria publike KESH Sh.a. me strukturën e saj KESH Gen dhe nga prodhuesit privat të cilët kanë privatizuar ose shfrytëzojnë centralele elektrike ekzistues si dhe nga subjektet që kanë nënshkruar marrëveshje konçensionare me Qeverinë për ndërtimin dhe shfrytëzimin e centraleve të rinj.

2.1 Prodhimi Publik i Energjisë Elektrike

Prodhimi publik i energjisë elektrike kryhet nga Shoqëria Aksionere KESH Sh.a. me 100% të aksioneve nga shteti si dhe nga Shoqëria “TEC-Vlora” gjithashtu me 100% të aksioneve nga shteti, e cila është pjesë e holdingut KESH.

Struktura e centraleve elektrike të prodhimit publik është paraqitur në Tabelën - 1- ku fuqia e përgjithshme e instaluar arrin në 1,531 MW, nga të cilat fuqia e instaluar e HEC-ve është 1,433 MW dhe e TEC-eve 98 MW. Duke marrë parasysh edhe fuqinë e përgjithshme të instaluar të prodhuesve privatë të energjisë

Table 1 Struktura e Centraleve Elektrike të Prodhimit Publik

Karakter. e Centralit	Centrali								
	HEC Fierz	HEC Koman	HEC V.Dejes	HEC Ulez	HEC Shkopet	HEC Bistr1	HEC Bistr2	HEC Lana-breg	TEC Vlore
Nr.Agregat.	4	4	5	4	2	3	1	2	2
Fuqia e Ag. MW	125	150	50	6.3	12	7.7	5	2.5	70+28
Fuqia Instaluar e centralit MW	500	600	250	25	24	24	5	5	98
Fuqia Totale MW	1,531								

(Burimi KESH sh.a.)


elektrike prej 42 MW, fuqia e përgjithshme e instaluar në vendin tonë rezulton 1573 MW. Në këtë vlerësim nuk është marrë në konsideratë TEC-i i Fierit, mbasi ai është hequr nga shfrytëzimi që në vitin 2008, si central me rendiment shumë të ulët.

Prodhimi publik i energjisë elektrike në vitin 2011 u realizua kryesisht, ose në masën 98.57 % nga centralet hidroelektrike (HEC-et) dhe vetëm 1.42 % nga TEC-i i Vlorës.

Gjatë vitit 2011 prodhimi i përgjithshëm neto i energjisë elektrike nga shoqëritë publike të gjenerimit ka qënë 4 021 245 Milion kWh, kurse prodhimi total që merr parasysh edhe prodhimin nga sektori privat i gjenerimit prej 136 831 Milion kWh arrin në 4 158 831 Milion kWh (4.158 TWh) figura -3-.

Viti 2011 nga pikpamja hidrologjike vlerësohet si një vit, me prurje me shkallë sigurie të ulët gjë që ka ndikuar jo pozitivisht në prodhimin e energjisë elektrike në vend, duke arritur prodhimin jo të lartë duke u nisur nga historiku i të gjitha kohrave në Shqipëri.

Në mënyrë grafike, ecuria e prodhimit të energjisë elektrike gjatë vitit 2011 si dhe krahasimi i tij me prodhimin e viteve 2007, 2008,2009 dhe 2010 është paraqitur në grafikun e figurës -3-






Figure 3 Prodhimi Energjisë Elektrike gjatë Vitit 2011, si dhe krahasimi i tij me periudhën 2007-2011

(Burimi OST)

Prodhimi ditor maksimal për vitin 2011, është shënuar në datën 25 Janar me 22 246 MWh. Ky prodhim është realizuar vetëm nga hidrocentralet në administrim të KESH sh.a., kapaciteti i instaluar i të cilëve është 1433 MW. Për këtë prodhim koha e shfrytëzimit me kapacitetin maksimal të instaluar, për çdo agregat në të gjithë HEC-et, rezulton rreth 12 orë në 24 orë pune ose një koeficient ngarkese mesatare.

Koha mesatare e shfrytëzimit të çdo agregati në H/C-et e kaskadës së Drinit gjatë vitit 2011 ka qënë 4 125 orë/vit nga 8 760 orë gjithsej në vitin. Natyrisht që agregatet janë vënë në punë në varësi të menaxhimit të rezervës ujore për të maksimizuar prodhimin.

Prodhimi ditor minimal gjatë vitit 2011, është realizuar në datën 25 Nëntor me 4 545 Milion kWh, ose 4.89 herë më pak se prodhimi ditor maksimal.

Në grafikun e figurës - 4 - është paraqitur prodhimi i energjisë elektrike në vendin tonë gjatë periudhës 1985 deri në 2011. Sikurse vihet re nga ky grafik, prodhimi i vitit 2011 është një prodhim jo i lartë.




Figure 4 Prodhimi i Energjisë Elektrike ne Shqipëri 1985 - 2011.

(Burimi KESH,OST)

Për periudhën 2007-2011, ERE ka evidentuar në mënyrë të detajuar të dhënat e prodhimit të energjisë elektrike për çdo ditë të secilit vit. Nga krahasimi i prodhimit të energjisë elektrike gjatë periudhës 2007 – 2011 vërehen ndryshime jashtëzakonisht të mëdha. Prodhimi më i ulët vjetor gjatë kësaj periudhe është ai i vitit 2007 me 2,918 milion kWh ose me një prodhim mesatar ditor prej 7.9 milion kWh. Ndërsa prodhimi më i madh është ai i vitit 2010 me 7,743.295 milion kWh ose me një prodhim mesatar ditor prej 21.2 milion kWh. Sikurse vihet re diferenca ndërmjet këtyre dy prodhimeve ekstremale arrin në 2.7 herë. Një tregues i tillë shpreh në mënyrë sinjifikative shkallën e lartë të riskut në stabilitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga sistemet elektroenergjetike të mbështetur vetëm në HEC-e.

Në këto kushte konsiderohet si i rëndësishëm realizimi i integritetit të dy sistemeve elektroenergjetike si sisteme komplementare, atij të Republikës së Shqipërisë, i bazuar pothuaj tërësisht në HEC-e dhe atij të Republikës së Kosovës i bazuar pothuaj tërësisht në TEC-e me qymyr. Është e rëndësishme të përmendet fakti se në këto sisteme kostot e prodhimit të energjisë elektrike janë nga më të ultat, çka e

bën me shumë interes për të dy vendet integrimin në një sistem unik energjetik mbas ndërtimit të linjës së interkoneksionit 400 kV Shqipëri-Kosovë.

Një analizë më e hollësishme për prodhimin publik të energjisë elektrike për vitin 2011 dhe për gjithë periudhën 2005-2011 konsiston në evidentimin e prodhimit dhe të kohës së punës për çdo agregat të hidrocentraleve të këtij sektori.

Table 2 Sasitë e prodhuara nga secili hidrocentral

Viti	Fierze	Koman	V.Dejes	Ulez	Shkopet	Bistrice-1	Bistrice-2
	Prodhimi TWh						
2005	1.86	2.187	0.927	0.121	0.058	--	--
2006	0.94	2.119	0.952	0.107	0.032	--	--
2007	0.69	1.199	0.630	0.071	0.034	--	--
2008	1.07	1.551	0.817	0.092	0.079	0.119	0.119
2009	1.54	2.000	1.082	0.126	0.102	0.137	0.137
2010	2.29	2.420	1.510	0.150	0.120	0.130	0.04
2011	1.238	1.602	0.815	0.07	0.058	0.126	0.028

Në tabelën -2- janë paraqitur sasitë e prodhuara nga secili hidrocentral, kurse në figurën -5- janë paraqitur grafikisht këto parametra për H/C-et e Kaskadës së Drinit.




Figure 5 Historiku i Prodimit të Energjisë Elektrike nga H/C-et E Kaskadës së Drinit




Figure 6 Prodimit nga H/C-et 2005-2011

(Burimi KESH sh.a)

Në figurën - 7- është paraqitur koha totale vjetore e punës së secilit HEC dhe në tabelën -3- është paraqitur në veçanti edhe koha e punës vjetore për çdo agregat të secilit central.

Një dukuri e rëndësishme në punën e hidrocentraleve të sistemit, ka qënë gadishmërija shumë e lartë e të gjithë agregateve të centraleve.

Është me rëndësi të theksohet se në sajë të kësaj gadishmërije është bërë e mundur që mos të derdhet asnjë pikë uji nga portat e centraleve pa ju marrë më parë energjia sidomos gjatë muajit Janar 2011.

Table 3 Koha e punës vjetore për çdo agregat të secilit central

Viti	Fierze	Koman	V.Dejes	Ulez	Shkopet	Bistrice-1	Bistrice-2
Ore Pune							
2005	18,580	16,261	19,556	21,324	6,141	18,060	8,300
Mesatare per agregat	4,645	4,065	3,911	5,331	3,070	6,020	8,300
2006	14,753	18,388	22,216	19,430	10,832	23,598	7,924
Mesatare per agregat	3,688	4,597	4,443	4,857	5,416	7,866	7,924
2007	8,435	10,826	15,385	14,430	7,036	25,757	1,584
Mesatare per agregat	2,108	2,706	3,077	3,607	3,518	8585	1,584
2008	11,312	13,477	20,681	17,323	8,606	22,887	5,042
Mesatare per agregat	2,828	3,369	4,136	4,330	4,303	7,629	5,042
2009	15,636	13,121	20,770	22,015	11,215	25,408	8,221
Mesatare per agregat	3,909	3,280	4,154	5,503	5,607	8,469	8,221
2010	21,994	20,735	33,676	26,411	13,519	25,668	8,004
Mesatare per agregat	5498	5,183	6,735	6,602	6,759	8,556	8,004
2011	13,063	17,169	19,257				
Mesatare per agregat	3,266	4,295	4,814				




Figure 7 Orët e Punës në H/C-et e Kaskadës së Drinit

(Burimi KESH sh.a)

2.2 Mbi Kriteret e Shfrytëzimit të Rezervës Hidroenergjetike në Kaskadën e Lumit Drin

Sikurse dihet HEC-i i Fierzës është një central me rregullim vjetor të prurjeve, çka ndikon drejtpërsëdrejti dhe në prodhimtarinë e HEC-eve të Komanit dhe të Vaut të Dejës të cilët furnizohen me ujë nga prurjet e rregulluara të HEC-it të Fierzës.

Në figurën -8- është paraqitur grafikisht për vitin 2011 niveli i ujit në metra, në rezervuarin e Fierzës si dhe prurjet ditore në m³/sek, të lumit Drin në këtë rezervuar. Gjithashtu në figurën -9- janë paraqitur për krahasim edhe nivelet ditore të 137 ujit dhe prurjet ditore për çdo vit të 137 periudhës 2007 – 2011.





Figure 8 Niveli i liqenit të H/C Fierza në fund të çdo muaji të vitit 2011, prurjet ditore në m³/sek





Figure 9 Sasia e ujit nga prurjet në liqenin e H/C Fierza gjatë vitit 2011, Prurjet Mesatare mujore 1948-2011

(Burimi OST sh.a)

Sikurse vihet re me lehtësi diferencat midis prurjeve të vitit 2011 me prurjet e viteve paraardhës janë shumë të ulta, çka e bën vitin 2011 një vit me prurje nga më të ultat historikisht.

Pavarësisht këtyre kushteve hidrologjike manaxhimi i nivelit të ujit në rezervuarin e Fierzës, është trajtuar me kujdes, në mënyrë që të absorbohej prej këtij baseni sasia maksimale e mundëshme e prurjeve sidomos gjatë muajit janar 2011.

Në grafikun e figurës -10- është paraqitur shfrytëzimi i rezervës hidroenergjetike gjatë vitit 2011.

Kriteret e përpunimit të rezervës hidroenergjetike janë pothuajse analoge edhe në vitet paraardhëse, ato janë mbështetur në tre parimet themelore të Rregullores së Shfrytëzimit të Digave, të cilat konsistojnë:

- Respektimin e kushteve të sigurisë së digave.
- Shfrytëzimin optimal të rezerves hidroenergjetike.
- Minimizimin e efekteve të përmytjes.




Figure 10 Rezerva energjetike në Kaskadën e Drinit në fund të muajve 2011

(Burimi OST sh.a)

Në mendimin inxhinerik, përsa i përket teorisë së rregullimit ditor dhe vjetor të prurjeve në një kaskadë, shërben si model bazë rregullimi, ai që mbështetet përgjithësisht në prurjet me shkallë siguriye ose probabilitet rreth 70%. Mbi këtë bazë ndërtohet modeli i përpunimit vjetor të rezervës hidroenergjetike në mënyrë të tillë që

të realizohet një shfrytëzim me efikasitet të lartë i kësaj rezerve, ose me fjalë të tjera të merret sasia maksimale e energjisë elektrike.

Marrja e vendimit nga ana e Qeverisë, që ndërtimi i HEC-it të Skavicës t'i shtohet burimeve publike të energjisë elektrike, është pa dyshim një nismë që do të ketë efektivitet jo vetëm në rritjen e prodhimit vendas të energjisë elektrike por edhe në absorbimin në një shkallë më të madhe të prurjeve në rrjedhën e sipërme të Drinit, çka do të ishte gjithashtu një faktor i ndjeshëm në rritjen e shkallës së sigurisë nga përmbajtjet.

2.3 Prodhimi i Energjisë Elektrike nga TEC-i i Vlorës

TEC Vlora ishte parashikuar të vihej në punë gjatë vitit 2011, por për shkak të problemeve teknike të konstatuara gjatë testeve u vonua futja plotësisht në punë me kapacitet të plotë i këtij burimi. Në grafikun e figurës-11- është paraqitur prodhimi i realizuar nga ky TEC për çdo ditë gjatë vitit 2011.

Gjatë kësaj periudhe TEC-i prodhoi 59.611 milion kWh energji elektrike.




Figure 11 Prodhimi bruto nga TEC-Vlora 2011

(Burimi KESH sh.a, OST sh.a)

Sikurse dihet, ky TEC është i projektuar dhe konstruktuar që të punojë dhe me gaz natyror, por aktualisht ka përdorur si lëndë djegëse naftë diesel, mbasi ende nuk është realizuar furnizimi i Shqipërisë me gaz natyror, për pasojë kostua e prodhimit të energjisë elektrike prej tij është shumë më e lartë se ajo e HEC-eve egzistues, mbasi cmimi i naftës në tregjet ndërkombëtare, sikurse dihet, është tepër i lartë. TEC-i i Vlorës ka të instaluar dy turbina nga të cilat njëra turbinë me gas dhe tjetra klasike me avull me presion të lartë dhe me prodhimtari, përkatësisht 70% dhe 30% të kapacitetit të përgjithshëm nga secili agregat.

2.4 Prodhimi nga HEC-et Private të Energjisë Elektrike

Struktura e prodhimit privat të energjisë elektrike është paraqitur në mënyrë të përmbledhur në tabelën -4-. Aktualisht janë në prodhim 58 hidrocentrale nga 26 shoqëri private dhe koncensionare, me fuqi të përgjithshme të instaluar prej 43.12 MW nga të cilat 17.25 MW janë shtuar gjatë vitit 2011. Prodhimi i përgjithshëm për vitin 2011 nga gjeneruesit privatë ishte 136.8 GWh ose 2.0 % e prodhimit të përgjithshëm të vitit 2011.

Në tabelën -4- është paraqitur prodhimi mujor i energjisë elektrike gjatë vitit 2011 nga 26 shoqëritë koncensionare dhe private që kanë në administrim ose pronësi 58 hidrocentrale me fuqi deri 15 MW.

Gjatë vitit 2011 u futën në shfrytëzim 6 HEC-e të rinj (“Ansara” Elbasan, “Faqekuq 1&2” Skrapar, “Gizavesh” Librazhd, “Stranik”, “Carshove” Permet, “Sasaj” Sarande) me fuqi të përgjithshme të instaluar prej 17.25 MW dhe një prodhim prej 10.674 GWh.

Prodhimi i përgjithshëm i energjisë elektrike nga HEC-et deri 15 MW nga 159.01 GWh që ishte në vitin 2010 gjatë vitit 2011 arriti në 136.8 GWh, ose pati një rënie prej 14% për shkak të situatës së pafavorshme hidrike.

Table 4 Prodhimi i Energjise Elektrike nga Subjektet Private/Koncesion per vitin 2011

Prodhimi i Energjise Elektrike nga Subjektet Private/Koncesion per vitin 2011 (MWh)		
Nr.	Subjektet	Sasia realizuar
1	Marjakaj sh.p.k	1,098
2	WTS Energji sh.p.k	671
3	Selce sh.p.k	1,098
4	Maksi Elektrik sh.p.k	756
5	Spahiu Gjanc sh.p.k	5,118
6	Wonder Power sh.a	4,771
7	Amal sh.p.k	1,153
8	EMIKEL sh.p.k	3,927
9	Favina sh.p.k	6,265
10	Juana sh.p.k	405
11	Sarolli sh.p.k	412
12	Projeksion Energji sh.a	1,026
13	Albanian Green Energy sh.p.k	31,042
14	Balkan Green Energy sh.p.k	36,870
15	HEC-i TERVOL-it	21,736
16	HIDRO ALBANIA ENERGY	2,669
17	Hec Bishnica 1,2 sh.p.k	6,282
18	DISHNICA ENERGI sh.p.k	499
19	ELEKTRO LUBONJA sh.p.k	229
20	ANSARA KONÇENSION sh.p.k	708
21	En.Ku sh.p.k	131
22	HP OSTROVICA ENERGY sh.p.k	5,874
23	DOSKU ENERGY sh.p.k	783
24	Hidroinvest 1 sh.p.k	839
25	ERMA MP sh.p.k	300
26	Energo Sas sh.p.k	2,170
	Totali Kontratave	136,832

(Burimi ERE)

Në grafikun e figurës -12- është paraqitur ecuria e prodhimit nga HEC-et e vegjël (deri 15 MW) gjatë periudhës 2004 – 2011. Duke marrë parasysh që prodhimi i rritur i vitit 2010 përveç rritjes së kapaciteteve të instaluar në një masë të madhe u ndikua nga kushtet shumë të favorshme hidrike, nga grafiku vihen re tempet e larta të rritjes së prodhimit nga HEC-et e dhënë me koncension mbas vitit 2008.




Figure 12 Ecuria e Prodhimit nga HEC-et e vegjël të dhënë me koncesion dhe private

(Burimi ERE)

Në grafikun e figurës -13- janë paraqitur të ardhurat e arkëtuara nga subjektet private për shitjen energjise elektrike të prodhuar nga HEC-et me fuqi deri 15 MW, e cila për vitin 2011 arriti në mbi 1.Miliard lekë.




Figure 13 Të ardhurat nga shitja e energjise elektrike

(Burimi KESH sh.a)

Në strategjinë e sektorit të energjisë, Qeveria Shqiptare ka përcaktuar si përparësi të saj, shfrytëzimin e potencialit të madh hidroenergetik të vendit ende të pashfrytëzuar. Për të nxitur nismën private për investime në ndërtimin e HEC-eve të rinj me koncesion, me fuqi deri në 15 MW, Qeveria ka autorizuar KESH sh.a. që të blejë të gjithë energjinë elektrike të prodhuar prej tyre, me cmim të miratuar nga ERE,

sipas një formule nxitëse e cila i referohet cmimeve mesatare të importit të energjisë elektrike plus një bonus 10%. Diferencimi në cmim ndërmjet HEC-eve private egzistues dhe atyre që ndërtohen të rinj është arsyetuar me ndryshimin e madh në vleftën e investimeve ndërmjet këtyre dy kategori objektsh.

Gjatë vitit 2010, për shkak se si cmimi i importit të energjisë ashtu edhe norma e këmbimit Eur/Lekë ka ardhur në rritje, cmimi i energjisë elektrike për HEC-et deri 15 MW me koncensionet e “reja” për vitin 2011 ishte 6.85 ose 14% më i lartë në krahasim me cmimin prej 6 lek/kWh të vitit 2010. Ndërkohë cmimi i vitit 2012 për HEC-et me koncensionet e reja, bazuar në metodologjinë që mbështetet mbi cmimet e importit të vitit parardhës rezultoi 9.3 leke/kWh ose 34.9% më i lartë se cmimi i vitit 2011.

Në vitin 2011 cmimi për HEC-et private/koncension egzistues për shkak të vlerësimit të cmimit sipas një metodologjie tjetër, u rrit në 7.57 lek/kWh nga 7.4 lek/kWh ose me 2.29% më shumë. Kjo diferencë në rritjen e cmimit midis këtyre dy grupeve vjen si rezultat i aplikimit të dy metodologjive të ndryshme: për HEC-et private/koncension të vjetër bazë e llogaritjes është cmimi mesatar për klientët tarifore për vitin përkatës ndërsa për HEC-et me koncensionet e reja bazë e llogaritjes është cmimi i importit dhe kursi i këmbimit për vitin paraardhës.

Në figurën -14- paraqitet ecurija e cmimeve të HEC-eve me kapacitet deri 15MW, gjatë periudhës 2004 deri 2012.




Figure 14 Çmimeve e HEC-eve private, me Konzension dhe koncesionet e reja

(Burimi ERE)

Nga grafiku i mesipërm vërehet se, ndërsa për cmimin e HEC-eve private/konzension të vjetër ka një tendencë të qëndrueshme në rritje, cmimi për HEC-et me konzension të dhënë pas vitit 2007 ka luhatur gjë që mund të frenojë iniciativën e investitorëve për të investuar në këtë sektor. Kjo ka sjellë nevojën e përcaktimit të një cmimi të unifikuar dhe të qëndrueshëm të paktën për një periudhë 10 vjecare të HEC-eve me kapacitet deri 15 MW, pavarësisht nga natyra e pronësisë.

Table 5 Prodhimi nga impjantet prodhuese private dhe me koncesion gjatë vitit 2011 (Burimi ERE)

PRODHIMI NGA IMPJANTET PRODHUESE PRIVATE DHE ME KONCESION GJATE VITIT 2011 (MWh)														
Totali i IPP-ve	159,040	16,468	14,249	15,773	14,909	21,220	14,045	6,639	4,506	3,462	5,988	4,653	14,919	136,832
HEC Bene (Shkodër)	586	186	118	171	252	144	100	0	0	0	0	0	126	1,098
HEC Tamarë (Koplik)	546	92	85	103	98	101	56	0	0	0	35	20	81	671
HEC Selcë (Koplik)	1,778	98	73	149	251	220	26	0	0	18	72	31	161	1,098
HEC 1& 2 Leskovik (Kolonjë)	996	114	110	96	126	94	90	44	0	0	0	46	35	756
HEC Gjanç (Korçë)	8,628	0	0	0	0	1,386	974	1,546	1,095	116	0	0	0	5,118
HEC Bogovë (Skrapar)	12,940	895	731	703	504	1,039	789	110	0	0	0	0	0	4,771
HEC Xhyrë (Librazhd)	1,445	234	152	150	156	164	138	90	32	36	0	0	0	1,153
HEC Lenije (Gramsh)	2,861	250	220	267	261	265	255	161	62	93	105	99	214	2,252
HEC Çorovodë (Skrapar)	553	0	83	100	100	100	90	43	0	0	0	0	60	576
HEC Tuçep (Bulqizë)	1,602	108	108	102	114	114	110	89	101	102	120	0	30	1,098
HEC Vitkuq 1 (Korçë)	5,202	542	467	1,024	1,150	958	441	140	137	58	141	115	1,093	6,265
HEC Orenj (Librazhd)	459	63	54	58	50	51	39	33	0	0	0	0	57	405
HEC Shpella (Pogradec)	589	27	67	60	58	54	43	35	12	6	0	18	32	412
HEC Rehovë (Kolonjë)	728	67	28	53	82	80	66	3	0	0	0	15	0	395
HEC Treskë 1 (Kolonjë)	787	107	88	91	92	91	63	34	0	0	0	30	35	631
HEC Çarshovë (Përmet)	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
HEC Smokthinë (Vlorë)	40,302	4,326	3,658	4,025	3,220	3,038	2,618	1,643	1,598	1,120	1,701	1,631	2,464	31,042
HEC Bulqizë-1 (Bulqizë)	830	121	102	124	136	139	120	93	80	69	71	65	121	1,241
HEC Homesh (Bulqizë)	1,001	100	82	72	61	52	36	8	6	19	14	23	37	510
HEC Zerqan (Bulqizë)	1,316	155	138	174	156	149	96	78	67	68	76	71	72	1,299
HEC Arras (Dibër)	12,584	1,376	1,480	1,520	1,704	1,736	752	184	40	256	592	400	1,744	11,784
HEC Lurë (Dibër)	934	236	212	65	0	39	0	0	0	30	109	0	59	750
HEC Orgjost (Kukës)	1,129	630	498	573	654	570	546	318	60	63	111	66	126	4,215
HEC Lekbibaj (Tropojë)	662	0	0	0	0	0	0	0	0	0	191	116	8	315
HEC Dukagjin (Shkodër)	1,741	92	130	139	174	180	168	182	182	132	172	154	124	1,829
HEC Marjan (Korçë)	530	36	35	35	37	38	38	37	26	10	7	7	28	334
HEC Lozhan (Korçë)	493	35	42	67	54	57	42	11	0	3	5	3	4	323
HEC Barmash (Kolonjë)	2,243	281	207	148	92	91	45	0	0	0	0	0	33	897
HEC Treskë 2 (Kolonjë)	222	115	113	127	105	125	66	15	0	0	0	0	21	687
HEC Nikolicë (Bilisht)	1,185	275	172	186	232	267	238	157	119	57	46	17	60	1,827
HEC Funarë (Librazhd)	5,803	718	625	486	591	585	449	9	0	101	300	279	528	4,671
HEC Lunik (Librazhd)	1,185	137	113	111	98	89	70	12	8	6	14	5	61	724
HEC Kërpicë (Gramsh)	1,148	88	71	76	73	77	78	67	60	49	44	48	60	792
HEC Ujanik (Skrapar)	2,149	178	89	133	150	146	116	69	16	6	21	5	13	943
HEC Borsh (Sarandë)	1,124	152	87	134	113	85	69	32	0	11	38	40	34	795
HEC Leshnicë (Sarandë)	537	118	99	88	77	54	25	13	9	9	12	10	29	541
HEC Velçan (Korçë)	5	26	155	174	70	84	264	116	58	78	84	42	176	1,327
HEC Sheshaj (Tropojë)	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
HEC Voskopoje (Korçë)	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
HEC Piqerras (Sarandë)	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
HEC Muhur (Dibër)	368	135	121	119	124	117	24	0	0	6	81	101	114	941
HEC Rajan (Kolonjë)	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	21	15	90	126
HEC Tuçep (Bulqizë)	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
HEC Bicaj (Kukës)	0	0	0	52	27	25	23	0	0	0	0	0	4	131
HEC Ansara (Elbasan)	0	512	40	44	40	49	0	0	0	0	23	0	0	708
HEC Tervol (Elbasan)	35,596	2,592	2,526	2,767	2,468	4,104	3,022	556	313	351	461	316	2,260	21,736
HEC Cermalev (Kukës)	3,065	320	273	297	267	301	296	232	182	159	174	170	0	2,669
HEC Bishnicë (Pogradec)	2,795	832	665	736	772	783	634	304	244	258	256	217	580	6,282
HEC Dishnicë (Korçë)	179	57	82	114	78	100	40	0	0	0	27	0	0	499
HEC Lubonje (Korçë)	215	42	48	60	42	37	0	0	0	0	0	0	0	229
HEC Faqekuq1&2 (Skrapar)	0	0	0	0	0	3,240	888	178	0	171	213	192	993	5,874
HEC Gizavesh (Librazhd)	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	524	128	131	783
HEC Stranik (Librazhd)	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	130	160	549	839
HEC Sasaj (Sarandë)	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2,170	2,170
HEC Çarshovë (Përmet)	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	300	300




Figure 15 Prodhimi nga impiantet prodhuese private dhe me koncension gjatë vitit 2011

2.5 Efienca e Prodhimit të Energjisë Elektrike

Karakteristikat e eficiencës së prodhimit të energjisë elektrike burojnë së pari nga natyra e burimeve gjeneruese. Në një sistem energjetik, si ky i yni, ku e gjithë energjia elektrike, ose në rastin e përgjithshëm, kur pjesa kryesore e saj, prodhohet nga hidrocentralet, është me rëndësi të evidentohen tiparet themelore të këtij sistemi prej nga rrjedhin më pas edhe përparësitë dhe të metat e tij.

Në analizën tonë janë marrë në konsideratë këto tipare themelore:

- aftësija e akumulimit të energjisë elektrike në formë rezerve potenciale hidroenergjetike,
- aftësija për rregullimin e prurjeve në mënyre vjetore.
- optimizimi i kombinimit të prodhimit me importin e energjisë elektrike.
- fleksibiliteti i lartë ndaj ngarkesës, cka i lejon të mbulojë lehtësisht pikun e ngarkesës,
- varësija e theksuar e prodhimit të energjisë elektrike nga kushtet hidrologjike të motit.
- Shkarkimet e ujit nga rezervuarët.
- Investime relativisht më të mëdha për ndërtimin e tyre dhe kohë më e gjatë për përfundimin dhe futjen e objektit në shfrytëzim në krahasim me TEC-et
- Shpenzime më të vogla shfrytëzimi dhe mirëmbajtje.

Bazuar në informacionet ditore për situatën elektroenergjetike në vend, ERE cdo ditë e ka ndjekur këtë situatë dhe e ka reflektuar atë grafikisht në mënyrë që të analizojë dhe të vlerësojë eficiencën e shfrytëzimit të kaskadës hidroenergjetike.

Në tabelën -6- paraqiten të dhëna krahasuese për cdo vit të periudhës 2002 – 2011 ndërmjet treguesve që ndikojnë drejtëpërsëdrejti në vlerësimin e eficiencës së prodhimit të energjisë elektrike.

Table 6

Emertimi	Viti									
	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011
Prodhimi (GWh)	3,204	4,974	5,467	5,409	5,516	2,933	3,770	5,201	7,702	4,158
Importi (GWh)	2,072	937	567	365	633	2,828	2,417	1,884	1,911	3,262
Çmimi mesatar i importit (Euro/MWh)	30.18	30.15	35.57	40.04	47.81	69.00	79.00	48.69	45.50	60.49
Vlera e Importit (000 Euro)	62.53	28.26	20.17	14.63	30.25	195.13	190.94	91.74	86.95	197.34
Furnizimi (GWh)	5,430	5,900	5,945	5,933	6,121	5,719	6,300	6,593	6,970	7,342
Sasia vjetore e Ujit (Miljard m ³)	4.44	5.8	7.81	6.74	6.52	4.11	4.12	6.00	10.85	5.839
Derdhjet vjetore te Ujit (Miljard m3)	0	0	0	0	0	0	0	0	1.96	0
Konsumi Specifik (m ³ /kWh)	1.38	1.17	1.43	1.25	1.18	1.4	1.04	1.19	1.20	1.47
Ndalesat e energjise (GWh)	960	662	556	664	412	891	200	0	0	0
Ndalesat e energjise (ore/dite)	4.3	2.9	2.3	2.7	1.6	3.4	0.3	0	0	0

(Burimi KESH, OST)




Figure 16 Shkarkimet e Ujit nga H/C-et e Kaskadës së Drinit (2002-2011)

(Burimi OST sh.a)

Për arsye të kushteve të thata hidrometeorologjike, gjatë vitit 2011 KESH nuk ka aplikuar shkarkimin e ujrave nga basenet e tre hidrocentraleve të kaskadës së Drinit.

Në figurën -16- janë paraqitur në mënyrë grafike shkarkimet e ujit nga HEC-et e Kaskadës së lumit Drin, për secilin vit të periudhës 2002-2011.




Figure 17 Energji e shitur me cmime tregu dhe eksportuar gjatë vitit 2011

(Burimi KESH sh.a, OST sh.a)

Eksportet e realizuara nga KESH sh.a.(figura -17-)gjatë muajit janar, janë kryer pa çenuar sigurinë e furnizimit të pandërprerë të vendit me energji elektrike.

Table 7 Eksporti i energjise elektrike për vitin 2011

Viti 2011	REALIZIMI		
	Sasia MWh	Vlefte €	Vlefte Leke pa TVSH
Totali	232 128	9 280 982	1 303 977 971

Në tabelën -7- janë paraqitur të ardhurat e KESH-it nga eksporti i energjisë elektrike të cilat rezultojnë mbi 1.3 Miliard lekë.

ERE gjykon se për një sistem gjenerues të energjisë elektrike kryesisht me HEC-e, dhe vecanërisht me burime të përqendruara në mbi 80% të prodhimit vjetor në kaskadën e Lumit Drin, me prurje që variojnë nga 7-8 m³/sek në mbi 1,500m³/sek, në Fierzë dhe mbi 4,000m³/sek në Vaun e Dejës, është e nevojshme që njësjia e përpunimit të rezervës hidroenergjetike të mbështetet nga një shërbim i kualifikuar dhe i mirëpajisur për prognozimin hidrometeorologjik.

3. Konsumi i Energjisë Elektrike

Gjatë vitit 2011, ashtu sikurse edhe gjatë vitit 2010, ndërprerjet e energjisë kanë qënë vetëm ato për shkak të defekteve në rrjet ose për shkak të remonteve të paralajmëruara.

Për këtë arsye edhe viti 2011 shpreh në mënyrë objektive nivelin real të kërkesës vjetore për energji elektrike.

3.1 Kërkesa për Energji Elektrike

Sikurse shprehet dhe më sipër, deri në vitin 2009 nuk ka pasur një vlerësim të besueshëm të kërkesës për energji elektrike. Që nga viti 2008, kur filloi furnizimi i pandërprerë me energji elektrike u krijuan premisat për të bërë një vlerësim real dhe për të planifikuar me objektivitet kërkesën për energji në vitet pasues.

Në figurën -18-paraqiten në menyrë grafike konsumi vjetor i energjisë elektrike në Shqipëri për periudhën 1985 deri në 2011.




Figure 18 Konsumi i përgjithshëm në vite

(Burimi OST sh.a)

Rritja mesatare vjetore e kërkesës për energji gjatë kësaj periudhe rezulton në vleftë absolute me 183 GWh/Vit. Në periudhën përpara vitit 2008, për shkak të ndërprerjeve të programuara të energjisë ky tregues nuk është real. Duke ju referuar viteve 2009, 2010 dhe 2011 rritja e kërkesës për energji në vitin 2010 rezulton në vleftë absolute me 378 GWh më shumë ndaj vitit 2009, ose me 6% më shumë, ndërsa në vitin 2011 me 372 GWh ose me 5% më shumë se viti 2010.

Në figurën -19- është paraqitur një grafik krahasues i konsumit total të energjisë elektrike për cdo muaj, përkatësisht gjatë periudhës 2007-2011.




Figure 19 Konsumi i energjisë elektrike 2007-2011 (Burimi ERE)

Bilanci i përgjithshëm energjetik për vitin 2011, në të cilin merren në konsideratë përveç prodhimit edhe importet, shkëmbimet, konsumi dhe humbjet e energjisë elektrike në sistemin elektroenergetik, është paraqitur në diagramën e figurës -20-




Figure 20 Bilanci Energjitik viti 2011 (Burimi ERE,OST,KESH,CEZ)

Në përcaktimin e sasisë së shitur në vitin 2011, është përjashtuar sasia e energjisë elektrike prej 278.6 GWh e faturuar si dëm ekonomik dhe 156.2 GWh të raportuar nga CEZ Shpërndarje si Energji e pa faturuar.

Në grafikun e figurës -21- është paraqitur piku vjetor i ngarkesës për periudhën 1985 – 2011. Piku në vitin 2011 shënon 1450 MW.




Figure 21 Piku i ngarkesës gjatë muajve të vitit 2011

(Burimi ERE)




Figure 22 Prodhimi, Importi dhe Kërkesa 2011




Figure 23 Prodhimi, Importi dhe Konsumi 2002-2011

Në vitin 2011, sikurse vërehet nga grafiku i figurës -22-dhe tabela përkatëse është arritur konsumi më i madh historik në vendin tonë me 7.342TWh. Tendencë e përgjithëshme e konsumit të energjisë elektrike për periudhën 1985-2011 është rritja mesatare vjetore e kërkesës për energji elektrike mesatarisht me rreth 4%.

Krahas rritjes së kërkesës për energji elektrike është rritur edhe piku i ngarkesës nga 420 MW në vitin 1985 në 1450 MW në vitin 2011 me një rritje mesatare vjetore prej 40.8MW.

3.2 Struktura e Konsumit të Energjisë Elektrike

Struktura e konsumit të energjisë elektrike shpreh në mënyrë të sintetizuar edhe shkallën e zhvillimit ekonomiko-industrial të një vendi.

Në vendin tonë konsumi familjar ndaj konsumit të përgjithshëm të faturuar edhe për vitin 2011 përbën 51.4% cka tregon një ekonomi me zhvillim industrial të kufizuar. (Në llogaritjen e këtij treguesi jemi bazuar në pasqyrën e strukturës së shitjes të raportit vjetor të CEZ Shpërndarje e cila përmban edhe faturimet për dëmin ekonomik prej 278 GWh si dhe energjinë e pafaturuar 156 GWh për të cilin kompania nuk jep të dhena analitike mbi sasinë e faturuara në secilin grup konsumatorësh).

Një peshë të rëndësishme në konsumin e energjisë elektrike zënë edhe konsumatorët buxhetorë dhe jo buxhetorë, te këta të fundit bëjnë pjesë kryesisht ujësjellësit dhe hidrovorët të cilët janë edhe debitorët më të mëdhej ndaj OSSH-së.

Konsumatorët familjarë (me cmimet përkatëse 7.70 lek/kWh dhe 13.5 lek/kWh) përbëjnë peshën kryesore në të ardhurat e Çez Shpërndarje.

VITI 2011					
Dhene direkt Kurum etj per llogari te OSSH	nga H/C Priv/Konc	nga H/C e vegjel te KESH	Hyre ne rrjetin e OSSH nga OST (Kas+Imp Humb)	0.8	Dhene DARFO-s (KK) nepermjet rrjetit te OSSH
545,048	136,832	67,995	6,287,917		
7,037,792					
ENERGJIA E HYRE PER TU PERDORUR NGA OSSH					
	6,492,745	ENERGJIA NE RRJETIN E SHPERNDARJES		6,492,745	energjia e llogaritur per efekt te humbjeve ne OSSH
		Humbje (%)	37.60		
ENERGJIA E SHITUR NGA CEZ-SHPERNDARJE (MWh)					4,596,640
		Humbje	2,441,151		

Figure 24




Figure 25 Energjia disponibël në rrjetin e OSSH gjatë vitit 2011

Dominanca e konsumatorëve familjarë në konsumin e përgjithshëm të energjisë në vend, për pasojë edhe në dominancën e të ardhurave të OSSH-së, dhe problemet e mprehta që lindin nga kjo kategori konsumatorësh me humbjet joteknike të energjisë, përbëjnë një nga faktorët më problematik në nivelin e cmimeve të energjisë elektrike, që ka ndjeshmëri të lartë sociale dhe që kërkon zgjidhje të shpejtë

Table 8 Energjia Elektrike aktive/reaktive e shitur 2011

Energjie Elektrike Aktive e Shitur 2011	4597 MWh
Energji Elektrike Reaktive e Shitur 2011	278.8 MWh

Në grafikun e figurës -26- ku është paraqitur struktura e shitjes së energjisë elektrike sipas nivelit të tensionit, vërehet se në tensionin e ulët ku janë të lidhur edhe konsumatorët familjarë dhe shumica e bizneseve të vogla shitja e energjisë elektrike për këta konsumatorë është dominuese në krahasim me nivelet e tjera të tensionit.




Figure 26 Konsumi i Energjisë sipas Tensioneve

(Burimi CEZ Shperndarje)

Duhet theksuar se sipas nivelit të konsumit, sinjifikativ është fakti se rreth 69.1% e gjithë konsumatorëve familjare i përkasin bllokut të konsumit deri 300kWh/muaj, ose shtresave të popullsisë me të ardhurat më të pakta.




Figure 27 Konsumi familjar kundrejt konsumit total në vite

(Burimi CEZ Shpërndarje)

Një tregues i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik të vendit është edhe raporti i konsumit familjar ndaj konsumit të përgjithshëm. Në figurën -27- është paraqitur kjo ecuri gjatë periudhës 1985 deri në 2011. Konsumatorët familjarë figurojnë sipas raportit të CEZ Shpërndarje pa përjashtuar pjesën përkatëse të dëmit ekonomik dhe energjinë e pafatutuar për arsye të mungesës së raportimit nga ana e kompanisë në mënyrë analitike.


Tendenca e zvogëlimit të konsumit familjar ndaj konsumit të përgjithshëm, mbas vitit 2007, është një prirje pozitive e cila përveç zvogëlimit të humbjeve të energjisë elektrike lidhet edhe me një zhvillim më të madh ekonomik të vendit.

3.3 Profili i Konsumit të Energjisë Elektrike

Struktura e konsumit të energjisë elektrike ndikon drejtpërdrejtë edhe në profilin e ngarkesës ose të konsumit të energjisë elektrike. Në figurën -28- është paraqitur profili i konsumit të energjisë elektrike në 21 Janar 2011, ku është shënuar edhe konsumi maksimal për vitin 2011 prej 25.996 milion kWh/ditë si dhe profili i konsumit në 10 Prill 2011 që i përket konsumit minimal për vitin 2011 prej 17.705 Milion kWh/ditë.

Tipar karakteristik i këtij profili është “gropa” e madhe e ngarkesës ndërmjet oreve të natës (24 – 7) ndaj oreve të ditës. Në vleftë absolute ajo arrin deri në 700MW ose 50% e ngarkesës maksimale. Një profil i tillë tregon se punohet pak në “turnin e tretë”.

Në dallim nga profili i ngarkesës në një ditë me konsum maksimal, në profilin e një dite me konsum minimal, spikat një pik ngarkese në orët e mbrëmjes (19-22) e cila ka të bëjë kryesisht me intensifikimin e veprimtarisë familjare në këto orë, gjatë stinës së verës.




Figurë 28 Grafiket ditor me ngarkesën maksimale dhe minimale të vitit 2011

Profili vjetor i konsumit të energjisë elektrike është paraqitur në grafikun e figurës -29-. Tipari karakteristik i këtij profili është simetria thuhajse e plotë e konsumit dimër – verë. Gjatë periudhës së ngrohtë Prill – Shtator ka një konsum mesatar pothuajse konstant kurse në tre muajt paraardhës dhe pasardhës ka një rritje simetrike të ngarkesës e cila shpjegohet me ftohjen e motit dhe përdorimin gradual të energjisë elektrike për ngrohje.

Përdorimi i energjisë elektrike për ngrohje përbën një dukuri tjetër problematike të konsumit të energjisë elektrike në vendin tonë. Çdo ndryshim i temperaturës së mjedisit reflektohet menjëherë në konsumin ditor të energjisë elektrike, pikërisht të efektit nga përdorimi ose mospërdorimi i ngrohjes elektrike të banesës.

Gjatë stinës së verës, në muajt Korrik dhe Gusht merr formë një pik i ri ngarkese, i cili nga viti në vit po bëhet më evident dhe lidhet me përdorimin gjithnjë e në shkallë më të gjerë të pajisjeve klimatizuese.



Figurë 29 Grafiku i ngarkesave mesatare mujore gjatë vitit 2011


(Burimi OST sh.a)

3.4 Importi i energjisë elektrike.

Në zbatim të kërkesave të Modelit Shqiptar të Tregut, importet e energjisë elektrike për nevoja publike në vendin tonë, kryhen nga furnizuesi publik me shumicë (FPSH) në përbërje të KESH-it, CEZ Shpërndarje sh.a dhe Furnizuesit të Kualifikuar. Ndërsa FPSH importon energji për të plotësuar nevojat e klientëve tariforë, CEZ importon energji elektrike për të mbuluar humbjet e energjisë elektrike në sistemin e shpërndarjes dhe Furnizuesit të Kualifikuar për nevojat e Klientëve të Kualifikuar.

Ndryshe nga viti 2010 ku për herë të parë që mbas vitit 1998, në bilancin e përgjithshëm import-eksport, eksportet tejkaluan importet dhe vendi ynë rezultoi si vend eksportues neto i energjisë elektrike, viti 2011 përsëri sjell kthimin e vendit në importues neto.


Në grafikun e figurës -30- është paraqitur bilanci import-eksport i energjisë elektrike për periudhën 1985 – 2011. Sikurse vihet re deri në vitin 1998, (me përjashtim vetëm të vitit 1990) vendi ynë ka qenë një vend eksportues neto i energjisë elektrike.



Figurë 30 Bilanci Imp/Eksp i energjisë elektrike në vite

(Burimi CEZ Shpërndarje)


Në grafikun e figurës -31- paraqitet importi i energjisë elektrike për çdo muaj të vitit 2011 si dhe krahasimi me vitet 2007-2010.



Figurë 31 Importi Energjisë Elektrike (në hyrje) 2007-2011

(Burimi CEZ Shperndarje)


Në figurën -32- në mënyrë grafike është paraqitur ecuria e prodhimit, importit dhe konsumit të energjisë elektrike gjatë periudhës 2002 – 2011



Figurë 32 Ecuria e treguesve të prodhimit vendas dhe importit të energjisë elektrike gjatë viteve 2002 – 2011

(Burimi CEZ Shpërndarje)


Në grafikun e figurës -33- është paraqitur ecuria e importeve të energjisë elektrike gjatë periudhës 2002 deri 2011. Nëse deri në vitin 2008 importet janë realizuar vetëm nga shoqëria KESH, mbas vitit 2008, me privatizimin e shoqërisë së shpërndarjes, importet janë kryer për mbulimin e humbjeve nga CEZ Shpërndarje dhe për furnizimin e konsumatorëve tarifar nga FPSH/KESH sh.a. Ndërsa në vitin 2010 importet u kryen vetëm nga CEZ Shpërndarje për mbulimin e humbjeve të energjisë elektrike, në vitin 2011 kemi importe nga të dy këto kompani për një total prej 3,262 GWh.



Figurë 33 Ecuria e importeve të energjisë elektrike gjatë viteve 2002-2011

(Burimi KESH, CEZ Shpërndarje)

Në figurën -34- janë paraqitur çmimet e importit të energjisë elektrike gjatë periudhës 2002 – 2011.




Figurë 34 Çmimet e importit të energjisë elektrike gjatë viteve 2002 – 2011.

(Burimi CEZ Shpërndarje, KESH)

Sikurse vihet re, që nga viti 2002 dhe deri në vitin 2008, kur arrijnë pikun, çmimet e importit të energjisë elektrike kanë ardhur vazhdimisht duke u rritur. Në vitin 2008 në krahasim me vitin 2002 çmimet e importit rezultuan 2.63 herë më të larta. Mbas vitit 2008 për shkak të uljes së kërkesës për energji elektrike si pasojë e krizës ekonomike botërore çmimet e importit kanë qenë në rënie. Kjo tendencë

ndalet në vitin 2011 në të cilin çmimi mesatar i importit pësoi një rritje prej 32.94 % krahasuar me vitin 2010.



Figurë 35 Grafiku i vlerës së importit

(Burimi CEZ Shpërndarje, KESH)

Në grafikun e figurës -35- janë paraqitur financimet që janë kryer gjatë periudhës 2002- 2011 për të siguruar sasi të përkatëse të energjisë elektrike, kundrejt çmimeve të importit.

Viti 2011 shënon vlerën më të madhe të shpenzimeve për blerjen e energjisë elektrike, dhe kjo vjen kryesisht në saj të sasive të konsiderueshme të importuara.

Duke parë këto bilance të importeve të energjisë elektrike, mund të thuhet me të drejtë se energjia elektrike përfaqëson një produkt me kosto shumë të lartë që për pasojë duhet të përdoret me eficiencë.


3.5 Efienca e Konsumit të Energjisë Elektrike.

Nëse në prodhimin publik të energjisë elektrike efienca e kësaj veprimtarie vjen duke u rritur nga viti në vit, nuk mund të themi të njëjtën gjë për ritmet me të cilat po përmirësohet efienca e konsumit të energjisë elektrike.

Faktorët që determinojnë uljen e eficiencës së konsumit të energjisë elektrike janë:

- Niveli i lartë i humbjeve të energjisë elektrike në shpërndarje. Humbjet totale dhe humbjet jo teknike dhe teknike në veçanti, kanë nivele të papranueshme, ç'ka reflektohet në nivelin e ulët të faturimeve të energjisë elektrike ndaj konsumit të përgjithshëm.
- Niveli i ulët i arkëtimeve të energjisë elektrike të faturuar.

Në grafikun e figurës -36- është paraqitur niveli i humbjeve, arkëtimeve dhe efektivitetit gjatë vitit 2011. Me termin efektivitet shprehet rezultati final i eficiencës në konsumin e energjisë elektrike që merr në konsideratë efektet e përbashkëta të nivelit të faturimeve dhe të nivelit të arkëtimeve.




Figurë 36 Arkëtimet, Humbjet dhe Efektiviteti i shitjes 2011

(Burimi CEZ Shpërndarje)

Humbjet e përgjithshme në shpërndarje gjatë vitit 2011, duke marrë në konsideratë edhe konstatimet e ERE-s mbi dëmin ekonomik dhe energjinë e pafaturuar përbëjnë 37.58% të energjisë së përgjithshme të injektuar në sistemin e shpërndarjes, sikurse tregohet në grafikun e figurës -36-.

Niveli i arkëtimeve i raportuar nga CEZ Shpërndarje për vitin 2011 është 70.69% të energjisë elektrike të faturuar. Kjo shifër përfshin edhe arkëtimet e prapambetura të periudhës 2006-2010 në vleftën 6.9 miliard leke. Niveli i arkëtimit të vitit 2011 për faturat korrente, raportohet nga CEZ Shpërndarje në 59%.

Koeficienti vjetor i efektivitetit për sistemin e shpërndarjes (i cili merr parasysh nivelin vjetor të humbjeve dhe të arkëtimeve) rezulton me 49.63%. Vërehet qartë se niveli i eficiencës në shpërndarje është ulur me 4.11% në krahasim me vitin 2010.



Figurë 37 Ecuria e humbjeve në sistemin e shpërndarjes

(Burimi CEZ Shpërndarje)

Në zbatim të programit të zvogëlimit të humbjeve në shpërndarje, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s Nr. 93, datë 30.11.2010, CEZ Shpërndarje ka detyrimin që për periudhën 2010-2011 të zvogëlojë humbjet me 6%


d.m.th. nga niveli 33.92% në 1 Janar 2010, ti ulë në nivelin 27.92% në 31 Dhjetor 2011.

Niveli i humbjeve 30.9% të raportuara nga CEZ Shpërndarje çon në konkluzionin që kompania CEZ Shpërndarje nuk e ka realizuar targetin e humbjeve. Nisur nga llogaritjet e ERE-s për këtë tregues, duke marrë në konsideratë edhe humbjet e paraqitura nga kompania si "dëm ekonomik" dhe "energji e pafaturuar", situata paraqitet akoma më pesimiste me nivelin e humbjeve 37.58%.

Eficienca e ulët në performancën e kompanisë vjen si pasojë e një menaxhimi ende cilësisht të pamjaftueshëm të sistemit të shpërndarjes nga ana e CEZ Shpërndarje. Është detyrë themelore e CEZ Shpërndarje që të reflektojë thellë në përmirësimin e menaxhimit të shoqërisë dhe të realizojë sa më shpejt kthesën pozitive të shumëpritur nga konsumatori shqiptar.

Në sistemin e transmetimit humbjet e energjisë elektrike janë në vleftën 172.9 GWh dhe përbëjnë 2.3% të energjisë së injektuar në sistemin e transmetimit.


Humbjet totale faktike për vitin 2011, të cilat marrin parasysh humbjet në rrjetin e shpërndarje me 2440 GWh dhe humbjet në rrjetin e transmetimit me 172.9 GWh janë gjithësej 2,613 GWh ose 35.6% e gjithë energjisë së injektuar në sistemin elektroenergjetik të vendit.



Figurë 38 Humbjet totale kundrejt energjisë së futur në rrjet

(Burimi ERE,CEZ Shpërndarje)


Në grafikun e figurës -38- është paraqitur ecuria e humbjeve gjatë periudhës 2002 – 2011, kurse në grafikun e figurës -39- është paraqitur marrëdhënia e faturim-arkëtimeve gjatë së njëjtës periudhë.



Figurë 39 Faturimi/Arkëtimi 2002-2011

(Burimi CEZ Shpërndarje)

Duhet të theksojmë se shkalla e performancës së CEZ Shpërndarje ende është larg objektivave të vendosura.



Figurë 40 Ecuria e furnizimit me energji elektrike perkundrejt ndalesave të energjisë për periudhën 2002-2011

(Burimi ERE, CEZ Shpërndarje)

Një nga treguesit kryesor të efikasitetit të përdorimit të energjisë elektrike është shkalla e mungesës së saj. Energjia e munguar është energjia më e shtrenjtë, për efekt të impaktit mjaft të rëndë që sjell mungesa e energjisë elektrike në jetën ekonomiko-sociale të vendit.

Deri në vitin 2008 furnizimi me energji elektrike është kryer me ndërprerje të planifikuara. Në grafikun e figurës -40- paraqiten ndërprerjet e energjisë elektrike gjatë periudhës 2002 – 2011. Vetëm tre vitet e fundit në Shqipëri nuk ka patur ndërprerje të programuara të furnizimit me energji elektrike dhe mund të themi se tashmë kjo dukuri është konsoliduar.

4. Operatori i Sistemit të Transmetimit

Zhvillimi i rrjetit të transmetimit në përputhje me parashikimet afatgjata dhe me planet e zhvillimit të sektorit elektroenergjetik në tërësi është një nga funksionet themelore të Operatorit të Sistemit të Transmetimit OST sh.a dhe përbën një domosdoshmëri për kryerjen e funksioneve të saj. I gjithë sistemi elektroenergjetik shqiptar aktualisht ndodhet në një fazë të zhvillimit intensiv. Kjo duket qartë në këto aspekte:

- Ritmet e rritjes së kërkesës për energji elektrike në Shqipëri janë ende mjaft të larta. Duke ju referuar të dhënave të periudhës 2005-2011, energjia elektrike që është injektuar në sistemin e transmetimit për nevojat e konsumatorëve të energjisë elektrike është rritur rreth 3.8% në vit.
- Kërkesat për lidhjen e burimeve të reja në sistemin e transmetimit janë shtuar dhe sipas parashikimeve pritet që vitet e ardhëshme të ndërtohen burimet e rëndësishme të energjisë elektrike, kryesisht HEC-e, si dhe disa centrale eolike. Kërkesat për ndërtimin e këtyre të fundit kanë arritur në një fuqi të instaluar jashtëzakonisht të madhe.
- Sistemi ynë elektroenergjetik ende nuk arrin të mbulojë nëpërmjet prodhimit vendas kërkesën për energji elektrike dhe për këtë arsye çdo vit është e domosdoshme të importohen sasi të mëdha të energjisë elektrike. Veçanërisht ky deficit është i madh në vitet e thata, ku për mbulimin e kërkesës duhet një import akoma dhe më i madh. Si pasojë e vënies në punë të linjës së re 400 kV Tiranë – Podgoricë është bërë i mundur të realizohet një import në bandë prej rreth 700 MW.
- Në kuadrin e integrimit në Bashkimin Europian dhe Traktatit të Komunitetit të Energjisë, vendi ynë ka marrë angazhimet përkatëse, për adoptimin e legjislacionit përkatës dhe krijimin e kushteve teknike të favorëshme për zhvillimin e integruar të tregut të energjisë elektrike në rajon, nëpërmjet rehabilitimit dhe modernizimit të Sistemit të Transmetimit dhe fuqizimit të rrjetit të interkoneksionit.

4.1 Projektet kryesore të përfunduara gjatë vitit 2011


- *Linja e interkonjeksionit 400 kV Elbasan2-Tirana2- Podgoricë.*

Projekti përbëhet nga dy pjesë:

1. Linja 400 kV Elbasan2-Tirana2.
Linja ka një gjatësi prej 48 km me një vlerë totale rreth 13 milion Euro.
2. Linja 400 kV Tirana2- Podgoricë. Vlera e plotë e tij është 43 milion Euro. Projekti konsiston në ndërtimin e linjës së interkonjeksionit 400 kV Tirana2-Podgoricë. Linja ka një gjatësi të përgjithshme prej 155 km nga të cilat 125.3 km janë në territorin shqiptar. Pjesa e linjës nga Tirana deri në V. Dejës (rreth 80.5 km) është ndërtuar me shtylla për dy qarqe për të qenë e gatëshme për linjën 400 kV Tiranë – Kosova B. Gjithashtu pjesë e këtij projekti është dhe ndërtimi i dy daljeve 400 kV në N/st Elbasan2

Aktualisht të dy linjat janë përfunduar, është bërë prova e energjizimit të tyre dhe janë vënë në punë në datën 11 Maj 2011. Për shkak të vonesave në ndërtimin e N/stacionit 400/220/110 kV Tirana2, fillimisht linjat u vunë në operim së bashku, nëpërmjet lidhjes direkte Elbasan2 – Podgoricë. Në datën 10 Korrik 2011 u realizua hyrja dhe dalja e kësaj linje në N/stacionin 400 kV Tirana2.

Linjat 400 kV Elbasan – Tirana 2 dhe Tirana 2– Podgoricë janë pjesë e linjës 400 kV Elbasan 2– Tiranë2 – Podgoricë, që ka bërë të mundur mbylljen nëpërmjet territorit tonë të një rrjeti unazor 400 kV të rajonit të Ballkanit.



Projekti ka një impakt të madh në rritjen e mundësisë teknike të shkëmbimit të energjisë elektrike midis sistemit tonë dhe vendeve fqinje si dhe një impakt rajonal gjithashtu. Veçanërisht për kushtet aktuale të vendit tonë projekti do të jetë i rëndësishëm pasi do të krijojë mundësinë teknike të marrjes së importit të kërkuar në kohën e duhur, për të mundësuar mbulimin e kërkesës për energji elektrike në çdo situatë. Kjo u vërtetua dhe në periudhën e vështirë hidrike të fundit të vitit 2011, ku u realizua një import i rendit rreth 18 milion kWh në ditë dhe që shmangu një situatë kritike që do ta fuste vendin tonë në kufizime të thella të furnizimit me energji elektrike. Për më tej, me ndërtimin e burimeve të reja hidrocentrale dhe centrale eolike, për te cilat Shqipëria ka burime të konsiderueshme, garantoher transmetimi dhe tranzitimi nëpërmjet rrjetit shqiptar i energjisë elektrike të prodhuar prej tyre në drejtim të vendeve të rajonit.

Gjithashtu ai do të ketë një ndikim të rëndësishëm në rritjen e sigurisë së punës dhe qëndrueshmërisë të sistemit elektroenergjetik në tërësi. Ndërtimi i kësaj linje ishte një nga kushtet që OST të bëhet anetare me të drejta të plota i Rrjetit European të Operatorëve të Sistemit të Transmetimit, për Energjinë Elektrike (ENTSO-E).

Impakte të tjera pozitive:

- Krijohet mundësia e operimit të përbashkët të sistemeve gjeneruese me natyrë komplementare duke zvogëluar koston e përbashkët të prodhimit të energjisë elektrike. Gjenerimet rajonale të dominuar nga termocentalet mbulojnë bazën e ngarkesës dhe gjenerimi shqiptar i dominuar nga hidrocentralet mbulon pikun e ngarkesës.
 - Mundësi teknike reale për krijimin e një tregu të integruar të energjisë elektrike në Evropën Juglindore.
 - Rritja e kapacitetit të shkëmbimit me fqinjët i jep shtysë investimeve private për ndërtimin e burimeve hidrike dhe njëkohësisht dhe parqeve eolike, për prodhimin e energjisë elektrike në territorin e Shqipërisë, e cila ka një potencial të konsiderueshëm ende të pa shfrytëzuar.
 - Reduktohet kosto e përbashkët e burimeve të reja të energjisë elektrike.
 - Mundësohet balancimi i energjisë reaktive, pasi gjenerimi kapacitiv i linjës shmang fluksin e madh reaktiv që futej në sistemin tonë nga fqinjët.
 - Përmirësohet niveli i tensionit dhe reduktohen humbjet e energjisë elektrike në rrjetin e transmetimit.
-
- ***Ndërtimi i nënstacionit 400/220/110 kV Tiranë***

Projekti është me vlerë 24.5 milion Euro dhe përfshin ndërtimin e një nënstacioni 400/220/110 kV në Tiranë, i përbërë nga 2 autotransformatorë 400/220 kV me fuqi 300 MVA secili, dy transformatorë 220/110 kV me fuqi 120 MVA secili si dhe daljet përkatëse për lidhjen me rrjetin transmetues 400, 220 dhe 110 kV. Projekti ka përfunduar dhe N/stacioni është vënë në funksionim në muajin Korrik 2011. Rëndësia e këtij N/stacioni është e shumfishtë.

NEN/STACIONET E SISTEMIT TE TRANSMETIMIT		
	FUQIA E INSTALUAR	NUMRI
400 kV	750 MVA	3
220 kV	2126 MVA	12
150 kV	40 MVA	1
GJITHSEJ		16.

LINJA TE TENSIONIT TE LARTE	
400 kV	319.585 km
220 kV	1128 km
150 kV	34,4 km
110 kV	1216.2 km

LINJAT E INTER-KONJEKSIONIT	
Fierze-Prizren	220 kV (68 km)
Koplik-Podgorice	220 kV (44.75 km)
Bistrica 1-Myrtos	220 kV (47 km)
Zemlak-Kardia	400 kV (20 km)

(Bazimi OST)


Së pari, nëpërmjet transformimit 400/220 ai siguron lidhjen midis dy niveleve të tensionit: 400 kV dhe 220 kV, duke bërë të mundur futjen e fluksit të fuqisë nga rrjeti i interkonjeksionit 400 kV në rrjetin e brendshëm 220 kV. Së bashku me N/st 400 kV Elbasan 2, ky nënstacion është pjesë e domosdoshme e rrjetit që realizon shkëmbimin e energjisë elektrike me fqinjët, veçanërisht importin e energjisë elektrike.

Nyja e re 220 kV krijon një konfiguracion të ri kur rrjeti 220 kV paraqitet më i ndërthurur dhe më i balancuar, duke operuar në mënyrë të sigurtë. Fluksi i fuqisë nga HEC Koman hyn direkt në rajonin e Tiranës që përfaqëson nyjen konsumatore më të madhe në vend.

Për më tepër nëpërmjet transformimit 220/110 kV dhe rrjetit 110 kV do të përmirësohen në mënyrë rrënjësore kushtet e furnizimit me energji elektrike nga rrjeti i transmetimit të N/stacioneve 110 kV të sistemit të shpërndarjes të Tiranës.

Projekti ka një impakt të madh në rritjen e qëndrueshmërisë së sistemit elektroenergjetik në tërësi, në përmirësimin e cilësisë së shërbimit të transmetimit dhe në reduktimin e humbjeve të energjisë elektrike në rrjetin transmetues.

STRUKTURA E SISTEMIT TE TRASMETIMIT SHQIPTAR



Figurë 41 Struktura e Sistemit të Transmetimit Shqiptar

5. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes

OSSH ka për objekt të veprimtarisë së vet mbajtjen dhe zhvillimin e një sistemi të sigurtë dhe eficient shpërndarjeje për të garantuar një furnizim me cilësi dhe pa ndërprerje me energji elektrike të konsumatorëve të lidhur në këtë sistem.

Sistemi i shpërndarjes administrohet nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH), i cili është i licencuar nga ERE për të kryer veprimtarinë e shpërndarjes së energjisë elektrike. OSSH kryen edhe importet e energjisë elektrike deri në atë masë sa të mbulojë humbjet e energjisë elektrike në shpërndarje. Sistemi i shpërndarjes së energjisë elektrike përfaqëson bashkësinë e linjave elektrike ajrore dhe kabllore, n/stacioneve dhe instalimeve të tjera (kabina transformuese etj) që shërbejnë për shpërndarjen e energjisë elektrike.

Funksionet e kryerjes së furnizimit me energji elektrike dhe të gjitha procedurat e faturimit dhe arkëtimit të energjisë elektrike të shitur te konsumatorët tariforë kryhen nga Furnizuesi Publik me Pakicë (FPP), që përfaqëson një subjekt të pavarur financiarisht dhe funksionalisht nga OSSH-ja por që juridikisht është pjese e saj. FPP për furnizimin e konsumatorëve tariforë blen me çmime të rregulluara nga Furnizuesi Publik me Shumicë (FPSH), të gjithë energjinë elektrike të prodhuar në vend dhe të importuar prej tij (FPSH), për plotësimin e nevojave të konsumatorëve tariforë.


Funksionet e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe Furnizuesit Publik me Pakicë kryen nga CEZ Shpërndarje Sh.a.

5.1 Struktura e Sistemit te Shperndarjes

Në Tabelën 10 është paraqitur harta e Republikës së Shqipërisë dhe shtrirja gjeografike e secilës zonë së shpërndarjes. CEZ Shpërndarje është organizuar në 4 Zona Shpërndarje me emertimet:

- Zona Veriore me qendër në Shkodër.
- Zona Qëndrore me qendër në Durrës
- Zona Juglindore me qendër në Korçë
- Zona Jugperendimore me qendër në Fier

Table 9 Ndarja Administrative e Rrjetit te Shperndarjes



(Burimi CEZ Shperndarje)

Në tabelën 11 janë paraqitur të dhëna mbi asetet dhe numrin e konsumatorëve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.

Table 10 Te dhenat mbi Operatorin e Sistemit te Shperndarjes

Te dhenat mbi Operatorin e Sistemit te Shperndarjes

Zonat	CEZ Shperndarje	Qender (Dures)	Veri (Shkoder)	Jug-Lindje (Korce)	Jug-Perendim (Fier)
Numri I N/Zonave	40	7	12	11	10
Linja 35 kV (km)	1,131	200	231	400	300
Fuqia MVA	2956	1000	552	654	740
Transformatore TL	316	61	79	63	113
Siperfaqe (km²)	29 176	2458	10 023	0219	7476
Nenstacione	156	31	46	41	47
Konsumatore	1 108 000	410 000	189 000	248 000	261 000
Kabina TM	20 056	6518	5 438	4 100	4 000
Gjatesia e rrjetit TM (km)	12 490	2354	3 763	3403	3 970
Gjatesia e rrjetit TU (km)	25 695	4 155	7 532	8110	5 898

(Burimi CEZ Shperndarje)

PJESA II

Kapitulli I

Rregullimi i Sektorit të Gazit Natyror

1. Prioritetet e ERE-se për Sektorin e Gazit Natyror gjate Vitit 2011

Gjate vitit 2011, ERE ka punuar në zhvillimin e kapaciteteve të veta institucionale për krijimin e kuadrit të domosdoshëm rregullator në fushën e gazit natyror të harmonizuar me Direktivat e BE dhe me vendet e rajonit.

Duke qene së zhvillimi i sektorit të gazit natyror në Shqipëri në terma afatshkurtër dhe afatmesëm është i lidhur ngushtësisht me projektin TAP, vëmendja kryesore e ERE-së në këtë sektor ka qënë e fokusuar në mbështetjen e gjithanshme të përpjekjeve për konkretizimin e këtij projekti duke krijuar hapësirat e nevojshme për interesat shqiptare në të.

2. Përmbledhje e Shkurtër e Zhvillimeve me të Rëndësishme ne lidhje me Projektet e Gazit Natyror

TAP, IGI/Posseidon, Nabucco dhe SEEP, janë katër projekte përbërës të të ashtuquajturit Korridor i Jugut dhe synojnë të furnizojnë tregjet europiano-perëndimore me gaz natyror prej vendburimit Shah Deniz 2 të Azerbaxhanit. Ata paraqitën ofertat e tyre pranë Konsorciumit Shah Deniz 2 me datën 1 Tetor 2011, në kushtet kur gazi i disponueshëm nga ky vendburim mjafton vetëm për njërin prej projekteve konkurrues.



Ndryshe nga sa parashikuar gara nuk u finalizua brenda vitit 2011. Konsorciumi i Shah Deniz 2, vetëm në muajin Shkurt 2012, përzgjodhi projektin TAP ndërmjet dy projekteve konkurruese të degëzimit jugor të cilët synojnë tregun italian të gazit; ITGI dhe TAP. Gara është ende në proces dhe pritet që brenda muajve në vijim të përzgjidhet projekti më i preferuar i degëzimit verior, Nabuco ose SEEP, që shkojnë drejt Baumgarten, Austri. Faza finale e cila do të përzgjedhë prej dy projekteve të kualifikuara nga faza paraardhëse, është njoftuar së do të përfundojë në mesin e vitit 2013.

Për shkak të rëndësisë jo vetëm energjitike por edhe ekonomike e gjeopolitike beteja e projekteve për gazin e Shah Deniz 2, ka qënë shumë intensive në të gjitha nivelet.

ERE ka bërë prezent në të gjitha takimet ndërkombëtare, nevojën për trajtim të njëjtë të projekteve mbi bazën e kriterëve ekonomike e objektive si dhe rëndësinë e veçantë që projekti TAP ka jo vetëm për Shqipërinë, por edhe për realizimin e Unazës së Gazit të Ballkanit përfundimor dhe vetë Italinë.

Në sajë të bashkëpunimit midis METE dhe ERE, në tetor 2011, nga ana shqiptare u depozitua pranë Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë në Vjene një kërkesë që projekti TAP të klasifikohet si projekt prioritar i Komunitetit të Energjisë, duke qene se ai përshkon një prej Palëve Kontraktuese (Shqipërinë) dhe kontribuon në zhvillimin e sektorit në rajon dhe përmirësimin e sigurisë së furnizimit të tij me energji.

2.1 Zhvillime Specifike të TAP gjate 2011

TAP është i vetmi projekt i cili kalon përmes Shqipërisë dhe për pasoje paraqet interesin më të madh për ne. Projekti ka një kosto të vlerësuar prej 3,7 miliard Euro dhe parashikohet të filloje punimet të vitin 2014 dhe të jete gati për shfrytëzim në vitin 2017, i cili është edhe viti i fillimit të prodhimit të fazës së dyte të vendburimit Shah Deniz 2.

Gjate vitit 2011 duke marre në konsiderate zhvillimet në Greqi TAP mori vendimin, që lidhjen e tij me rrjetin grek të transmetimit ta zhvendose prej Selanikut në Komotini, qytet i cili ndodhet pranë kufirit Greko-Turk. Ky vendim, i cili e zgjat tubacionin edhe me rreth 300 km shtese, krahas rritjes së vlerës së investimit, kontribuon edhe në rritjen e pavarësisë së TAP prej sistemit grek.

Gjate 2011, TAP ka kryer studimet mjedisore në Shqipëri, Greqi dhe Itali dhe ka paraqitur aplikimet e tij për marrjen e lejeve të nevojshme sipas legjislacioneve përkatëse të vendeve tranzituese.

2.2 Trajtimi nga ERE i Aplikimit të Paraqitur prej Kompanisë TAP-AG për Përrjashtim prej të Drejtës së Hyrjes së Palëve të Treta të Projektit TAP

Ne date 01.09.2011, pranë ERE u paraqit nga ana e kompanisë TAP-AG, kërkesa për përrjashtimin nga e drejta e hyrjes (aksesit) te palëve te treta në sistemin e transmetimit mbështetur ne nenin 40, te Ligjit nr. 9946, date 30.06.2008 “Për Sektorin e Gazit Natyror”.

Duke qene se projekti shtrihet përmes Greqisë, Shqipërisë dhe Italisë, i njëjti aplikim është paraqitur ne te njëjtën kohe nga ana e TAP-AG edhe Autoriteteve përkatëse të Italisë (MSE, Ministria Italiane e Zhvillimit Ekonomik) dhe Greqisë (RAE, Autoriteti Rregullator i Energjisë) si dhe Komisionit European dhe Agjencisë europiane të koordinimit të rregullatorëve të energjisë ACER.

Ne përputhje me Ligjin Nr. 9946, datë 30.06.2008, “Për sektorin e gazit natyror”, trajtimi i këtij aplikimi duhet te kryhet ne bashkëpunim me autoritetet

vendase, ato të vendeve fqinje ku projekti tranziton dhe strukturat përkatëse të BE. ERE ka kërkuar prej METE dhe Autoritetit të Konkurrencës vlerësim të aplikimit dhe do të angazhojë gjatë hapave të mëtejshme të vlerësimit edhe aktore të tjerë të interesuar.

Kjo kërkesë është e para e këtij lloji për ERE-n, dhe për pasojë Rregullat e Praktikës dhe Procedurave të saj, nuk parashikojnë mënyrën e trajtimit të saj. Për të mundësuar shqyrtimin e kërkesës Bordi i Komisionereve:

- me Vendimin nr. 107, datë 17.10.2011, miratoi ndryshimet e nevojshme për të mundësuar shqyrtimin e kërkesës në fjale duke marrë në konsideratë kushtet specifike të saj, dhe
- me Vendimin nr 155, date 19.12.2011, miratoi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të paraqitur prej TAP-AG.

ERE është në komunikim me autoritetet vendase dhe ato jashtë vendit dhe po konsideron me kujdes çdo koment apo sugjerim në lidhje me Aplikimin për përjashtim prej të drejtës së aksesit të palëve të treta në sistemin e transmetimit të paraqitur nga TAP.

TAP ka shpjeguar se e mbështet projektin kryesisht në tregun italian të gazit natyror, megjithatë në aplikim është shprehur interes ndaj mundësive për furnizim me gaz të vendeve të Ballkanit Perëndimor, përfshirë Shqipërinë. Duke marrë në konsideratë rëndësinë e furnizimit me gaz të vendit, ERE i ka kërkuar TAP një pozicionim dhe një zgjidhje më të qarte në lidhje me këtë çështje dhe do të jetë çështje parësore në diskutimet në vijim.

ERE në procesin e vendimmarrjes për aplikimin e paraqitur prej projektit TAP, synon që krahas mundësimit të kryerjes së këtij investimi shumë të rëndësishëm, të sigurojë që kuadri rregullator të ketë të gjithë hapësirat e mundshme për furnizimin me gaz natyror të ekonomisë së vendit dhe asaj të rajonit dhe të krijojë një treg funksional të tij. Ky proces është duke u kryer edhe me asistencë ndërkombëtare.

2.3 Vështirësitë e Hasura në Koordinimin e Përpjekjeve për Trajtimin e Aplikimit të TAP, prej Autoriteteve Përkatëse të Vendeve që Përshkohen prej Projektit TAP.

Projekti TAP parashikon të shtrihet në tre vende të ndryshme prej të cilave; Greqia dhe Italia si vende anëtare të BE mbulohen prej Direktivës 2009/73/EC, të quajtur ndryshe Paketa e 3^{te} Rregullatore, ndërsa Shqipëria, e cila është Pale Kontraktuese e Komunitetit të Energjisë mbulohet prej Direktivës 2003/55/EC e quajtur ndryshe si Paketa e 2^{te} Rregullatore, e transpozuar në Ligjin nr. 9946, datë 30/06/2008 “Për Sektorin e Gazit Natyror”¹.

Pavarësisht sa me sipër MSE, (Ministria e Zhvillimit Ekonomik të Italisë), e cila është autoriteti përgjegjës për trajtimin e aplikimit të paraqitur prej TAP, në korrespondencën e saj të datës 30 shtator 2011, drejtuar institucioneve homologe shqiptare dhe greke, duke ju referuar Dekretit² të 11 prill 2006, shpjegon se duke qenë se Shqipëria nuk është vend anëtar i BE, procedura për trajtimin e aplikimit të TAP do të duhet ose të paraprihet nga një Protokoll Mirëkuptimi ndërqeveritar (Protocol of Agreement) për projektin në fjalë ose përndryshe aplikimi do të duhet të presë miratimin e tij paraprak prej Ministrisë Italiane të Mjedisit.

ERE e ka ngritur shqetësimin në fjalë pranë Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, duke argumentuar se trajtimi i Shqipërisë si një vend i tretë në mënyrë direkte injoron ekzistencën e Traktatit të Komunitetit të Energjisë, të cilin pala Italiane e ka nënshkruar dhe po e asiston. Ky qëndrim është koherent edhe me qëndrimin zyrtar të Direktoratit C (security of supply) të DG Energy³ të Komisionit Europian dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë⁴.

¹Keshilli i Minsitrave të Komunitetit të Energjisë në mbledhjen e tij të fundit të datës 6 tetor 2011 në Chinsinau, Moldavi mori vendimin që direktivat e reja të energjisë të njohura ndryshe edhe si Paketa e Tretë do të adoptohen në legjisllacionin e Paleve Kontraktuese deri në vitin 2015.

²Decreto del Ministro 11 Aprile 2006 publicatto sulla Gazzetta Ufficiale Della Repubblica Italiana del 12 maggio 2006.

³Leter e Z Heinz Hilbrecht, Drejtor i Direktoratit C të DG Energy I Komisionit Europian drejtuar TAP, Sekretariatit të Energjisë, MSE (Min Italiane për Zhvill Ekon) Rreg Italian dhe Rreg Grek, date 24 shkurt 2009.

Leter e Z Philip Loëe, Drejtor i Pergjithshem për Energji, drejtuar MSE në datën 6 dhjetor 2011.

⁴Leter e Z Slavtcho Neikov, Drejtor i Sekretariatit të KomEnergjisë, Vjene drejtuar MSE date 22 dhjetor 2011.

Adresa:Rruga “Gjergj Fishta”10

77 /175

Tel/Fax +355 42 22 963

Tirane

Tel +355 42 69 590

E-mail erealb@ere.gov.al

www.ere.gov.al

Në përputhje me sa me sipër, MSE ka pezulluar trajtimin e aplikimit të depozituar nga TAP prej palës italiane dhe kjo ka sjelle si pasojë pamundësinë e progresit të kësaj çështjeje prej të tre rregullatorëve: shqiptar - ERE, grek - RAE dhe atij italian - AEEG.

Për pasojë vendimmarrja në lidhje me aplikimin e TAP për përjashtim nga e drejta e aksesit të paleve të treta do të finalizohet mbas qartësimit të pozicioneve të autoriteteve kompetente të Italisë dhe Greqisë si dhe atyre të Bashkimit European dhe Komunitetit të Energjisë.

3. Kontributi i ERE-së në Grupin e Punës për Gazin të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë

Gjate vitit 2011 ERE ka marrë pjesë në mënyrë aktive në takimet e Grupit të Punes për Gazin të Komunitetit të Energjisë. Nëpërmjet këtij angazhimi është bere e mundur që krahas zhvillimit të njohurive në këtë fushe të kontribuohet edhe në përgatitjen e një sere studimesh të ndërmarra të fokusuara në sfidat e zhvillimit të sektorit të gazit natyror në vendet e Komunitetit të Energjisë.

PJESA III

Kapitulli I

Aktiviteti i Entit Rregullator te Energjise

1. Çmimet dhe Tarifat e Energjise

1.1 Çmimet dhe Tarifat e Energjisë Elektrike për periudhen 2012-2014

Bazuar në ligjin nr. 9072 datë 22.05.2003 për sektorin e energjisë (i ndryshuar), përkatësisht në nenet 26, 27 dhe 28 si dhe akteve të tjera nënligjore, që burojnë prej tij, ERE ushtron përgjegjësinë ligjore për përcaktimin e tarifave të aktiviteteve të rregulluara që realizohen në sektorin e energjise elektrike.

Ne kete kontekst nje nga veprimtaritë kryesore të ERE-s gjatë vitit 2011 ishte shqyrtimi i aplikimeve për tarifrat e reja nga ana e të licensuarve në sektorin elektroenergjetik përfshirë veprimtaritë e prodhimit, furnizimit publik me shumicë, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike për klientet tariforë.

Mbi bazën e një analize të plotë dhe të kujdesshme të treguesve teknike, ekonomike dhe financiare, të paraqitur nga të gjitha shoqëritë e rregulluara, përfshire KESH sh.a, TEC-Vlore sh.a, OST sh.a dhe CEZ Shperndarje sha., si dhe te tre kompanive gjeneruese “Hec Ulëz Shkopet” sh.a., “Hec Bistrica 1 dhe Bistrica 2”sh.a., “Hec Lanabregas” të krijuara në zbatim te Ligjit Nr. 10430 datë 09.06.2011, Për krijimin e shoqërive "Hec Ulëz - Shkopet", sha, "Hec Tiranë, Lanabregas", sha dhe "Hec Bistrica 1 dhe Bistrica 2 sha" dhe përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërive "Hec Ulëz - Shkopet", sha dhe "Hec Bistrica 1 dhe Bistrica 2", në mbështetje të kërkeses së tyre për të ardhura dhe përmes një procesi tejet transparent, ERE percaktoi tarifrat dhe cmimet per veprimtarite e mësipërme për periudhen 2012-2014, të cilat Bordi i Komisionereve të ERE-s i miratoi me Vendimet Nr.144, 145, 146, 147, 148, 149, 150, 151, 152, 153 dhe 154 të datës 07.12.2011.

1.1.1 Metodologjite dhe Procedurat e Përcaktimit të Çmimeve e Tarifave.

ERE në mbështetje të Ligjit nr. 9072, date 22.05.2003, “Per sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, ka hartuar dhe miratuar metodologjitë për llogaritjen e tarifave të aktiviteteve të rregulluara në sektorin e energjisë elektrike.

ERE për të garantuar një proces transparent dhe të drejtë të përcaktimit të tarifave zbatoi me korrektësi Vendimin Nr.21 date 18.03.2009 të Bordit të Komisionerve të ERE-s i ndryshuar me Vendimin Nr. 107 date 17.10.2011 për disa shtesa dhe ndryshime në “Rregullat e praktikës dhe procedurave të ERE-s” i cili përcakton etapat dhe procedurat përmes të cilave duhet të kryhet procesi i aplikimit, shqyrtimit dhe miratimit të tarifave të energjisë elektrike.

Duke patur parasysh parimet e përcaktuara në aktet nënligjore të mësipërme dhe duke qenë se tarifat e shërbimeve të energjisë elektrike janë të transferueshme tek cmimet e shitjes me pakice për klientet tariforë/fundorë, kërkesat e paraqitura për rishikimin e këtyre tarifave nga shoqëritë, u shqyrtuan njëkohësisht nga ana e ERE-s.

1.1.1.1 Tarifa e Prodhimit të Energjisë Elektrike për KESH sh.a.

Me 1 Shtator 2011, KESH sh.a., i licensuar për prodhimin e energjisë elektrike, paraqiti në Entin Rregullator të Energjisë aplikimin për rishikimin e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014.

Tarifat për vitet 2012, 2013 dhe 2014 të propozuara nga ana e KESH/Gen për prodhimin e energjisë elektrike ishin respektivisht 1.10 leke /kWh, 0.99 leke /kWh dhe 1.04 leke /kWh, pra me një rritje mesatare vjetore prej 65 % nga tarifa e mëparshme e vitit 2011 prej 0.63 leke/kWh.

Te ardhurat mesatare vjetore të kerkuara për të mbuluar shpenzimet operative dhe ato kapitale për periudhën 2012-2014 për KESH Gen, llogariten në shumën 3,856 milion leke nga 4,364 milion lekë të kërkuara nga shoqëria. Ndryshimi vjen për shkak të saktësimit që ERE e pa të arsyeshme të bënte lidhur me disa prej zërave të

shpenzimeve operative të shoqërisë, por edhe për shkak të shkëputjes së 5 HEC -eve në zbatim të Ligjit Nr. 10430 datë 09.06.2011.

Tarifa mesatare vjetore e gjenerimit publik për periudhën 2012-2014 u përcaktua 1.00 leke /kWh me vendimin nr. 144 dt 7.12.2011 të ERE-s. Tarifa mesatare vjetore e gjenerimit për periudhën 2012-2014 rezulton e rritur me 58.7% krahasuar me atë të vitit 2011 prej 0.63 leke/kWh.

1.1.1.2 Tarifa e Prodhimit të Energjisë Elektrike për Periudhën 2012-2014 për “HEC Ulez Shkopet” sh.a.; “HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2”sh.a. “HEC Lanabregas”sh.a.

HEC Ulez & Shkopet sh.a., HEC Bistrica 1 Bistrica 2 sh.a. dhe HEC Lanabregas sh.a. janë licensuar për prodhimin e energjisë elektrike nga Bordi i Komisionereve të ERE-s respektivisht me Vendimet Nr. 132 datë 06.12.2011, Nr. 136 datë 06.12.2011 dhe Nr. 134 datë 06.12.2011.

Këto shoqëri paraqiten në ERE kërkesat për cmimin e shitjes së energjisë elektrike për vitin 2012 të cilat u analizuan me kujdes dhe në zbatim të metodologjisë së llogaritjes së tarifës për kompaninë publike të gjenerimit të miratuar nga Bordi i Komisionereve të ERE-s me vendimin nr. 77, date 26.06.2008.

Në perfundim të kësaj analize u vendos që tarifat për prodhimin e energjisë elektrike për periudhën 2012-2014 për këto kompani të jenë: 2.72 lekë/kWh per HEC Ulez & Shkopet sh.a, 2.20 lekë/kWh per HEC Bistrica 1, Bistrica 2 sh.a. dhe 6.25 lekë/kWh per “Hec Lanabregas”sh.a.

1.1.2 Tarifa e Shërbimit të Shitjes me Shumicë të Energjisë Elektrike nga Furnizuesi Publik me Shumicë.

KESH sh.a., i licensuar për furnizimin me shumicë të energjisë elektrike, paraqiti në Entin Rregullator të Energjisë kërkesën për rishikimin e tarifës së shërbimit të shitjes me shumicë të energjisë elektrike për periudhën 2012-2014, me anë të të cilit kërkoji rishikimin e tarifës mesatare vjetore të periudhës, nga 1.48 leke/kWh në 4.91 leke/kWh me një rritje prej rreth 231%. Tarifa e propozuar bazohej në:

- Axhustimin në rritje i të ardhurave për periudhën aktuale të vitit 2011, si pasojë e rritjes së importeve të energjisë elektrike për mbulimin e rritjes së kërkesës së energjisë për shitje tek konsumatorët tariforë nga parashikimi.
- Llogaritjen e kërkesës për të ardhura për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014 bazuar në sigurimin e energjisë elektrike për mbulimin e kërkesës nga burimet hidro të vendit, importi si dhe parashikimi i prodhimi nga TEC-Vlora sh.a i cili ka kosto operimi relativisht të lartë.
- Marrja parasysh e kostove për shlyerjen e Overdrafteve të marra nga bankat për vitin 2007 dhe 2008 si dhe për importin e paparashikuar të energjisë për vitin 2011.

ERE në zbatim të Vendimit nr. 78, datë 26.06.2008, të Bordit të Komisionerëve të ERE, “Për miratimin e metodologjise së llogaritjes së tarifës për furnizuesin publik me shumicë të energjisë elektrike” si dhe Deklaratën Rregullatore, të miratuar nga Bordi i Komisionerëve me Vendimin Nr. 12, datë 03.03.2009, ka miratuar një nivel të ardhurash mesatare vjetore për periudhën rregullatore 2012-2014 prej 12,120 milion lekë, të cilat i korrespondojnë një tarife mesatare vjetore prej 2.83 leke /kWh, pra me një rritje prej 91.2% krahasuar me atë të periudhës së mëparëshme rregullatore.

1.1.3 Çmimi i Energjisë Elektrike për HEC-et Ekzistues deri në 10 MË

Mbështetur në Ligjin e Energjisë Elektrike dhe aktet e tjera nënligjore, ERE ka autoritetin dhe përgjegjësinë e rishikimit të çmimeve të shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit e vegjel ekzistues (koncesionarë apo privatë) me fuqi të instaluar deri në 10 MË si dhe të prodhuesve të rinj me fuqi të instaluar deri në 15 MË. Për llogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga HEC-et ekzistues është zbatuar “Metodologjia për llogaritjen e çmimit të unifikuar për shitjen e energjisë elektrike për të licensuarit për prodhimin e energjisë nga HEC-et me fuqi të instaluar deri në 10 MË” miratuar nga Bordi i Komisionerëve të ERE-s me vendimin Nr.5, date 26.01.2007.

Bazuar në llogaritjet e bëra nga ERE çmimi i shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga të licensuarit konçesionare dhe privatë, me fuqi të instaluar deri në 10 MË, për periudhën 01 Janar 2012 – 31 Dhjetor 2012 u vendos 7.77 leke/kWh.

1.1.4 Çmimi i Energjisë Elektrike per HEC-et e rinj deri 15 MË

Për llogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga HEC-et e rinj me fuqi të instaluar deri 15 MË është zbatuar "Metodologjia për përcaktimin e çmimit unik të energjisë elektrike të prodhuar nga HEC-et e rinj me fuqi të instaluar deri në 15 MË të dhënë me koncension në baze të Ligjit Nr. 9663, datë 18.12.2006 "Per Konçensionet".

Për të nxitur investimet për shfrytëzimin e rezervës hidroenergjetike të vendit, në të gjitha rrjedhat ujore, Qeveria adoptoi një politikë të tillë që e kushtëzonte çmimin e shitjes së energjisë elektrike, të prodhuar nga këto subjekte të shoqëria publike KESH sh.a., me çmimin mesatar të importit të vitit paraardhës.

Sipas metodologjisë së sipërpërmendur, për llogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike është përdorur formula në vijim;

$$P_u = P_i * 1.1. * R_{ex}$$

ku :

" P_u " është çmimi unik i energjisë elektrike të prodhuar nga HEC-et e rinj me fuqi të instaluar deri në 10 MË,

" P_i " është çmimi mesatar i importit të energjisë elektrike të realizuar nga KESH sh.a. (në funksionin e FPSH) në vitin paraardhës,

" R_{ex} " - norma mesatare e shkëmbimit Lekë/EUR të publikuar nga Banka e Shqipërisë për vitin paraardhës.

Çmimi mesatar i importit gjatë vitit 2011, nga raportimet e KESH sh.a. rezultoi 60.18 Eur/MËh.

Duke zbatuar këtë metodologji llogaritjeje çmimi i energjisë elektrike nga HEC-et e rinj që jepen me koncension me fuqi të instaluar deri në 15 MË rezultoi 9.30 leke/kWh ose 34.9% më i lartë se viti 2011. Një luhatje e tillë e çmimit për këtë kategori HEC-esh vjen si rezultat i variacionit të çmimit të importit të energjisë elektrike në vite të ndryshëm, nuk perputhet me politiken e Qeverisë për nxitjen dhe inkurajimin e investimeve për ndërtimin e këtyre hidrocentraleve.

1.1.5 Tarifa e Shërbimit të Transmetimit të Energjisë Elektrike

Operatori i Sistemit të Transmetimit, i licensuar për veprimtarinë e transmetimit të energjisë elektrike, paraqiti në ERE kërkesën për rritjen e tarifës së transmetimit për periudhën e tretë rregullatore me një rritje prej 22.3 % krahasuar me tarifën aktuale prej 0.6 lekë/kWh.

ERE në llogaritjen e tarifës së transmetimit është mbështetur në metodologjinë e llogaritjes së tarifës së transmetimit të energjisë elektrike, të miratuar me Vendimin nr. 59, datë 29.12.2005, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Tarifa prej 0.65 lekë/kWh, e miratuar me vendimin nr.146 datë 7.12.2011 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, është rezultat i të ardhurave mesatare vjetore të miratura prej 4037 milion leke. Këto të ardhura parashikohet që të mbulojnë të gjitha shpenzimet operative dhe kapitale, duke përfshirë kapitalizimin e kredive të përfunduara dhe saktësimin e detyrimeve që ka OST sh.a. për pagesën e interesit dhe principalit për kredite e vjetra dhe për kredite në implementim.

1.1.6 Tarifa e Shërbimit të Shpërndarjes dhe e Furnizimit me Pakicë të Energjisë Elektrike për Konsumatorët Fundorë për Periudhën 2012-2014.

Shoqëria CEZ Shpërndarje Sh.a. në funksionin e saj të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes si dhe të Furnizuesit Publik me Pakicë paraqiti në ERE aplikimin për tarifën e shpërndarjes së energjisë elektrike si dhe atë të furnizimit me pakicë për klientët tariforë për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014, aplikim i cili reflektoi edhe ndryshimet më të fundit të ligjit nr. 10485, datë 26.11.2011 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9072 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, lidhur me liberalizimin e tregut të energjisë elektrike për përdoruesit e lidhur në rrjetin e TL dhe ata me konsum vjetor më të lartë se 50 milion kWh në të gjitha nivelet e tensionit.

Të ardhurat mesatare vjetore të kerkuara nga CEZ Shpërndarje sh.a. për aktivitetin e shpërndarjes dhe të furnizimit me pakicë për periudhën 2012-2014, janë

në masen 46,609 milion lekë duke mos parashikuar ndryshim të tarifës për veprimtarinë e furnizimit me shumicë (nga KESH-i) dhe të transmetimit (nga OST-ja) gjatë kësaj periudhe. Në përfundim cmimi mesatar me pakicë për klientët tariforë u kerkua që të ishte 9.80 leke /kWh ose 2.83 % më i larte se cmimi mesatar ekzistues.

Shqyrtimi dhe miratimi tarifave të shërbimit të shpërndarjes dhe shitjes me pakicë për periudhën 2012-2014 nga ana e ERE-s u bazua në :

- Vendimin Nr.79 datë 26.06.2008 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës së shpërndarjes së energjisë elektrike”;
- Vendimin Nr. 80, datë 26.6.2008 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës së furnizimit me pakicë së energjisë elektrike”
- Deklaratën Rregullatore të miratuar nga ERE me Vendimin Nr.12, datë 03/03/2009;
- Vendimin Nr.46 të Bordit të Komisionerëve datë 14.06.2010 “Mbi kërkesën e OSSH-se lidhur me nivelin e humbjeve të energjisë për vitin 2008”.
- Vendimin Nr.143 datë 07.12.2011 ”Për shqyrtimin e aplikimit të CEZ Shpërndarje sh.a për miratimin e planit të investimeve periudhën e tretë rregullatore 2012-2014.
- Vendimin Nr.93 datë 30.11.2010 “Për miratimin e programit të uljes së humbjeve totale për tre periudhat e rregullimit”.
- Vendimin nr. 99 datë 30.09.2011 të Bordit të Komisionerëve “Mbi miratimin e Studimit për Borxhin e Keq”

Mbas një shqyrtimi të kujdesshëm të të gjithë elementeve përbërës të kërkesës së shoqërisë CEZ Shpërndarje, përfshirë këtu monitorimin e kryer pranë kompanisë për verifikimin e kostove faktike, sqarimet e marra nëpërmjet informacionit plotësues si dhe në seancat teknike dhe publike, ERE vendosi t’i njohë CEZ Shpërndarje sh.a.:

- të ardhura mesatare vjetore për realizimin e veprimtarisë të furnizimit publik me pakicë, në shumën prej 40,760 milion lekë, duke përfshirë të ardhurat e kërkuara për aktivitetin e gjenerimit, transmetimit dhe shpërndarjes, për periudhën e tretë rregullatore (2012-2014). Nga këto, vlera 21,288 milion lekë i përket aktivitetit të shpërndarjes dhe vlera prej 4,557 milion lekë i përket aktivitetit të furnizimit me pakicë.

- tarifa mesatare e shërbimit të shpërndarjes për periudhën e tretë rregullatore (2012-2014) në vlerën 5.0 leke /kWh ose 20.6% më e ulët nga 6.3 leke për kWh që ishte në vitin 2011. Kjo tarifë reflekton reduktimin e shpenzimeve operative (OPEX) prej 5,586 milion lekë për periudhën rregullatore 2012-2014, reduktim i cili u gjykua si i arsyeshëm si pasojë e mosargumentimit të kërkeses për të ardhura të paraqitur nga kompania.
- Tarifa mesatare e furnizimit me pakicë për konsumatorët tariforë reflekton reduktimin e kërkesës për të ardhura të kërkuara nga CEZ Shpërndarje sh.a., në funksionin e tij si furnizues me pakicë, në shumën 9,772 milion lekë për periudhën 2012-2014, nga të cilat reduktimi i shpenzimeve operative për shumën 1,386 milion lekë dhe 8,386 milion lekë reduktimi i të ardhurave të kërkuara për mbulimin e borxhit të keq (pa përfshirë kompensimin e viteve paraardhëse).
- Tarifat e aksesit për përdoruesit që furnizohen në rrjetin TM dhe TU respektivisht në vlerën : 3.2 lekë/kWh dhe 5.4 lekë/kWh;

Në përfundim të analizave dhe metodologjisë së përdorur cmimi mesatar me pakicë për konsumatorët tariforë rezultoi 9.53 leke/kWh, që është i njëjtë me cmimin mesatar të miratuar nga ERE për vitin 2011. Ky çmim mesatar shpërndahet tek grupet e konsumatorëve tariforë sipas tabelës -12-

Tabela 11 Tarifat e shërbimeve dhe të shitjeve me pakicë të energjisë elektrike për vitet 2012-2014

Tarifat e shërbimeve dhe të shitjes me pakice të energjisë elektrike per periudhen e trete rregullatore 2012-2014

Niveli / Tensionit	Kategorite e Konsumatoreve	Viti 2012-2014	
		Cmimi (leke/kWh)	Cmimi I energjise ne pik (leke/kWh)
TENSIONI I MASEM	Kliente te furnizuar ne 35 kV		
	Industri	8.50	9.78
	Tregeti & shërbime	8.50	9.78
	Bujqesi	8.50	9.78
	Te tjere	8.50	9.78
	Kliente te furnizuar ne 20/10/6 kV		
	Industri	9.10	10.47
	Tregeti & shërbime	10.00	11.50
	Furra buke, prodhim mielli	7.10	8.17
	Bujqesi	8.70	10.01
Te tjere	9.70	11.16	
Buxhetore	11.50	13.23	
TENSIONI I ULËT	Kliente te furnizuar ne TU		
	Industri	10.50	12.08
	Tregeti & shërbime	12.20	14.03
	Furra buke, prodhim mielli	7.60	8.74
	Bujqesi	10.50	12.08
	Te tjere	12.00	13.80
	Buxhetore	14.00	16.10
	Familjare		
	Biloku I pare deri ne 300 kWh	7.70	
	Biloku I dyte mbi 300 kWh	13.50	
	Tarifa fikse e shërbimit per leximin "zero" (leke/muaj)	200	
	Tarifa per konsumin e energjise elektrike ne ambientet e perbashketa (shkalle, pompe, ashensor, etj (leke/kWh)	8.00	
	* Cmimi I energjise reaktive do te jete 15% e cmimit te energjise aktive		

Sikurse shihet në tabelën e mësipërme, vazhdon të ruhet edhe për periudhën 2012-2014, faturimi me blloqe për konsumatorët familjarë, duke respektuar të njëjtin kufi prej 300 kWh për bllokun e parë dhe mbi 300 kWh për bllokun e dytë.

Në grafikun e figurës -42- është paraqitur ecuria e çmimeve të energjisë elektrike të miratuara nga ERE gjatë periudhës 2008-2014.




Figure 42 Çmimet e miratuara nga ERE për periudhën 2008-2014

1.2 Shqyrtimi i Studimit mbi Nivelin e Borxhit të Keq në Arkëtimet e Faturave të Energjisë Elektrike.

Një nga treguesit e rëndësishëm që ndikon nivelin e çmimeve të energjisë elektrike të konsumatorëve tariforë, është niveli i Borxhit të Keq. Deklarata Rregullatore, në pikën Pika 5.2, ka përcaktuar mënyrën e llogaritjes së këtij treguesi si përqindje ndaj të ardhurave totale të Furnizuesit Publik me Pakicë si dhe objektivat e uljes së tij përgjatë periudhave të rregullimit nisur nga niveli baze prej 14% i njohur (i pranuar) për vitin 2008 si viti para privatizimit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH).

Më tej për periudhat e rregullimit duke filluar nga viti 2009, si viti i parë i privatizimit nivelet e Borxhit të Keq u përcaktuan si më poshtë:

- 14% për vitin 2009, pra një nivel i barabartë me atë të vitit 2008
- 13% për vitin 2010, 1 pikë përqind ulje kundrejt vitit 2009

Për çdo vit të periudhës 2011-2014 në Deklaratën Rregullatore, parashikohet një ulje e Borxhit të Keq prej një pike përqindje nisur nga niveli aktual për vitin 2010.

Sipas Deklaratës Rregullatore, OSSH në funksion të veprimtarisë së shitjes me pakicë, do të kryente deri më 31 Korrik 2011, një studim të detajuar për Borxhin e Keq për të përcaktuar (i) metodologjinë e llogaritjes së Borxhit të Keq dhe (ii) Nivelet Aktuale të Borxhit të Keq për vitet 2008, 2009 dhe 2010.

CEZ Shpërndarje sh.a. paraqiti për miratim pranë ERE-s Studimin Borxhit të Keq, i cili u përgatit nga kompania Deloitte - ekspert financiar i pavarur. Sipas këtij studimi nivelet e përcaktuara të Borxhit të Keq, për vitet 2008, 2009, 2010 ishin respektivisht 18.39%, 20.71% dhe 23.25%.

Pas shqyrtimit të këtij studimi, ERE vendosi miratimin në parim të Studimit të Borxhit të Keq me korrektimet si më poshtë:

- Metodologjia e llogaritjes së Borxhit të Keq është një vlerësim i llogarive të arkëtueshme që merr parasysh edhe:
 - Kategorinë e debisë sipas llojit të konsumatorit (buxhetore, jobuxhetore private etj).
 - Moshën e debisë së konsumatorit
 - Periudhën e furnizimit të konsumatorëve debitorë
 - Performancën e kompanisë për mosrëndimin e tarifës së shitjes së energjisë elektrike me kosto të detyrimeve të papaguara nga të tretë.
- Nivelet aktuale të Borxhit të Keq për vitet 2008, 2009, 2010 janë respektivisht 14%, 14% dhe 13 %.
- Borxhi i Keq do të llogaritet si përqindje mbi shumën e të ardhurave të Furnizuesit Publik me Pakicë sipas pikës 5.2 të Deklaratës Rregullatore.

Në përcaktimin në këtë vendim të niveleve respektive prej 14%, 14% dhe 13% për vitet 2008, 2009 dhe 2010 u pranua metodologjia e përdorur nga kompania konsulente Deloitte ndërsa për të dhënat e paraqitura në studim u përdor supozimi:

- Klientët buxhetorë nuk do të konsiderohen debitorë, pasi detyrimet e tyre janë të njohura dhe do të paguhen nga shteti shqiptar.
- Për debitorët familjarë dhe privatë u supozua se do të kishte shpresë për një përqindje të caktuar arkëtimi edhe në vitet pasardhëse.
- ERE, në ndryshim nga sa paraqitej në studim, llogariti Borxhin e Keq si përqindje mbi shumën e të ardhurave të Furnizuesit Publik me Pakicë sipas pikës 5.2 të Deklaratës Rregullatore.

Kompania CEZ Shpërndarje ka ankimuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, Vendimin nr. 99 datë 30.09.2011, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, “Mbi miratimin e studimit të Borxhit të Keq”. Objekti i kësaj padie është shpallja si i pavlefshëm i këtij vendimi me arsyen se ERE nuk ka kompetenca që të ndryshojë konkluzionet e studimit mbi Borxhin e Keq, por thjesht ta miratojë ashtu siç është ose jo.

Po ashtu, kompania CEZ Shpërndarje ka ankimuar në ERE vendimet nr. 147 dhe 148 date 7.12.2011 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s në lidhje me përcaktimin e tarifave të shpërndarjes dhe çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tariforë për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014. Ky ankimim konsistoi kryesisht në refuzimin e reduktimit të kërkesës së të ardhurave për mbulimin e shpenzimeve operative (OPEX) të kompanisë për periudhën përkatëse rregullatore. Vendimmarrja e ERE-s për trajtimin e këtij ankimi ishte produkt edhe i vlerësimit të Panelit Rishikues të ngritur me kërkesë të CEZ Shpërndarje në bazë të Marrëveshjes së Mbështetjes Qeveritare (Government Support Agreement) si pjesë e Ligjit Nr. 10126, datë 11.05.2009, “Për Miratimin e Marrëveshjes së Garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për Garantimin e Projektit të Privatizimit të OSSH sh.a”. Bazuar në analizën e vet dhe në sa rekomanduar nga Paneli Rishikues ERE vendosi mos ndryshimin e vendimeve të ankimuara.

Aktualisht tarifa e aktivitetit të shpërndarjes dhe furnizimit publik me pakicë sikurse dhe Borxhi i Keq janë në proces trajtimi në kuadër të Marrëveshjes së Garancisë së Riskut Pjesor (PRG) dhe për këtë arsye kompania CEZ Shpërndarje ka nisur procedurat për aktivizimin e PRG-se sipas të cilës kompania garantohej në

masën 60 milion Euro për dëmet e mundshme që do të pranohen sipas procesit të parashikuar në paketën e privatizimit.

1.3 Çmimet dhe Tarifat e Energjisë Elektrike në Vendet e Rajonit, viti 2011

Baza e të dhënave e Shoqatës Rajonale të Rregullatorëve të Energjisë (ERRA) për tarifat e energjisë është burimi kryesor i të dhënave zyrtare të energjisë elektrike në vendet e Europës Qëndrore / Lindore. Ajo përmban të dhënat tremujore nga viti 2000 deri më sot dhe mbulon 28 vende (Shqipëria, Bullgaria, Kroacia, Estonia, Gjeorgjia, Hungaria, Moldavia, Polonia, Rumania, Rusia, Turqia, Ukrainë, etj). Në grafikun e figurës -43- janë paraqitur tarifat e energjisë elektrike pas taksimit (TVSH-se) për konsumatorët jo familjarë, për të gjitha vendet e ERRA-s, në Euro cent/kWh. Çmimi mesatar i energjisë elektrike për konsumatorët jo familjarë për vendet e rajonit është 9.44 Eurocent/KWh.




Figure 43 Çmimet e energjisë elektrike të konsumatorëve jo familjarë në vendet e rajonit

Në grafikun e figurës -44-, janë paraqitur çmimet e energjisë elektrike për konsumatorët familjarë, për të gjitha vendet e ERA-s, në eurocent/kWh. Çmimi mesatar i energjisë elektrike për konsumatorët familjarë për vendet e rajonit është 9.37 Eurocent/KWh.




Figure 44 Çmimet e energjisë elektrike të konsumatorëve familjarë në vendet e rajonit

Kapitulli II

Licensimi dhe Monitorimi i Veprimtarive në Tregun e Energjisë Elektrike

Licensimi dhe Monitorimi i Veprimtarive në Tregun e Energjisë Elektrike

Gjatë vitit 2011, ERE ka shqyrtuar 49 aplikime për:

- Liçensim në aktivitetet e sektorit të energjisë elektrike;
- Modifikimin e liçensave ekzistuese;
- Kualifikimin e impianteve si prodhues të energjisë së rinovueshme.

Bordi i Komisionerëve ka vendosur liçensimin e 39 subjekteve juridike, ndërsa 10 të tjera janë në proces liçensimi.

Janë kryer procedurat dhe është dhënë statusi i klientit të kualifikuar, nga ana e Bordit të Komisionerëve, për një subjekt.

Në tabelën -13- paraqiten liçensimet e kryera sipas aktiviteteve në sektorin e energjisë elektrike, gjatë vitit 2011.

Tabela 12 Liçensimet e kryera, sipas aktiviteteve

AKTIVITETI I LICENSUAR	Nr. i LIÇENSAVE TË MIRATUARA
Prodhim i energjisë elektrike	20
Furnizues i kualifikuar i energjisë elektrike	4
Tregtues i energjisë elektrike	15
Modifikim i Liçensës ekzistuese	2

1.1 Liçensimet në Veprimtarinë e Prodhimit të Energjisë Elektrike gjatë Vitit 2011

Pjesa më e madhe e liçensave të dhëna nga ERE i përkasin aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike.

Janë liçensuar për aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike 20 shoqëri private në 58 centrale elektrike (Hec-e). Fuqia e instaluar e këtyre HEC-eve është 216 MW. Nga këto 20 subjekte:

- 4 prej tyre janë me kapacitet total deri në 1MW
- 6 prej tyre janë me kapacitet deri në 5 MW
- 4 prej tyre janë me kapacitet deri në 10 MW
- 2 prej tyre janë me kapacitet deri në 15 MW
- 4 prej tyre janë me kapacitet mbi 15 MW

Janë në proces liçensimi 6 shoqëri të tjera për aktivitetin e Prodhimit të energjisë elektrike nëpërmjet 7 centrale elektrike (Hec-e), me një fuqi të instaluar 24.02 MW.

Të Liçensuarit në aktivitetin e Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Kontratat e Konçesionit gjatë vitit 2011

Tabela 13 Të Liçensuarit në aktivitetin e Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Kontratat e Konçesionit gjatë 2011

Nr	SUBJEKTI	LLOJI I LICENES	VENDIMI	HEC DHE KAPACITETI
1	“Hec Vlushe” shpk	Prodhim	Vendimi Nr. 23, date 10.03.2011	Hec –Vlushe me fuqi 14.2 MW
2	“Energy Partner –Al” shpk	Prodhim	Vendimi Nr. 7, date 02.02.2011	Hec – Shkalle me fuqi 1.3 MW; Hec –Cerunje me fuqi 2.3 MW; Hec –Plesha me fuqi 2.8 MW; Hec – Bejni 1 dhe Bejni 2 me fuqi 3.6 MW ; Hec –Klos me fuqi 2.6 Mw
3	“Hec Dunice” shpk	Prodhim	Vendimi Nr. 27, date 10.03.2011	Hec – Trebinje 1 me fuqi 0.39 MW; Hec – Treginjë 2, me fuqi 0.68 MW; Hec – Dunice me fuqi 0.75 MW; Hec - Potgozhan me fuqi 0.692 MW; Hec – Kalivac me fuqi 0.73 MW
4	“Korkis -2009” shpk	Prodhim	Vendimi Nr.21,	Hec – Belesova 1 me fuqi 0.150 MW

			date 04.03.2011	Hec –Belasova 2 me fuqi 0.280 MW
5	“Ferar Energy” shpk	Prodhim	Vendimi Nr. 4, date 25.01.2011	Hec –Benca me fuqi 2.070 MW; Hec –Tepelena me fuqi 3.420 MW
6	“Hec –Dragoshtunje” shpk	Prodhim	Vendimi Nr. 25, date 10.03.2011	Hec – Zanore me fuqi 1.2MW; Hec – Dragoshtunje me fuqi 3.1 MW Hec – Ura me fuqi 0.8 MW; Hec – Sheja me fuqi 1.6 MW;
7	“HP Ostrovica Energy” shpk	Prodhim	Vendimi Nr. 40, date 15.04.2011	Hec FAQE KUQ 1 me fuqi 3 MW ; Hec FAQE KUQ 2 me fuqi 3.4 MW
8	“Hidropower Elektrike” shpk	Prodhim	Vendimi Nr. 59, date 22.06.2011	Hec -Sllabinja 2A me fuqi 2 MW; Hec -Sllabinja 2B me fuqi 1.6 MW ; Hec -Sllabinja 2C me fuqi 1.8 MW ; Hec -Sllabinja 2D me fuqi 5 MW; Hec -Sllabinja 2E me fuqi 3.4 MW
9	“DN&NAT Energy” shpk	Prodhim	Vendimi Nr. 58, date 22.06.2011	Hec - Kumbull Merkurth me fuqi 0.63 MW
10	“Selisht ” shpk	Prodhim	Vendimi Nr. 60, date 22.06.2011	Hec - Selishte me fuqi 2 MW
11	“Idro Energjia Pulita” shpk	Prodhim	Vendimi Nr. 66, date 27.07.2011	Langarica 3 me fuqi 2.2MW Gostivisht me fuqi 1.3 MW Ura e Dashit me fuqi 1.2 MW
12	“Bekim Energjitik” shpk	Prodhim	Vendimi Nr. 61, date 13.07.2011	Kryezi 1 me fuqi 0.6 MW ; Kryezi I Eperm me fuqi 0.2 MW
13	“Euron Energy Group” shpk	Prodhim	Vendimi Nr. 87, date 26.09.2011	Hec- Orgjos i Ri me fuqi 4.8 MW ; Hec -Bele 1 me fuqi 5 MW ; Hec- Bele 2 me fuqi 11 MW ; Hec - TopoJan 1 me fuqi 2.9 MW ; Hec- TopoJan 2 me fuqi 5.8 MW
14	“Erald Energjitik” shpk	Prodhim	Vendimi Nr. 91, date 26.09.2011	Hec -Shemri me fuqi 1 MW ; Hec - Mgulle me fuqi 0.28 MW
15	“Erma -MP” shpk	Prodhim	Vendimi Nr. 105, date 17.10.2011	Hec –Carshove me fuqi 1.5MW
16	“Dosku Energy” shpk	Prodhim	Vendimi Nr. 67, date 27.07.2011	Hec –Gizavesh me fuqi 0.5 MW
17	“DITEKO” shpk	Prodhim	Vendimi Nr. 114, date 16.11.2011	Hec -Borove me fuqi 1.921 MW; Hec- Zabzun me fuqi 0.301MW ; Hec- Sebisht me fuqi 2.835 MW ; Hec- Prodan 1 me fuqi 0.38MW ; Hec - Prodan 2 me fuqi 0.801 MW; Hec - Okshtun Ekologjik me fuqi 0.45 Mw; Hec- Ternove me fuqi 0.921 Mw; Hec -Okshtun me fuqi 10 MW ; Hec- Lubalesh 1 me fuqi 4.6 Mw ; Hec Lubalesh 2 me fuqi 5.1Mw;

				Hec- Gjorice me fuqi 4.18Mw
18	“Hec –Lanabregas” sha	Prodhim	Vendimi Nr. 134, date 06.12.2011	Hec - Lanagregas me fuqi 5 Mw
19	“Hec “Bistrica 1 dhe 2”sha	Prodhim	Vendimi Nr. 136, date 06.12.2011	Bistrica 1 me fuqi 22.5 MW; Bistrica 2me fuqi 5 MW
20	“Hec –Ulez –Shkopet” sha	Prodhim	Vendimi Nr. 132, date 06.12.2011	Hec/ Ulez me fuqi 24 MW ; Hec /Shkopet me fuqi 24 MW
21	Snow Energy	Prodhim	Ne process licensimi	Hec/Koka 1 me fuqi 3.2 MW
22	Stravaj Energy	Prodhim	Ne process licensimi	Hec / Stravaj me fuqi 3.6 MW
23	Albanian Power “	Prodhim	Ne process licensimi	Hec / Martanesh me fuqi 10.5 MW
24	Hydro Power Plant Korca”	Prodhim	Ne proces licensimi	Hec /Verba 1 me fuqi 2 Mw Hec / Verba 2 me fuqi 3 Mw
25	Hydro Salillari	Prodhim	Ne process licensimi	Hec/Vertop me fuqi 1.52 MW
26	Peshku Picar 1” shpk	Prodhim	Ne process licensimi	Hec /Picar me fuqi 0.2MW

1.2 Licensimi në Aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike

Gjatë vitit 2011 janë licensuar 15 subjekte, nga të cilat 13 janë licensuar me afat 30 vjeçar për arsye se kanë patur licensë edhe në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike. Ndërsa 2 subjektet e tjera kanë marrë licensa me afat vlefshmërie 5 vjet.

Të licensuarit në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike për vitin 2011 janë:

Tabela 14 Të licensuarit në aktivitetin e Tregtimit te Energjisë Elektrike për vitin 2011

Nr.	Emri i Subjektit	Veprimtaria e Licensuar	Data e miratimit te licenses
1	“Hec Vlushë” shpk	Tregetim	Vendimi Nr. 24, date 10.03.2011
2.	“Energy Partner –Al” shpk	Tregetim	Vendimi Nr. 8, date 02.02.2011
3.	“Hec Dunice” shpk	Tregetim	Vendimi Nr. 28, date 10.03.2011
4.	“Energy Supply –Al” shpk	Tregetim	Vendimi Nr.6, date 02.02.2011
5.	“GSA” shpk	Tregetim	Vendimi Nr. 57, date 22.06.2011
6.	“Hec –Dragoshtunje” shpk	Tregetim	Vendimi Nr. 26, date 10.03.2011

7.	“HP Ostrovica Energy” shpk	Tregetim	Vendimi Nr. 48, date 24.05.2011
8.	“Euron Energy Group” shpk	Tregetim	Vendimi Nr. 88, date 26.09.2011
9.	“Erma-MP” shpk	Tregetim	Vendimi Nr.106, date 17.10.2011
10	“Diteko” shpk	Tregetim	Vendimi Nr. 115, date 16.11.2011
11	“Albanian Green Energy” shpk	Tregetim	Vendimi Nr. 121, date 18.11.2011
12	“Balkane Green Energy” shpk	Tregetim	Vendimi Nr. 127, date 02.12.2011
13	“Hec Lanabregas” sha	Tregetim	Vendimi Nr. 135, date 06.12.2011
14	“Hec Ulez-Shkopet” sha	Tregetim	Vendimi Nr. 133, date 06.12.2011
15	“Hec Bistrica 1 dhe Bistrica 2”sha	Tregetim	Vendimi Nr.137,d ate 06.12.2011
16	“ Malido Energy” shpk	Tregetim	Vendimi Nr. 5, date 16.01.2012
17	Hydro Salillari “ shpk	Tregetim	Ne process licesnimi
18	Stravaj Energy” shpk	Tregetim	Ne process licesnimi

1.3 Liçensimi në Aktivitetin e Furnizuesve të Kualifikuar të Energjisë Elektrike

Gjatë vitit 2011 janë liçensuar për aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar gjithsej 4 subjekte me afat vlefshmërie të liçensës prej 5 vjetësh.

Furnizuesit e kualifikuar të energjisë elektrike të liçensuar gjatë vitit 2011 janë paraqitur në tabelën e mëposhtëme:

Tabela 15 Furnizuesit e kualifikuar të energjisë elektrike të liçensuar gjatë vitit 2011

Nr.	Emri i Subjektit	Data e miratimit te licenses	Data perfundimit te licenses
1	“Energy Supply AP” shpk	Vendimi Nr. 05. date 02.02.2011	01.02.2016
2.	“Rudnap Energy Tirana” shpk	Vendimi Nr. 20, date 04.03.2011	03.03.2016

3.	“Albanian Green Energy” shpk	Vendimi Nr. 125, date 02.12.2011	02.12.2016
4.	“Ballkan Green Energy” shpk	Vendimi Nr. 126, date 02.12.2011	02.12.2016
5.	“Hydro Salillari “ shpk	Ne process licensimi	

Të licensuar gjithsej në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike janë 11 subjekte.

Kualifikimi i impianteve prodhuese si burime të energjisë së Rinovueshme

Për vitin 2011 nga ana e ERE –s janë kualifikuar si burime të rinovueshme energjie gjithsej 6 subjekte për 15 Hec–e, me kapacitet total 180 MW

Impiantet e kualifikuara si Burime të Rinovueshme Energjie gjatë vitit 2011

Tabela 16 Impiantet e kualifikuara si burime të rinovueshme energjie gjatë vitit 2011

Nr.	Emri I Subjektit	Vendimi i Bordit të Komisionereve të ERE-s	Asetet e Kualifikuara si burime të rinovueshme
1	"Energji ASHTA" shpk	Vendim Nr. 56, date 22.06.2011	Hec -Ashta me fuqi 48.2MW
2.	“Kalivac Green Energy” shpk	Vendim Nr. 81, date 12.09.2011	Hec -Kalivac me fuqi 93.9 MW
3.	“DITEKO” shpk	Vendim Nr. 116, date 16.11.2011	Hec -Borove me fuqi 1.921 MW ;Hec- Zabzun me fuqi 0.301MW ; Hec- Sebisht me fuqi 2.835 MW; Hec- Prodan 1 me fuqi 0.38MW; Hec - Prodan 2 me fuqi 0.801 MW ; Hec - Okstun/Ekologjik me fuqi 0.45 Mw; Oshtune me fuqi 10 MW; Hec- Ternove me fuqi 0.921 Mw; Hec- Lubalesh 1 me fuqi 4.6 Mw; Hec- Lubalesh 2 me fuqi 5.1Mw; Hec- Gjorice me fuqi 4.18Mw
4.	“HP Ostrovica Energy” shpk	Vendim Nr. 103, date 17.10.2011	Hec -Faqe Kuq 1 me fuqi 3 Mw Hec-Faqe Kuq 2 me fuqi 3.4 MW
5.	“Malido Energy” shpk	Vendimi 6, date 16.01.2012	Hec -Klos me fuqi 1.95 Mw
6.	Hydro Salillari	Ne process kualifikimi	Hec – Vertop me fuqi 1.52 MW

Modifikimi i Licencave

ERE ka trajtuar 2 kërkesa për modifikim liçense. Kërkesa për modifikimin e liçensave nga këto subjekte është bërë për shkak të rritjes së fuqisë së instaluar të impianteve.

Tabela 17 Modifikimi i Liçensave

Subjekti	Impianti	Fuqia e instaluar	
		Ishte	U bë
“Energo –Sas” shpk	Hec - Sasaj	7 MW	8.6 Mw
“Wenerg” sha	Hec – Dardha 1	4 Mw	5.8 MW

1. Monitorimi i Tregut të Energjisë Elektrike

Në zbatim të ligjit Nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, neni 8, pika 2 gërmat f) dhe g) si dhe neni 63, ERE-ja ka autoritetin dhe detyrimin për të monitoruar, kontrolluar dhe inspektuar shërbimet e operatoreve të liçensuar në lidhje me respektimin e detyrimeve ligjore si dhe zbatimin e rregullave, vendimeve dhe urdhërave të ERE-s.

2.1 Parimet e Monitorimit të Tregut të Energjisë Elektrike

Monitorimet janë kryer bazuar në Rregullat e Tregut si dhe të rregulloreve përkatëse që veprojnë pjesëmarrësit e tregut.

Këto monitorime janë kryer bazuar në plane tematike paraprahe dhe organizuar në mënyrë të tillë që të monitorohen në vazhdimësi rezultatet e pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike.

Proçesi i monitorimit është kryer duke ndjekur periodikisht hapat e mëposhtme :

- Mbledhja dhe përpunimi i rezultateve periodike(mujore) dhe informacioneve.
- Përpunimi i rezultateve dhe përcaktimi i vlerave të indikatorëve të performancës.
- Raportim i analizës së treguesve të performancës së pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike pranë Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
- Diskutim i zgjeruar i problematikave në mbledhjet periodike të Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
- Përcaktim i qëndrimit të ERE-s lidhur me performancën e operatoreve si dhe përgatitja e qëndrimeve dhe rekomandimeve për to.
- Identifikim i çështjeve për monitorim në terren.
- Kryerja e monitorimeve në terren dhe analizimi i tyre.
- Përcaktim i qëndrimit dhe rekomandimeve të ERE-s lidhur me konstatimet nga monitorimet.

Numri Urdherit	SUBJEKTI MONITORIMIT	Komp
19	Imp/Eksp e KESH gjate muajit Janar 2011	KESH
20	Humbjet ne OSSH	CEZ
53	Monitorim N/St I ri Gjirokaster	CEZ
57	Mon H/C te Hydro Power Pulita	H/C-Vegjel
65	Mon Mbi Furn,Matjen,Kons Cilesine	CEZ
65/1	Verifikim I gjetjeve (problematikave)	CEZ
68	Mon H/C te EMIKEL	H/C-Vegjel
70	Mon KESH Transacionet e Imp/Eks Qershor	KESH
73	Mon H/C te AMAL	H/C-Vegjel
77	Mon Mbi Faturimin,Billing,Nderpr,Kons, Cilesine	CEZ
89	Mon Performances dhe gadishmerise	TEC-Vlora
96	Mon. Shkakut te nderprerjeve JugPerendim	CEZ
100	Verifikim I faturimit te energjise reaktive Elbasan	ItalDruri sha
111	Verifikim ne kuder te miratimit te Planit te Inv.	CEZ
115	Metodologjia e llog se demit ekonomik	CEZ
116	Monit I Planit te Investimeve te per.trete.rregull.	CEZ
120	Verifikim Detyrim te prapambetura CEZ-Albpetrol	Albpetrol sha
123	Verifikim Mosfurnizimi I fshatit Stajke Bushat	CEZ
125	Mon.mbi furnizim/ark debitoret private2008-2011	CEZ
126	Verifikim faturimi Brigada Logjistike Vaqarr	CEZ
130	Verifikim ne kuder te miratimit te Planit te Inv.	KESH
132	Mon.Procedurave te prokurimit te Energjise	CEZ
133	Verifikim I lidhjes TM se subjektit Xhelips shkozet	CEZ
134	Mon I Investimeve te OST 2010-2011	OST
135	Monitorimi cash-flow 2010-2011ne CEZ-Shpernd.	CEZ
136	Mon mbi blerjet e enegjise nga KESH shtator 2011	KESH
137	Mon I Investimeve te KESH 2010-2011	KESH
138	Mon I Kredive dhe Overdrafteve te KESH	KESH
139	Mon. I Alokimit te Kapaciteteve te Interkoneks.	OST
140	Funksionimi I Tregut nga pikveshtrimi OST	OST
143	Verifikim ne vend I disa ankesave te konsumat	CEZ
144	Verifikim I mosfurnizimit ne fshatin Kastriot Diber	CEZ
145	Verifikim Bilancit energj.9-mujor+En.e pamatur	CEZ
146	Verifikim Bilancit energj.9-mujor OST	OST
150	Verifikim problemesh te furnizimit Kuqan-Tropoj	CEZ
151	Verifikim I furnizimit te zones se BajramCurrit	CEZ
152	Verifikim mosfaturim/lexim fshati Piraj	CEZ
158	Mon.i aplikimit te demit ekonomik Sh,FR,EL,Ko	CEZ
159	Zbatimi I metodol. Se fatur.te demit Ekonomik	CEZ
160	Verifikim mbi hapjen e kontratave provizore	CEZ
169	Verifikim mbifaturimi ne Gjyk.Kushtetuse	CEZ
170	Zbatimi rekomandimeve per trajt. e konsum.	CEZ
171	Mon. mbi ankandet e Kapaciteteve e kontratat	OST
	43 total 24 CEZ, 6 KESH, 5OST,8 te tjera.	

2.2 Monitorimi i KESH Sh.a.

Gjatë vitit 2011, ERE ka kryer 6 monitorime për aktivitetin e prodhimit dhe eksport-importit të energjisë elektrike.

Nga monitorimet është vënë re se procesi i blerjeve dhe shitjeve të energjisë elektrike është bërë në përputhje me Rregullat e Shitjes dhe Blerjes së Energjisë Elektrike të miratuara nga ERE.

2.3 Monitorimi i OST Sh.a.

Ne vitin 2011 janë kryer në OST Sh.a 5 monitorime për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga licënsimi si dhe Rregullat e Tregut.

Nga këto monitorime është vënë re se nga ana e OST Sh.a është kryer riorganizimi i strukturës së operatorit të tregut.

Gjatë vitit 2011, janë aplikuar “ Rregullat për Garancitë Financiare për Regjistrimin në Tregun e Energjisë Elektrike”, “Marrëveshja për Pjesëmarrje në Treg” si dhe “Rregullorja për Procedurën e Regjistrimit në Tregun e Energjisë Elektrike”. Këto rregulla bëjnë të mundur zhvillimin e një tregu transparent dhe funksional në zbatim të Direktiva të Bashkimit Europian.

2.4 Monitorimi i CEZ Shpërndarje Sh.a.

Një pjesëmarrës i rëndësishëm i Tregut të Energjisë Elektrike është kompania CEZ Shpërndarje Sh.a. i cili realizon aktivitetin e shpërndarjes dhe furnizuesit publik me pakicë.

Gjatë vitit 2011 janë kryer 24 monitorime për të verifikuar aktivitetin e licënsuar të shpërndarjes e furnizimit, të cilat kanë konsistuar në:

- Verifikimin e realizimit të planit të investimeve;
- Procedurat e prokurimit të humbjeve;
- Procedurat ndjekjes se humbjeve dhe faturimeve të energjisë elektrike;
- Verifikimin e bilancit të energjisë elektrike;

Nga këto monitorime, nder të tjera, është vënë re:

- Realizimi i investimeve ka qenë në mase të ulët rreth 20%, të planit të investimeve të miratuara nga ERE për vitin 2011. Këtë fakt, ERE e ka reflektuar në tarifën e miratuar për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014.
- Prokurimi i energjisë për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes, nuk ka reflektuar sasinë e humbjeve reale në sistem. Për këtë qëllim, me insistimin e ERE-s, palët në këtë proces aktualisht po kryejnë rakordimet përkatëse.
- Gjatë monitorimeve janë verifikuar ndryshimet për sa i përket faturimit, ku në shitjet e energjisë elektrike të faturuara përfshihet sasi energjie që i përketin dëmit ekonomik dhe energjisë së pamatur. Saktësimi i këtyre shifrave dhe rezultatet e analizuara, janë reflektuar në tarifën e miratuar nga ERE.
- Zbatimi i rregullave dhe procedurave të importeve të realizuara nga CEZ Shpërndarje, e cila në zbatim të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike ka përgjegjësinë për importin e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në Rrjetin e Shpërndarjes të cilat kanë rezultuar në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në Deklaratën Rregullatore.

Kapitulli III

Aktiviteti i ERE në Zhvillimin e Legjislacionit Sekondar dhe ndryshimet e tjera ligjore të ndodhura gjatë vitit 2011

Një pjesë e rëndësishme e veprimtarisë së ERE-s është edhe përpilimi i legjislacionit sekondar që përbën edhe kuadrin rregullator në Sektorin e Energjisë. Ky kuadër është plotësuar nga ERE në një pjesë të konsiderueshme dhe aktualisht janë miratuar gjate vitit 2011 apo janë ende në proces përpunimi nga ERE disa akte me mjaft rëndësi kryesisht për zhvillimet e tregut të energjisë .

Në çdo rast ERE në ushtrimin e përgjegjësisë për miratimin e akteve nënligjore të parashikuara në ligjin nr. 9072, date 22.05.2003, është mbështetur në parimet e konsultimeve publike, informimit të publikut, dhe pjesëmarrësve të tregut për proceset vendimmarrëse të saj me qëllim që këto vendimmarrje të reflektojnë ekuilibrimin e interesave të shtetit, konsumatorëve dhe investitorëve në sektorin e energjisë.

Po ashtu në miratimin e akteve nënligjore ERE është mbështetur edhe në angazhimet e marra nga vendi ynë në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjisë Elektrike duke synuar kështu reflektimin në aktet nënligjore të miratuara prej ERE-s, të rekomandimeve dhe detyrimeve në kuadër të angazhimeve të vendit për integrimin europian. Në vijim të çdo vendimmarrje të ERE-s për miratimin e akteve nënligjore normative sikurse edhe atyre individuale të cilat nuk kanë të bëjnë me veprimtarinë e brendshme të saj, ERE ka publikuar këto akte në Fletoren Zyrtare si dhe në faqen e web-it të ERE-s.

Në mënyrë më të detajuar gjatë vitit 2011, ERE ka përpunuar aktet rregullatore që vijojnë më poshtë të grupuara në:

- Aktet nënligjore të miratuara nga ERE,
- Ndryshime në legjislacionin primar të Sektorit të Energjisë Elektrike.

1. Aktet Nënligjore të Miratuara nga ERE

Gjatë vitit 2011 ERE ka miratuar rreth 11 akte nënligjore. Më poshtë janë paraqitur në mënyrë të detajuar përshkrimi për çdo akt të miratuar gjatë vitit 2011.

1.1 Rregullat dhe Procedurat e Shitjes së Energjisë Elektrike

Me vendimin nr. 1, datë 10.01.2011, në cilësinë e organit përgjegjës për miratimin e Rregullave dhe procedurave me të cilat KESH sh.a kryhen transaksionet e blerjes dhe shitjes së energjisë elektrike (nenit 8, pika 2 gërma "1", e Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", të ndryshuar, dhe VKM Nr. 338, datë 19.03.2008 "Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike", i ndryshuar), ERE rishikoi "Rregullat dhe Procedurat e Shitjes së Energjisë Elektrike".

Rishikimi i këtyre rregullave erdhi si një kërkesë e KESH sh.a dhe një analize nga ERE e problematikave të konstatuara gjatë zbatimit në praktike të proceseve të shitjes së energjisë elektrike. Pikërisht me qëllim eliminimin e kufizimeve të mundshme në procedurat e shitjes së energjisë elektrike nga KESH sh.a, si pasojë e paqendrueshmerisë së situatës hidrike në vend e cila shumë here dikton përfshirjen e KESH vetëm në transaksionet e shitjes së energjisë elektrike dhe jo atë të blerjes ERE vendosi që procesi i shitjes mos të kushtezohet detyrimisht me kryerjen me parë të një procesi blerjeje të energjisë elektrike. Përmes këtyre ndryshimeve gjithashtu saktësohet se KESH sh.a. është përgjegjës për përcaktimin në sasi dhe në kapacitet, të energjisë elektrike që do të shitet sipas procedurave të kësaj rregulloreje si dhe për përcaktimin e periudhës kohore dhe programit të livrimit të saj e që bazohet mbi optimizimin e përdorimit të burimeve energjetike sipas planifikimit të kryer nga KESH sh.a. Po ashtu ndryshimet synojnë të krijojnë me shumë fleksibilitet në procedurat e shitjes së energjisë elektrike duke lejuar KESH sh.a të shesë energji elektrike edhe si rezultat i negociatave direkte me kompanitë publike të furnizimit në rajon dhe nga ana tjetër me ndryshimet e bera në Rregullore është në diskrecionin e KESH sh.a –zgjedhja e formës së shitjes së energjisë elektrike si përmes kontratave nga shitja e energjisë në bursat rajonale, Marrëveshjet me shoqëritë

homologe apo nga Kontratat e lidhura mbas negociatave korente me palet ofertuese pas shpalljes se fteses per shitje nga KESH sh.a bazuar gjithnje ne parimin e leverdishmerise ne zgjedhjen e formes se shitjes se energjise elektrike.

Nga ana tjeter ndryshimet ne Rregullore nuk preken dhe ne te sanksionohet se Shitja e energjise elektrike, do te zhvillohet ne baze te parimeve te transparences, dhe te eficenses ekonomike, te cilat cojne ne perfitim ekonomik per KESH sh.a. pas cenaur asnjehere interesat e klienteve tarifore. Per kete qellim ne Rregullore percaktohet se nuk lejohet te behet shitje e energjise elektrike per qellim perfitimi ne rast se Autoriteti Shites nuk permbush, ose rrezikon te mos permbushe, detyrimet kontraktuale ndaj OST sh.a dhe OSSH sh.a/Furnizuesi Publik me Pakice.

1.2 Udhëzuesi për Aplikimin dhe Tarifat e Lidhjes së Re apo Modifikimit të Lidhjes Ekzistuese në Rrjetin Elektrik të OST.

Me vendimin nr. 2 datë 10.01.2011 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, u miratua Udhëzuesi për aplikimin dhe tarifat e lidhjes së re apo Modifikimit të lidhjes ekzistuese në rrjetin elektrik të OST. Miratimi i këtij akti shënon finalizimin e punës se nisur nga ERE gjate vitit 2010, për përpunimin dhe përpilimin e këtij udhëzuesi. Miratimi i këtij akti nga ERE është bere në zbatim të kërkesave të Ligjit “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” Nr. 9072, datë 22.05.2003, me shtesat dhe ndryshimet përkatëse, Kodit të Rrjetit të Transmetimit, Metodologjisë së përcaktimit të tarifës së shërbimit të transmetimit të përcaktuar nga ERE, si dhe aktet e tjera nënligjore që lidhen me funksionet kryesore të OST sh.a, në përputhje me licensën e dhënë nga ERE këtij subjekti. Nëpërmjet këtij udhëzuesi janë përcaktuar elementet qe kane te bëjnë me mënyrën, formatin e aplikimit dhe tarifave përkatëse qe duhet te paguaje një subjekt per realizimin e lidhjeve te reja, modifikimet ose rritja e kapacitetit të lidhjeve ekzistuese, në rrjetin elektrik të OST sh.a si dhe rastet e refuzimit dhe anulimit te lidhjes. Përcaktimi i pagesave bazohet ne shpenzimet e evidentuara që ndërliken me realizimin e shërbimit te lidhjes nga OST sh.a.

Në këtë akt po ashtu ndër të tjera janë sanksionuar parimet e trajtimit të barabartë të aplikuesve, konfidencialitetit, diskutimeve paraprake, publikimit. Miratimi i Udhëzimit për aplikimin dhe tarifat e lidhjes së re apo Modifikimit të lidhjes ekzistuese në rrjetin elektrik të OST, vendos mbi baza më të drejta dhe serioze marrëdhëniet midis Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe subjektit kërkues dhe njëkohësisht që OST të mbulojë kostot për këtë shërbim.

1.3 Rregullat për Alokimin e Kapaciteteve të Interkonjeksioneve

Gjatë vitit 2011 ERE miratoi me vendimin nr.13, datë 22.02.2011, edhe Rregullat e Alokimit të Kapaciteteve të Interkonjeksionit të cilat gjejnë mbështetje në Ligjin nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, Modelin e Tregut të Energjisë Elektrike të miratuar me VKM Nr. 338, datë 19.3.2008 dhe Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike. Miratimi i këtyre rregullave dhe ndryshimeve të bëra me datë 25 nëntor 2011, shënojnë një hap të rëndësishëm për krijimin e kushteve për hapjen dhe liberalizimin e mëtejshëm të tregut të energjisë elektrike në Shqipëri në përputhje me angazhimet e vendit tonë në kuadër të traktatit të Komunitet të Energjisë për vendet e Europës Juglindore.

Këto Rregulla specifikojnë çështjet e përcaktimit të Kapacitetit Transmetues Disponibël, mënyra e llogaritjes së kapacitetit transmetues disponibël, i cili do të vihet në dispozicion të pjesëmarrësve të tregut nëpërmjet procedurave transparente të ankandit, metodat e alokimit të kapaciteteve të interkoneksionit (tre tipe ankandesh, vjetor, mujor dhe ditor), procedurat se si zhvillohen ankandet përkatëse, mënyra dhe formati i paraqitjes së kërkesës për pjesëmarrje në ankand, mekanizmi i zhvillimit të ankandëve përfshirë mënyrën e vlerësimit dhe nxjerrjes së rezultateve të ankandit, çmimin marxhinal që do të paguajnë fituesit e ankandit, llogaritjen e pagesës për rezervimin e kapacitetit të interkoneksionit të fituar dhe mënyrën e bërjes dhe lëshimit të faturës përkatëse. Po ashtu në këtë rregullore janë sanksionuar edhe penalitete përkatëse që aplikohen për rastet e mospërdorimit të të drejtave të fituara apo kur transferimi i kapaciteteve të fituara tek pjesëmarrësit e tjerë të tregut nuk bëhet sipas kërkesave të këtyre rregullave, në këto raste zbatohet parimi “Përdore ose humbe” që do të thotë se fituesit e ankandit e humbin të drejtën e përdorimit pa ju kthyer pagesa e bërë për to dhe për mospërdorim të përsëritur pjesëmarrësit të tregut i pezullohet pjesëmarrja në procedurat e alokimit për një periudhë gjashtë mujore. Në

rregulloren e alokimit të kapaciteteve të interkonjeksionit janë përcaktuar gjithashtu rastet kur OST-ja mund të reduktojë pjesërisht ose tërësisht të drejtat e përdorimit të kapaciteteve të interkoneksionit të fituara apo të siguruara sipas këtyre rregullave, siç mund të jenë rastet e forcave madhore të parashikuara në pikën 40 të nenit 3 të ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003 « Për sektorin e energjisë elektrike », i ndryshuar, si dhe ai i rasteve të parashikuara në kapitullin XIII të Rregullave të Tregut, të cilat parashikojnë kufizimin apo mbylljen e plotë të tregut të energjisë elektrike nga ana e OST-së në raste të veçanta emergjence siç parashikohet në dispozitat e akteve të sipërcituara. Në përputhje me praktikën më të mirë të vendeve të Bashkimit Europian dhe direktivave dhe rregulloreve përkatëse të Komisionit Europian procesi i alokimit të kapaciteteve të OST sh.a mbështetet në parimin e transparencës së procedurave të alokimit të kapaciteteve si dhe në detyrimin e OST-së për të informuar pjesëmarrësit e tregut përmes publikimit të informacionit që kërkohet për t'u bërë publik në faqen e web-it të OST, të tillë kapaciteti transmetues disponibël, rregullat e ankandit, specifikimet e ankandit, formularët dhe dokumentat përkatës, rezultatet e ankandëve, kapacitetin e alokuar etj.

1.4 Metodologjia e Llogaritjes dhe Faturimit të Dëmit Ekonomik

Në kuadër të ndryshimeve të bëra në Ligjin nr. 9072, datë 22.05.2011 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, me Ligjin nr. 10 362, datë 16.12.2010, përkatësisht në nenin 51, “Matja e energjisë elektrike të furnizuar”, pika 14 :“Llogaritja e dëmit ekonomik, shkaktuar kompanisë nga çdo ndërhyrje e paligjshme, bëhet në përputhje me metodologjinë përkatëse të miratuar nga ERE”, me vendimin nr. 42, datë 22.04.2011, ERE miratoi “Metodologjinë e Llogaritjes së Dëmit Ekonomik”. Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e vlerës së dëmit ekonomik shkaktuar kompanisë së shpërndarjes nga ndërhyrjet e paligjshme në rrjetin e shpërndarjes. Në rregullore përcaktohet se dëmi ekonomik i përcaktuar sipas tabelës përkatëse të miratuar nga ERE do të jetë i zbatueshëm në rastet kur një entitet i caktuar me ligj i duhet të llogarisë dëmin ekonomik të shkaktuar prej ndërhyrjeve të paligjshme në rrjetin elektrik të shoqërisë së shpërndarjes. Në kushtet e pamundësisë së vërtetimit se sa ka zgjatur koha e ndërhyrjes së paligjshme Metodologjia merr si

bazë llogaritjeje të dëmit ekonomik, vlerën e konsumit mesatar vjetor të një klienti sipas kategorisë ku ai bën pjesë duke e llogaritur atë si shumëzim të konsumit mesatar mujor me 12 muaj të vitit. Çmimet që do të aplikohen për sasi të përkatëse do të jenë çmimet më të larta në fuqi, sipas kategorisë të cilës i përket klienti që ka shkaktuar dëmin ekonomik.

1.5 Miratimi i Kontratës TIP për Shërbimin e Verifikimit, Kontrollit Fillestar dhe Periodik të Matësve të Energjisë Elektrike

Me vendimin nr. 62, datë 22.07.2011, të Bordit të Komisionerëve, ERE në përputhje me nenin 51 pika 9, të Ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike të ndryshuar gjatë vitit 2011 me Ligjin nr. 10362, datë 16.12.2010, miratoi Kontratën Tip të propozuar në përputhje me ligjin e sipërcituar, nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë. Kjo kontratë rregullon marrëdhëniet midis subjektit të autorizuar dhe shpërndarësit, të cilat në përputhje me përcaktimet e ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike» të ndryshuar, konsistojnë në realizimin e një/disa ose të gjitha shërbimeve si verifikimin e saktësisë së aparatëve matëse të energjisë elektrike, kolaudimin e tyre, dhe pajisjen me çertifikatë të matësve të energjisë që vendosen për herë të parë në përdorim, ose para përdorimit (instalimit) për herë të parë tek konsumatori; inspektimin kontrollin, kolaudimin periodik për verifikimin e saktësisë së aparatëve matëse dhe të sistemit të matjes së energjisë elektrike, të përcaktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave, Kodi i matjes dhe/ose kërkesat teknike, Kontrollin, kolaudimin e matësve të energjisë sa herë që kërkohet nga Shpërndarësi ose konsumatori. Në kontratë janë përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e palëve për shërbimin sipas objektit të kontratës, mënyrën e njoftimit dhe mbi përfaqësimin e palëve për efekt të kësaj kontrate, kushtet e sigurimit teknik gjatë kryerjes së shërbimit të kontrollit siç përcaktohet në kontratë. Gjithashtu në dispozita të veçanta të kontratës janë trajtuar çështjet e pagesës dhe faturimit për realizimin e shërbimeve të kontrollit duke saktësuar se në përputhje me nenin 51 pika 9 të Ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar me Ligjin nr. 10362, datë 16.12.2010, do të kryhen në përputhje me Udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit përkatës të Energjisë. Çështje të tjera që trajtohen në

kontratë janë ato mbi Konfidencialitetin, Vlefshmërinë e Kontratës, Ndërprerjen e Kontratës, Personat e Autorizuar, Çështjet teknike si dhe Formularët akt instalimi dhe procesverbal i kontrollit të matësit.

1.6 Rishikimi i Kontratës së Furnizimit me Energji Elektrike të Klientëve Tariforë

Në fund të vitit 2010, ERE nisi punën për rishikimin e Kontratës së Furnizimit me Energji Elektrike të Klientëve Tariforë, punë që u finalizua më 21 tetor me miratimin e kontratës së re të furnizimit me energji elektrike të klientëve tarifore. Miratimi i Kontratës së re të furnizimit lindi i si një domosdoshmëri jo vetëm duke konsideruar kushtet e pas procesit të privatizimit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, dhe detyrimin sipas Deklaratës Rregullore për miratimin e kushteve të reja të cilësisë së shërbimit të furnizimit me energji elektrike të konsumatorit, por duke vlerësuar mbi të gjitha edhe kërkesat për një kontratë të re të furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve tariforë, të paraqitura nga subjekte të ndryshme në seancat dëgjimore publike të organizuara nga ERE. Miratimi i këtyre dy Dokumenteve të rëndësishme për konsumatorët dhe opinionin publik, është kryer nëpërmjet procedurave transparente dhe gjithë përfshirëse të cilat kanë konsistuar në publikimin në faqen zyrtare të ERE-s si dhe në median e shkruar dhe vizive të këtij dokumenti dhe Rregullores për standartet minimale të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes dhe shitjes së energjisë elektrike. Kushtet e reja të vendosura në kontratën e furnizimit me energji elektrike, përcaktojnë ndër të tjera:

- 1- Detyrimin e Kompanisë për të garantuar furnizimin të pandërprerë me energji elektrike për konsumatorët shqiptarë.
- 2- Gjithashtu është garantuar akses i lirë i leximit të matësit, që nënkupton të drejtën e konsumatorit për të lexuar në çdo moment aparatën e tij matës.
- 3- Një element i ri i rëndësishëm është ulja e kamatvonesës, nga 0.5 % në ditë për çdo ditë vonesë, bëhet 0.1 % në ditë, e cila lehtëson detyrimet e konsumatorëve.
- 4- Në kontratë janë parashikuar në mënyrë të detajuar elementët që do të përmbajë fatura e konsumit të energjisë elektrike, duke përcaktuar detyrime për Kompaninë për

vendosjen në faturë të të dhënave që nuk kanë përfshirë më parë të cilat i vijnë në ndihmë konsumatorit.

- 5- Një trajtim i hollësishëm i është bërë procesit të ankesave të konsumatorëve, duke përcaktuar që trajtimi i tyre do të bëhet mbi bazën e rregullave standarte që do të miratohen nga ERE.
- 6- I është dhënë zgjidhje problematikës së kontrollit të aparatit matës, i cili tashmë do të kryhet nga një subjekt i pavarur që licensohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe jo më nga Kompania CEZ, këtu përfshihet kontrolli fillestar, periodik dhe kontrolli që kryhet bazuar ankesën që paraqet konsumatori.
- 7- Janë përcaktuar në mënyrë të detajuar rastet e ndërprerjes së furnizimit me energji elektrike për konsumatorët, ku janë vendosur standarte për ndërprerjet e planifikuara (remontet) dhe ato të paplanifikuara (defektet). Bazuar në Rregulloren për Cilësinë e Shërbimit, e cila do të jetë pjesë përbërëse e kësaj Kontrate, Kompania e Furnizimit do të rregjistrojë dhe dokumentojë ndërprerjet që do të kryhen.

1.7 Rregullorja për Standartet Minimale të Cilësisë së Shërbimit të Shpërndarjes dhe Shitjes së Energjisë Elektrike.

Me vendimin nr. 110 datë 21.10.2011, ERE miratoi Rregulloren për standartet minimale të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes dhe shitjes së energjisë. Kjo rregullore ka për qëllim:

- Të sigurojë që privatizimi dhe liberalizimi i tregut të energjisë elektrike të mos dëmtojë cilësinë e shërbimit të furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve.
- Të krijojë kushtet e një shërbimi të garantuar për furnizim të pandërprerë (brënda limiteve të lejuar) me energji elektrike, të konsumatorëve në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike.
- Të përcaktojë standartet minimale të cilësisë së shërbimit të energjisë së furnizuar.
- Të përcaktojë rregullat dhe detyrimet e ndërsjellta në rastet e mos respektimit të detyrimeve të furnizuesit me energji elektrike dhe përfituesit të shërbimit, sipas kërkesave të kësaj rregulloreje.

Gjithashtu për herë të parë në këtë Rregullore janë përcaktuar rregullat dhe detyrimet e ndërsjellta në rastet e mos respektimit të detyrimeve të furnizuesit me energji elektrike dhe përfituesit të shërbimit, sipas kërkesave të kësaj rregulloreje me qëllim

për të siguruar një mbrojtje më të plotë të interesave të konsumatorëve në marrëdhënien e tij me kompaninë. Në këtë Rregullore janë parashikuar Rregullat për Vazhdueshmërinë e Furnizimit, për Cilësinë Tregtare të Shërbimit dhe Rregullat për Cilësinë e Tensionit.

1.8 Rishikimi i Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike.

Në kuadër të ndryshimeve më të fundit të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, me Ligjin nr. 10485, datë 26.11.2011, ERE vlerësoi të domosdoshme nisjen e procedurave për rishikimin e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike në mënyrë të veçantë për efekt të funksionimit të tregut për sa i takon disbalancave. Është konsideruar me mjaft rëndësi që në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike të përcaktohen aspektet që kanë të bëjnë me pagesat për devijimet mbi dhe nën 5% për furnizuesit dhe gjeneruesit. Po ashtu është me rëndësi edhe përcaktimi i lëvizjes së fluksit të fondeve si dhe siguruesin për mbulimin e disbalancave. Përcaktimi i këtyre çështjeve në Rregullat e tregut të Energjisë Elektrike do të kryhet nga ERE në fillim të vitit.

1.9 Rishikimi i Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s, të miratuara me vendimin nr. 21, datë 18.03.2009, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s

ERE me iniciativën e saj, gjatë vitit 2011 ka proceduar me analizimin në tërësi të rregullores së Praktikës dhe Proçedurave të saj, si dhe të neneve të veçantë të cilat kanë lënë vënd për interpretime të ndryshme në zbatim. Me vendimin nr. 107, datë 17.10.2011, Bordi i Komisionerëve miratoi disa shtesa dhe ndryshime në “Rregullat e Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s” të miratuara me vendimin nr. 21, datë 18.03.2009 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s. Ndryshimet në rregullore kanë konsistuar në një saktësim të trajtimit sipas procedurave të ERE-s edhe të ankesave apo zgjidhjes së mos marrëveshjeve të konsumatorëve të energjisë elektrike. Më tej janë saktësuar aspekte të afateve proçedural qoftë në drejtim të paraqitjes së çështjeve nga subjektet e interesuara ashtu edhe në drejtim të trajtimit të tyre prej ERE-s. Janë

saktësuar çështjet e njoftimeve të mbledhjeve vendimmarrëse të Bordit të Komisionerëve, proceseve të rishikimit të akteve të ERE-s dhe ankimit ndaj tyre.

1.10 Për disa ndryshime në Rregulloren për Organizimin dhe Funksonimin e Brëndshëm të Entit Rregullator të Energjisë

Në kuadër të përmirësimit në mënyrë të vazhdueshme të marrëdhënieve dhe parimeve mbi bazën e të cilave drejtohet e gjithë veprimtaria e ERE-s, si dhe për të siguruar një bashkëpunim sa me efikas të Organeve Vendimmarrëse të ERE-s në përcaktimin e drejtimeve kryesore të veprimtarisë së saj, gjatë vitit 2011 ERE rishikoi Rregulloren për Organizimin dhe Funksonimin e Brëndshëm të ERE-s duke miratuar disa ndryshime në këtë rregullore nëpërmjet vendimit të Bordit të Komisionerëve nr. 80, datë 24.08.2011. Në kuadër të ndryshimeve saktësohen aspekte të funksionimit dhe organizimit të punës në ERE nga kryetari i ERE-s në cilësinë e administratorit ekzekutiv, Bordit të Komisionerëve dhe strukturave tjera të ERE-s, si dhe mbi marrëdhëniet që kanë të bëjnë me etikën profesionale, natyrën e detyrave dhe qëllimin e punës të strukturave të ERE-s si dhe raportet e ndërsjellta ndërmjet tyre.

1.11 Rregullorja për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë ose të Pjesshëm, Heqjen dhe Rinovimin e Liçensave në Sektorin e Gazit Natyror.

Në zbatim të Ligjit nr.9946, datë 30.06.2008 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, neni 11 (Përgjegjësitë e ERE-s në Sektorin e Gazit Natyror) dhe të nenit 14, pika 7, ERE përpunoi draftin e rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë ose të pjesshëm, heqjen dhe rinovimin e liçensave në sektorin e gazit natyror dhe mbas konsultimeve me palët e treta e miratoi rregulloren e sipërcituar me vendimin nr. 9, datë 11.02.2011, të Bordit të Komisionerëve. Përmes kësaj rregullore janë përcaktuar procedurat e liçensimit për kryerjen e aktivitetit sikurse përcaktuar në Ligjin Nr. 9946, datë 30.06.2008 “Për Sektorin e Gazit Natyror,, duke specifikuar kushtet për dhënien, modifikimin dhe rinovimin e një liçensë si dhe autoritetin e ERE-s për përcaktimin e pagesave për kryerjen e çdo aplikimi për liçensë; si dhe heqjen ose përfundimin e një liçense në përputhje me

nenin 14, pika 6 të Ligjit Nr.9946, datë 30.06.2008 “Për Sektorin e Gazit Natyror,, dhe nenet 16, 17, 18, 19 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike“ i ndryshuar.

1. Aktet e Rregullatorit në Kuadër të Tregut të Energjisë Elektrike

Aktet e miratuara nga ERE në kuadër të Tregut të Energjisë gjatë vitit 2011 janë 3. Ndërkohë gjë gjatë vitit 2011, është punuar edhe për Rregulloren mbi Dhënien dhe Heqjen e Statusit të Klientëve të Kualifikuar, por duke qënë se ndryshimet në ligj përcaktuan taksativisht kalimin e tyre në Klientë Tariforë, kjo rregullore nuk ishte më e nevojshme të miratohej nga ERE. Më poshtë do të keni mundësi të lexoni më tepër mbi këto akte.

2.1 Kontrata për Furnizimin me Energji Elektrike ndërmjet Shoqërisë KESH sh.a (Furnizuesi Publik me Shumicë) dhe Shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a (Furnizuesit Publik me Pakicë) për periudhën 01.01.2011 deri më 31.12.2011, vendim nr. 31, datë 31.03.2011

Me vendimin nr. 31, datë 31.03.2011 të Bordit të Komisionerëve u miratuanga ERE Kontrata për furnizimin me energji elektrike ndërmjet shoqërisë KESH sh.a (furnizuesi publik me shumicë) dhe shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a (furnizuesit publik me pakicë) për periudhën 01.01.2011 deri më 31.12.2011.

Miratimi i këtij akti është në autoritetin e ERE –s në referim të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 338, datë 19.03.2008 “Për Miratimin e Modelit Shqiptar të Tregut të Energjisë Elektrike”, i ndryshuar dhe Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike. Kjo marrëveshje synon rregullimin e marrëdhënieve midis KESH sh.a dhe CEZ Shpërndarje sh.a për gjatë një viti, në lidhje me furnizimin me energji elektrike

në drejtim e përcaktimit të të drejtave dhe detyrimeve mes palëve, sasia e energjisë elektrike që do të lëvrohet për qëllime të kësaj kontrate, pika e lëvrimit, garancitë kontraktore, Interesi i pagesës së vonuar, Skeduli i lëvrimit, Paaftësia për Livrim, Kompesimi i detyrimeve për livrim të tepërt mbi planifikimin, Kompesimi i devijimeve të humbjeve etj.

2.2 Marrëveshja e Transmetimit të Energjisë Elektrike midis OST sh.a dhe CEZ Shpërndarje sh.a

Kjo marrëveshje u miratua nga ERE me vendimin nr. 03, datë 11.02.2011, të Bordit të Komisionerëve të saj. Për miratimin e kësaj marrëveshje ERE u bazua në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 338, datë 19.03.2008, “Për miratimin e Modelit Shqiptar të Tregut të Energjisë Elektrike” dhe Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike të miratuara me vendimin nr. 68, datë 23.6.2008 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s. Me anë të kësaj marrëveshje “OST sh.a” në cilësinë e personit juridik të licencuar për kryerjen e veprimtarisë së transmetimit të energjisë elektrike vënë dispozicion sistemin e transmetimit të saj për transmetimin e energjisë elektrike nga pikat e marrjes në pikat e dhënies për CEZ Shpërndarja sh.a në mënyrë të vazhdueshme dhe të pandërprerë, në sasi të dhe për periudhën kohore të specifikuar në këtë marrëveshje, Nga ana tjetër CEZ Shpërndarja sh.a mbart detyrimin për të informuar OST sh.a në lidhje me sasinë e energjisë elektrike që do të transmetohet për llogari të saj. Në kontratë ndër të tjera është përcaktuar mënyra e llogaritjes së disbalancave për të cilat nga programi javor, deri në masën +/- 5% CEZ Shpërndarja nuk do të paguajë sanksione, por do të ketë detyrimin që në javën/javët pasardhëse të planifikojë rregullimin e këtyre disbalancave.

2.3 Kontrata e Negociuar nga Shoqëria CEZ Shpërndarja sh.a për Prokurimin e Energjisë Elektrike për Mbulimin e Humbjeve në Sistemin e Shpërndarjes për vitin 2012.

Me vendimi nr. 127, datë 02.12.2011, ERE miratoi lidhjen e kontratës nga CEZ Shpërndarje me EFT AG për prokurimin e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes për vitin 2012, me profilin si më poshtë:

Periudha 1.1.2012 – 31.12.2012

Fuqia: 150 MW CBC 100 % nga EFT

Sasia: 1,317,600 MWh

Çmimi /njësi: **62.40** Euro/MWh

Në miratimin e kësaj kontrate ERE u bazua në Rregulloren për procedurat standarte të prokurimit të energjisë elektrike nga OSSH sh.a në piken 2.10, ku thuhet se ERE miraton lidhjen e kontratës së negociuar nga OSSH me kusht që çmimi i pranuar në kontratë të jetë më i ulët se ai i ofertës të paraqitur në tenderin e anuluar ku oferta e paraqitur nga EFT Ag ishte 65.99 Euro /MWh kundrejt çmimi 62.40 Euro /MËH të ofruar në procedurën me negociim.

2.4 Mbi Dhënien e Statusit të Klientit të Kualifikuar

ERE me vendimin nr. 107, datë 10.12.2010, miratoi “Nivelit e Konsumit Vjetor të Energjisë Elektrike “Për Përfitimin e Statusit të Klientit të Kualifikuar për vitin 2011.” Ky miratim u bë në mbështetje të nenit 48, pika 1, të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar dhe Ligjit nr.9501 datë 03.04.2006, “Për Ratifikimin e Traktatit të Krijimit të Komunitetit të Energjisë. Qëllimi i përcaktimit të Nivelit të Konsumit Vjetor, nga ana e ERE-s, është që të gjithë klientët familjarë dhe jo familjarë të energjisë elektrike të kenë mundësi në zgjedhjen e furnizuesit dhe rrjedhimisht të drejtën për të përfituar statusin e klientit të kualifikuar. Në këtë mënyrë plotësohet më mirë harmonizimi i legjislacionit tonë në sektorin e energjisë me angazhimet e marra nga ana Republikës së Shqipërisë në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjisë nëmënyrë të veçantë pjesës që lidhet me përcaktimin e pikës 3, të Shtojcës “A”, ku thuhet se: Secila Palë Kontraktuese duhet të sigurohet që klientë të kualifikuar brenda kuadrit të Direktivave të Komunitetit European 2003/54/EC dhe 2003/55/EC do të jenë:

- i) Nga 1 janari 2008, të gjithë konsumatorët jofamiljarë;
- ii) nga 1 janari 2015 të gjithë konsumatorët.

2. Amendimet në Legjislacionin Primar në Sektorin e Energjisë Elektrike

Ligji nr. 10361 datë 16.12.2010 “ Për disa ndryshime në Ligjin nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”

Më datë 25.11.2011, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar Ligjin nr.10485, datë 26.11.2011, “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, ku ndër të tjera parashikohet ndryshimi i nenit 48, dhe konkretisht në kuadër të këtyre ndryshimeve përcaktohet se:

“Klient i kualifikuar” do të konsiderohet automatikisht çdo konsumator i energjisë elektrike, i lidhur në rrjetin e energjisë elektrike me tension 110 kV e sipër, si dhe çdo konsumator tjetër i energjisë elektrike që, pavarësisht nivelit të tensionit të rrjetit të energjisë elektrike në të cilin është lidhur, ka një konsum vjetor të energjisë elektrike më të madh se 50 milionë kWh.”

Nëpërmjet këtij ndryshimi shënohet një hap i mëtejshëm në drejtim të përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Europian. Duke konsideruar angazhimet e vendit tonë në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjisë për vendet e Europës Juglindore, ndryshimi i sipërcituar përmbush kështu një nga kërkesat e këtij Traktati që ka të bëjë me liberalizimin e tregut të energjisë elektrike.

Nga ana tjetër një tjetër ndryshim i rëndësishëm në kuadër të Ligjit nr. 10485, datë 26.11.2011, “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, është ndryshimi i nenit 64 Kundravajtjet administrative. Përmes këtij ndryshimi i jepet zgjidhje një nga çështjeve më të mprehta në drejtim të ushtrimit të përgjegjësive të ERE-s për zbatimin në kohë dhe me korrektesë të vendimeve të saj nga të licensuarit në tregun e energjisë elektrike. Është për tu theksuar se deri para hyrjes në fuqi të ligjit të sipërcituar, ERE-s kishte të drejtën që për shkelje të caktuara të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003 “ Për sektorin e energjisë elektrike” të vendoste gjopa, vlera më e lartë e të cilave është 350.000 lekë. Gjopat e këtyre niveleve janë konsideruar nga shoqatat e mbrojtjes së konsumatorëve apo grupet e tjera të interesit por edhe nga ana jonë si masa shtrënguese jo efektive dhe si të tilla nëpërmjet Ministrisë së Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës ERE në

mungesë të iniciativës ligjore, kërkoi ndërhyrjen e kësaj te fundit për të mundësuar ndryshimin e nenit 64 të ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003 2003 “ Për sektorin e energjisë elektrike”. Ndryshimi i nenit 64 të ligjit të sipërcituar reflekton Paketën e Tretë Legjislative të BE për sektorin e energjisë dhe konkretisht në Direktivën 2009/72, të Komisionit Europian nënvizohet nevoja që vendet anëtare të marrin masa për forcimin e rolit të rregullatorit sidomos në drejtim të vendosjes së sanksioneve ndaj kompanive. Dispozita e ndryshuar lë një hapësirë më të gjërë të rasteve të aplikimit të gjobave nga rregullatori dhe së dyti vlera maksimale e gjobave është më e madhe se ato që përmbahen në nenin aktual të ligjit (neni 64), ku vlera më e madhe e një gjobë është 350.000 lekë. Me ndryshimin në ligj së pari përcaktohet një maksimum gjobe prej 3 për qind të xhiros vjetore të një të licensuari dhe një minimum prej 0,01 për qind. Përveç kësaj, në nenin e ndryshuar, përcaktohet edhe vendosja e gjobave ditore për raste të tilla si vonesa në kryerjen e pagesave të rregullimit ndaj ERE apo për moszbatim të urdhërimeve të ERE-s, për korrigjimin e shkeljeve brenda afateve të caktuara nga ERE. Këto ndryshime sanksionojnë mos vendosjen e gjobave në shumë monetare fikse duke konsideruar që shkelja mund të kryhet edhe nga subjekte të licensuar që kanë të ardhura vjetore shumë të vogla në krahasim me disa nga të licensuarit në sektorin e energjisë elektrike me të ardhura vjetore shumë të larta, gjë që mund të ishte shumë rënduese për subjektet e vogla çka dhe çonte në një trajtim disproporcional midis një subjekti me të ardhura të ulta dhe një subjekti me të ardhura vjetore shumë më të mëdha nëse gjoba do të ishte në vlera monetare të fiksuara në ligj. Ky ndryshimi jep më shumë mundësi ERE-s jo vetëm që të bëjë një kategorizim më të detajuar të gjobave për shkelje të ndryshme nga të licensuarit, por në të njëjtën kohë do të shërbejë edhe si një mekanizëm me efikas për zbatimin e të gjithave dispozitave ligjore e nënligjore për rregullimin e sektorit të energjisë elektrike.

3. Trajtimi i Proçeseve Gjyqësore

Gjatë vitit 2011, janë ndjekur edhe në një sërë çështjesh gjyqësore që kanë patur zhvillim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Duke bërë një statistikë të thjeshtë krahasuar me vitet e mëparshme, rezulton se numri i proçeseve gjyqësore që ERE ka ndjekur gjatë vitit 2011 është rritur ndjeshëm. Ndër të tjera numri i proçeseve gjyqësore ku ERE ka qënë palë e paditur ka arritur në 5 (pesë) dhe janë ende në proçedim.

Mosmarrëveshjet që janë trajtuar në këto gjykime kanë qënë kryesisht ankimime nga subjektet e liçensuara nga ERE dhe ankesa të qytetarëve (konsumatorëve) për mbifaturim të energjisë elektrike.

Kryesisht ERE ka marrë pjesë në cilësinë palës së e tretë në këto gjykime dhe në 5 raste ERE ka qënë palë e paditur, respektivisht me gjyqet me shoqëritë:

- CEZ Shpërndarje sh.a. - në lidhje me ankimimin e vendimit nr. 31, datë 31.03.2011, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për Miratimin e Kontratës së Furnizimit me Energji Elektrike ndërmjet shoqërisë KESH sh.a (Furnizuesi Publik me Shumicë) dhe shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a (Furnizuesi Publik me Pakicë) për periudhën 01.01.2011 – 31.12.2011”.
- CEZ Shpërndarje sh.a. - në lidhje me ankimimin e vendimit të ERE-s, nr. 62, datë 22.07.2011, “Për miratimin e Kontratës Tip për shërbimin e verifikimit, kontrollit periodik e fillestar të matësave të energjisë”, si edhe Vendimit nr. 73, datë 09.08.2011, Mbi ankimimin e CEZ Shpërndarje sh.a të Vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Nr. 62, datë 22.07.2011 “Për miratimin e kontratës tip për shërbimin e verifikimit, kontrollit periodik e fillestar të matësave të energjisë elektrike.”
- KESH sh.a. - në lidhje me ankimimin e kësaj kompanie të vendimit të ERE-s nr. 118, datë 28.12.2010 “Për mospranimin e ankesës së KESH sh.a për rishikimin e vendimit të Bordit të Komisionerëve nr. 97, datë 07.12.2010, “Për Përcaktimin e tarifës së energjisë elektrike për furnizuesin publik me shumicë për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2011.”

- GEN – I Tirana sh.p.k. -në lidhje me ankimimin e vendimit nr. 78, datë 22.10.2010 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s - lidhur me miratimin e lidhjes së kontratave për shit – blerjen e energjisë për periudhën 01.01.2011 – 31.12.2011, midis shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a dhe shoqërive CEZ AS dhe EFT AG.
- Çështje te tjera - në lidhje me ankimimin e faturavetë energjisë elektrike ku ERE është thirrur me cilësinë e personit te tretë në gjykatë.

Kapitulli IV

Veprimtaria e ERE në fushën e Mbrojtjes së Konsumatorit

Në përputhje me kuadrin ligjor dhe atë rregullator mbi të cilin mbështetet veprimtaria e Entit Rregullator të Energjise, një vëmendje e veçante i është kushtuar garantimit të të drejtave të konsumatoreve tarifore dhe mbrojtjes së vazhdueshme të interesave të tyre si dhe të gjithë pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike në tërësi.

Fuqizimi i rolit aktiv të konsumatoreve në treg, mirinformimi dhe mbrojtja e interesave të tyre, në mënyrë të veçantë të konsumatoreve familjare, është një nga sfidat më të rëndësishme dhe prioritetet kryesore të ERE-s. Pas përfundimit të procesit të privatizimit, bëhet gjithmonë e më e rëndësishme përfaqësimi i të gjithë atyre konsumatoreve që nuk kanë mundësinë dhe aftësinë e duhur për të njohur dhe për të patur aksesin e nevojshëm si në kuadrin ligjor ashtu edhe në aspektin teknik të funksionimit të tregut, duke qenë të ekspozuar kështu ndaj shkeljeve të mundshme të të drejtave të tyre nga efekti monopol i tregut të energjisë.

Për këtë arsye, fuqizimi i rolit të konsumatoreve konsiston në punën për:

1. Trajtimin dhe Zgjidhjen e Ankesave të Konsumatoreve

Trajtimi i drejtpërdrejtë i ankesave të konsumatoreve të energjisë elektrike, konsiderohet nga ana e ERE-se si një nga veprimtaritë parësore të saj, e cila na shërben për identifikimin e problemeve konkrete të furnizimit me energji elektrike të klientëve dhe kontribuon në monitorimin e cilësisë së shërbimit që ofron Furnizuesi nga këndvështrimi i konsumatorit. Trajtimi me përkushtim, transparence, paanshmëri dhe brenda afateve ligjore të ankesave të konsumatorëve, mbetet një nga aspektet më të rëndësishme të veprimtarisë së ERE-së.

Gjatë vitit 2011, konstatohet një rritje e konsiderueshme e numrit të konsumatoreve që i drejtohen drejtpërdrejtë ERE për zgjidhjen e ankesave të tyre kundrejt Kompanisë së Furnizimit. Për vitin në fjalë, pranë ERE-së janë regjistruar dhe trajtuar rreth 1200 ankesa, kundrejt 350 të regjistruara për vitin 2010. Në këtë numër nuk përfshihen informacionet dhe orientimet e dhëna nëpërmjet telefonatave

apo e-mail (rreth 100 ankesa me e-mail) si dhe konsultimet e shumta me konsumatorë të ndryshëm që i drejtohen personalisht ERE-së.

Kjo rritje dëshmon si për forcimin e autoritetit të ERE-së ashtu dhe për ndërgjegjësimin e konsumatorëve për rolin e ERE-s si një autoritet i pavarur në mbrojtje të interesave të konsumatorëve të energjisë elektrike.

Problematika kryesore e trajtuar për vitin 2011, ka konsistuar në:

- Një nga problemet kryesore të trajtuara në 3 muajt e parë të vitit, kanë qenë ankesat e konsumatorëve për aplikimin në mënyrë të kundërligjshme nga ana e CEZ Shpërndarje të “dëmit ekonomik” apo “energji e pamatur” për kundravajtësit e energjisë elektrike. Kjo problematikë është monitoruar dhe ndjekur me kujdes nga ana jonë. Të gjitha ankesat e regjistruara, janë dërguar në CEZ duke kërkuar anulimin e tyre në përputhje me Vendimin nr. 90, datë 15.11.2010, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për moszbatim të kushteve të përcaktuara në Licencë dhe konkretisht të pikës 3.1, të Licencës për Aktivitetin e Furnizimit Publik me Pakicë të Energjisë Elektrike”. Pas disa kërkesave zyrtare të ERE-s, CEZ Shpërndarje sh.a. bëri anulimin e këtyre faturave dhe publikoi në Web të gjithë numrat e kontratave për të cilat është bërë faturimi në zërin “energji e pamatur”. Për këtë problematikë nga ana jonë janë kryer disa komunikime me media. Procesi është në monitorim nga ana e ERE-s.
- Një problem tjetër i trajtuar gjërisht nga ana e ERE-s gjatë vitit 2011 ka qenë faturimi i klienteve familjare sipas tarifës së bllokut të parë. Duke analizuar me shumë përgjegjësi këtë problematikë dhe argumentet e paraqitura nga CEZ Shpërndarje, ERE ka vlerësuar se formula e korigjimit të aplikimit të tarifës së Bllokut të Parë për leximet e kryera për më shumë apo më pak se 30 ditë, i cili është zbatuar nga ana CEZ Shpërndarje në Sistemin e Faturimit, nuk ishte në përputhje me aktet e miratuara nga Enti Rregullator. Pas monitorimit të kryer për këtë veprim të CEZ-it, bazuar në Kontratën e Furnizimit të Konsumatorëve Familjarë, neni 5 dhe 6, ERE vendosi të ndalohet aplikimi i formulës për korigjimin e faturimit të tarifës së bllokut të parë për leximet e kryera për më shumë apo më pak se 30 ditë dhe të respektohet detyrimi kontraktual për leximin mujor të konsumit të energjisë elektrike. Për këtë qëllim

u kërkua të bëhen sistemimet përkatëse për të gjithë konsumatorët për muajt e faturuar në mënyrë të parregullt.

- Problemi më shqetësues vazhdon të mbetet parregullsia në faturim. Këtu do të përmendim probleme qe lidhen me:
 - mbi faturimin e energjisë elektrike;
 - mosrespektim të afatit të leximit të matësit;
 - mospërputhje të faturimit të kryer me leximin real të matësit;
 - faturime dukshme të gabuara;
 - gabime ose vonesa në hedhjen e të dhënave që rrjedhin nga Sistemi Billing.

Këto ankesa janë trajtuar posaçërisht nga ERE, duke bërë verifikimin në vend të gjendjes dhe më pas i jepen udhëzimet përkatëse kompanisë CEZ Shpërndarje duke i caktuar afate për zgjidhjen e tyre. Sipas informacioneve të dërguara Kompania dhe verifikimet e ERE-s, për pjesën më të madhe të tyre është pranuar gabimi dhe është bere sistemimi përfundimtar i gjendjes reale të leximit të matësit. Procesi i verifikimit ndiqet hap pas hapi deri në përgjigjet përfundimtare për zgjidhjen e ankesës së këtyre konsumatoreve.

Megjithëse është vërejtur një përmirësim në kthimin e përgjigjeve në kohë për ankesat që i drejtohen ERE-s, përsëri konstatojmë vonesa në hedhjen e këtyre korigjimeve në Sistemin Billing, gjë e cila krijon shqetësim tek konsumatorët. CEZ ka informuar se këto probleme janë shkaktuar nga instalimi i programit të ri të Sistemit Billing.

- Problematike ka rezultuar edhe cilësia e shërbimit të ofruar konsumatorit. Është vërejtur shqetësimi i tyre lidhur me ndërprerjet e energjisë elektrike si dhe cilësinë e tensionit. Pjesa më e madhe e këtyre ankesave vijnë kryesisht nga Komuna dhe subjekte të ndryshme private. Një pjese e madhe e këtyre ankesave na janë përcjellë nga METE dhe Avokati i Popullit.

Nga ana jonë këto ankesa janë trajtuar duke organizuar seanca dëgjimore, në të cilat i është kërkuar CEZ-it informacion i detajuar lidhur me shkaqet e ndërprerjeve dhe kohëzgjatjen e tyre. Nga ana e CEZ Shpërndarje, janë pranuar ndërprerjet e kryera dhe janë angazhuar për respektimin e detyrimeve kontraktuale dhe njoftimin në kohë të konsumatorëve për rastet ndërprerjeve të planifikuara dhe kryerjen e defekteve në një kohe sa më të shkurtër. Gjithashtu nga ana e ERE-së, i është kërkuar ndërhyrja e menjëhershme për kryerjen e shërbimeve të rrjetit të shpërndarjes dhe investimeve brenda fondeve të planifikuara, aty ky gjendja është më emergjente.

Problemet me cilësinë e tensionit, janë të njohura dhe të pranuar nga CEZ Shpërndarje. Rregullimi dhe përmirësimi i situatës për të siguruar një furnizim me energji elektrike konform standardeve, do të kërkonte investime të reja, një pjese e të cilave janë parashikuar për periudhën e trete rregullatore, në përputhje me planin e investimeve që është miratuar nga ERE.

- Një fenomen te ri për këtë periudhë do të përmendim edhe ankesat e abonentëve që megjithëse kanë kryer të gjitha pagesat e konsumit të energjisë, rezultojnë debitorë. Nga dokumentacioni që kemi shqyrtuar, kemi konstatuar se kemi të bëjmë me raste kur konsumatorët i kanë kryer pagesat kryesisht me bankë ose postë dhe në këto raste vërejmë mos rakordimin e faturave të paguara, por kemi edhe raste të kryerjes se pagesave në zyrat e shitjes dhe për të cilat mungon dokumentacioni i kryerjes së këtyre pagesave. Procedura e ndjekur për këta konsumatore, ka qenë kryerja e verifikimit në vend të Librezës origjinale apo pagesat e kryera me Arkë apo Bankë, me Sistemin e Billingut të CEZ Shpërndarje, duke bërë me pas sistemimet e nevojshme.
- Probleme të matjes së energjisë elektrike - Pajisja me aparat matës, kryerja e kontrollit të aparatit matës, hedhja në sistem e të dhënave të aparateve matës të rinj, mos rakordimi i vlerës së faturuar aforfe me gjendjen reale të matësit, kanë rezultuar problematike edhe për vitin 2011. Edhe për këto ankesa, është kërkuar nga CEZ informacioni i nevojshëm dhe plotësimi i dokumentacionit përkatës. Në disa raste kemi konstatuar vonesa në hedhjen e të dhënave të matësve të rinj në sistem. Për këto raste, ERE ka monitoruar me kujdes plotësimin dhe sistemimin e të dhënave të matësit të ri, duke kërkuar respektimin e faturimit të Bllokut të Pare me 300 kWh për çdo muaj vonesë.

- Probleme të lidhjes dhe transferimit të kontratave – për këto raste konstatojmë vonesa në lidhjen e kontratave, mos transferim të kontratave për objektet që figurojnë debitorë. Nga ana jone është udhëzuar të bëhet lidhja e kontratave për të gjithë ata subjekte që nuk janë debitorë. ERE është në ndjekje të vazhdueshme të këtij problemi.
- Do të theksonim se kemi vërejtur probleme në trajtimin e ankesave dhe zgjidhjen e problemeve nga ana e Qendrave të Kujdesit ndaj Klientit të ngritura nga CEZ Shpërndarje. Megjithëse është shënuar një hap përpara në hapjen e 42 Qendrave të Kujdesit ndaj Klientit, kemi konstatuar neglizhencë dhe vonesa në trajtimin e ankesave të konsumatorëve, mos rakordim ndërmjet Departamenteve brenda Kompanisë. Problemet të cilat regjistrohen nga ana e Zyrave të Kujdesit ndaj Klientit, nuk u jepet zgjidhje përfundimtare dhe përgjigje në kohë për ankesat, por vonohen duke i adresuar nëpër Departamente të tjera të Kompanisë. Kjo vonesë bën që një pjesë e konsumatoreve që nuk kanë marrë përgjigje brenda afatit 1 muaj të përcaktuar në Rregulloren e Brendshme të CEZ, t'i drejtohen ERE-s për zgjidhjen e ankesës.

Për këtë qëllim, nga ana e ERE-së monitorohet në vazhdimësi aktiviteti që kryhet nga këto Qendra në lidhje me respektimin e afateve të trajtimit të ankesave, mënyra e zgjidhjes së tyre, reflektimi në faturë i korigjimeve të bëra, etj.

Table 18 Pasqyra e ankesave për vitin 2011 dhe mënyra e trajtimit të tyre nga ERE

Nr. i ankesave të ardhura në vitin 2011 dhe mënyra e trajtimit të tyre

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Total
Nr. i Ankesave të Trajtuar	150	86	85	76	51	58	58	37	77	69	88	184	1019
Trajtim i Posaçem	89	66	74	70	51	58	58	37	77	69	70	135	860
Anullime të Kryera	61	20	11	6	-	-	-	-	-	-	18	49	165
Trajtuar në Seanca Degjimore		19	27	18	17	10	7	8	26	18	20	14	184
Verifikime në Vend	3	5	6	9	6	5	3	4	8	7	6	9	71

2.Proçesi i Miratimit të Kontratës së Furnizimit të Klientëve Tarifore dhe Rregullores për Standardet Minimale të Shërbimit të Shpërndarjes dhe Furnizimit të Energjise Elektrike.

Si një nga detyrat më themelore ku u përqendrua vëmendja e ERE-s gjatë këtij viti, ka qenë miratimi i Kontratës së Furnizimit të Klientëve Tarifore dhe Rregullores për Cilësinë e Shërbimit të Shpërndarjes dhe Furnizimit të energjisë elektrike.

Pas publikimit të draftit të kontratës dhe rregullores së mësipërme, mund të themi se këto dy dokumente janë pritur me shumë interes si nga grupet e interesit ashtu edhe nga publiku i gjerë.

Për te realizuar një proces sa më transparent dhe gjithë përfshirës, ERE zhvilloi disa takime me përfaqësuesit e të gjitha palëve të interesuara që kishin depozituar komentet dhe qëndrimet e tyre pranë ERE-së. Ne këtë proces është përfshirë në mënyrë aktive Avokati i Popullit, Autoriteti i Konkurrencës dhe Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatoreve. Nga ana jone u bënë disa prezantime dhe takime te ndryshme, përfshirë edhe në disa televizione kombëtare.

Përpara procesit të vendimmarrjes së Bordit të Komisionerëve, u organizuan seanca dëgjimore me subjektet e interesuara në Fier, Shkodër dhe një seancë dëgjimore publike në Tiranë.

Ky proces u përmbyll me 21 Tetor me miratimin nga ana e Bordit të Komisionerëve të Kontratës së Furnizimit me Energji Elektrike për Konsumatorët Familjare dhe Jo-Familjare dhe Rregulloren për Standardet Minimale të Cilësisë së Shërbimit të Shpërndarjes dhe Furnizimit me Energji Elektrike.

3.Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve midis te Licensuarve

Një aspekt tjetër i punës së ERE-së, është edhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve midis subjekteve të licensuara që operojnë në tregun e energjisë elektrike. Këtu do të përmendim trajtimin e problematikave ndërmjet pjesëmarrësve të tregut KESH, OST, CEZ Shpërndarje. Konkretisht problematikat më kryesore të trajtuara kanë qenë:

- a. Diskutimin e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit dhe mosmarrëveshjet e lindura për vitet 2008 -2010.
- b. Mënyra e llogaritjes dhe trajtimit të disbalancave në sistemin e energjisë elektrike.
- c. Pretendimet për mospagesat e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i kontratave në tregun e energjisë elektrike dhe rakordimet e pagesave që këto kompani i detyrohen njëra tjetrës.
- d. Rakordimin e sasisë se importit për mbulimin e humbjeve në Sistemin e Shpërndarjes që duhet të rakordohet midis palëve.
- e. Lidhur me zbatimin e kontratës tip të miratuar nga ERE për shërbimin e verifikimit dhe kontrollit fillestar dhe periodik të matësve të energjisë elektrike.

Për të gjitha këto çështje, janë organizuar seanca dëgjimore teknike mes palëve, ku janë diskutuar problematikat që ekzistojnë në marrëdhëniet midis këtyre kompanive. Nga ana jone janë dhëne rekomandimet e nevojshme për zgjidhjen e këtyre mosmarrëveshje mbi baza kontraktuale në zbatim të kuadrit rregulator.

4. Seancat Dëgjimore

Si një pjesë e rëndësishme e veprimtarisë së ERE-së, në zbatim të kriterit të transparencës dhe të konsultimit me palët e interesuara dhe me publikun, bazuar në Rregulloren e Praktikës dhe Procedurave, janë organizuar rreth 30 seanca dëgjimore për trajtimin dhe zgjidhjen e ankesave duke grupuar problematiken. Në këto seanca, janë ballafaquar shqetësimet e konsumatoreve me kompaninë dhe janë dhënë udhëzime nga ana e ERE-s, udhëzime të cilat janë të detyrueshme për kompaninë, për zgjidhjen e problemeve të konstatuara me konsumatorët.

Rreth 30 seanca dëgjimore të tjera kanë patur për objekt konsultimet për aktet rregullatore apo trajtimin e problematikave të ndryshme me të licensuarit, palët e interesuara si dhe shoqatat e tregtarëve të energjisë apo të konsumatorëve. Mendimet dhe vërejtjet e shprehura në këto seanca, analizohen dhe nëpërmjet një procedure transparente, iu bëhet e ditur të interesuarve qëndrimi i ERE-së për marrjen parasysh apo jo të tyre. Gjatë këtyre seancave, është siguruar një pjesëmarrje gjerë si nga METE, Autoriteti i Konkurrencës, përfaqësues të Kompanive publike, Shoqatat e Konsumatorëve si dhe subjekte të interesuara.

5. Monitorimi në vend i problematikave

Një aspekt tjetër i punës së ERE-s, është edhe monitorimi në vend i problematikave të ndryshme që ngrihen nga ankesat e konsumatorëve, nga media apo kryesisht. Këtu do të përmendim monitorimin e problematikave si më poshtë:

- Mungesën e furnizimit me energji elektrike të disa zonave në Shkodër;
- Mungesën e furnizimit me energji elektrike në disa zona të Dibrës;
- Mos faturimin e energjisë elektrike në disa zona të Lezhës
- Problematikën e cilësisë dhe mungesës së furnizimit me energji elektrike në zonën e Tropojë dhe Bajram Currit.
- Problematiken e faturimit në zonën e Korçës.

6.Mbrojtja Konsumatore në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjise

Një rol të rëndësishëm në drejtim të njohjes me legjislacionin europian dhe praktikave më të mira të rajonit për sa i takon mbrojtjes së konsumatorëve, luan edhe pjesëmarrja aktive në Grupin e Punës së Mbrojtjes së Konsumatorëve të ECRB (Bordi i Rregullatorëve të Komunitetit të Energjisë në Vjenë), ku mbi bazë tematikash analizohen dhe krahasohen eksperiencat e rregullatorëve të vendeve anëtare si dhe prezantohen nga ana jonë iniciativat e ndërmarra për përmirësimin e kuadrit rregullator në përputhje me Paketën e Tretë Rregullatore.

Një detyrë të rëndësishme për këtë periudhe në kuadër të CWG (Customer Working Group) të ECRB, do të përmendim pjesëmarrjen dhe plotësimin për herë të parë të Benchmark-ut të 5-të të CEER (Rregullatori Europian për Energjinë) për Cilësinë e Shërbimit të Furnizimit të Energjisë Elektrike – “5th CEER Benchmarking Report on the Quality of Electricity Supply”.

Po në kuadër të ECRB, CWG dhe GWG (Gas Working Group), janë plotësuar pyetësorë të ndryshëm për çështjet e energjisë elektrike dhe gazit natyror për sa i takon aspektit të mbrojtjes së konsumatorëve në këto dy fusha.

7. Marrëdhëniet me Publikun

7.1 Proçedurat e Informimit Publik

Ne mënyrë që të garantojë për një publik të gjerë dhe për mediat një njohje më të thellë të veprimtarisë së ERE-s dhe për të vlerësuar më mirë efikasitetin e përhapjes së mesazheve të saj, një ndër detyrat kryesore është publikimi i informacionit për kushtet e kryerjes së shërbimeve nga Kompanitë e licensuara në sektorin e energjisë, me qëllim që të garantojë transparence maksimale, në funksion të përmirësimit të shërbimeve të ofruara përdoruesve të rrjetit të energjisë elektrike si dhe konsumatorëve finale.

Për të përmbushur këtë detyrim institucional dhe për të siguruar një mbështetje të rëndësishme në strategjinë e komunikimit, ERE ka rritur përpjekjet për informimin e konsumatorëve nëpërmjet zhvillimit të iniciativave të reja të komunikimit.

Veprimtaria e komunikimit e kryer nga ERE, i kanë dhënë prioritet aspekteve të ndryshme dhe kanë konsoliduar imazhin e saj në aktivitetin e rregullimit.

7.2 Komunikimi nëpërmjet ngjarjeve dhe aktiviteteve

Është për t'u evidentuar fakti se nga ana e ERE-s konsiderohen veçanërisht efektive organizimi dhe pjesëmarrja në aktivitetet të cilat organizohen në kuadër të mbrojtjes së konsumatorëve nga Organizma të ndryshme si brenda dhe jashtë vendit. Këto takime shërbejnë për të promovuar funksionet institucionale të ERE-s, si dhe detyrat e veprimet e saj në drejtim të mbrojtjes së konsumatorëve.

Këtu do të përmendim pjesëmarrjen në aktivitetet e Shoqatën e Mbrojtjes së Konsumatorit, Zyrës për Mbrojtjen e Konsumatorit (ZMK) në Tiranë dhe vendosjen e marrëdhënieve institucionale me Konfindustrian, duke marrë pjesë në mënyrë aktive në Forumet dhe takimet e organizuara prej tyre.

7.3 Komunikime me Pjesëtarët e Tregut

ERE ka fuqizuar bashkëbisedimin me pjesëtarët e tregut në sektorin e energjisë elektrike, duke organizuar takime periodike me Kompanitë Publike KESH, OST, CEZ Shpërndarje. Do të përmendim këtu edhe të licensuarit për prodhimin e energjisë nga HEC-et e vegjël, të rinj dhe ata ekzistues, me Shoqatën e Tregtarëve të Energjisë, etj. Në këto takime informohen dhe diskutohet me pjesëtarët e tregut lidhur me kuadrin rregullator të miratuar nga ERE si për problematikën që ata ndeshin gjatë operimit në treg.

Gjithashtu një rëndësi të veçantë i është kushtuar shpërndarjes së materialeve me karakter informues dhe komunikimeve të ndryshme tematike me investitorët dhe persona të interesuar kryesisht mbi kuadrin rregullator lidhur me burimet e rinovueshme, të efikasitetit dhe kursimit të energjisë.

7.4 Komunikime në Web

Si një nga aktivitetet më strategjike për të zhvilluar një aksion efikas në drejtim të informimit të publikut, është zhvilluar komunikimi nëpërmjet faqes së Web-it. Kjo veprimtari konsiston si në përditësimin dhe zgjerimin e përmbajtjes së kësaj faqeje, ashtu edhe nëpërmjet propozimit të shërbimeve të reja. Web site i ERE-s, është pasuruar me materiale të reja, si kuadri rregullator i miratuar, vendimet e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, publikime dhe konsultime për publikun. etj.

Ky fakt konstatohet edhe me rritjen e korrespondencës që ERE trajton online, ashtu dhe me përgjigjen e pyetjeve dhe kërkesave të shumta të konsumatorëve që vijnë në këtë drejtim.

7.5 Marrëdhëniet me Median e Shkruar dhe Vizive

Për sa i takon aktivitetit me median e shkruar dhe vizive, përveç rritjes së raporteve të komunikimit, gjatë kësaj periudhe është konsoliduar dialogu me median nëpërmjet pjesëmarrjes në emisione të ndryshme televizive me audience të lartë, realizimit të intervistave të shumta televizive, ndërhyrjeve në publik për shpjegimin e qëndrimeve të ERE-s lidhur me çështje të ndryshme të ndjeshme për publikun, realizimi i deklaratave të shpeshta për shtyp, ashtu edhe duke organizuar takime dhe mbajtur kontakte të veçanta me media e gazetarë që mbulojnë këtë sektor.

Kontakte të shpeshta me median janë realizuar gjatë gjithë periudhës së miratimit dhe më pas, të Kontratës së Furnizimit me Energji Elektrike për Konsumatorët Familjare dhe Jo-Familjare dhe Rregullores së Standardeve Minimale të Cilësisë së Shërbimit të Shpërndarjes dhe Furnizimit me Energji Elektrike.

ERE gjithashtu prej 3 vjetësh ka marrëdhënie institucionale me ATSH, ku kryen një shkëmbim të rëndësishëm të informacionit me këtë agjensi prestigjioze lajmesh.

Kapitulli V

Marrëdhëniet Ndërinstitucionale dhe Ndërkombëtare të ERE-s

1. Veprimtaria Ndërinstitucionale dhe Ndërkombëtare e ERE-s

Për vitin 2011, zhvillimi i marrëdhënieve ndërinstitucionale brenda vendit dhe marrëdhëniet ndërkombëtare multilaterale dhe bilaterale kanë zënë një vend të veçantë në veprimtarinë e ERE-s. Në zhvillimin e marrëdhënieve ndërinstitucionale mund të përmendim marrëdhëniet me Kuvendin e Shqipërisë, Ministrinë e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjistikës (METE), Ministrinë e Integritit, Autoritetin e Konkurrencës, Avokatin e Popullit, si dhe institucione të tjera në vend.

2. Marrëdhëniet e ERE-s me Kuvendin e Shqipërisë

Gjatë vitit 2011 ERE ka konsoliduar akoma më shumë marrëdhëniet me Kuvendin e Shqipërisë, në veçanti me Komisionin e Veprimtarive Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit.

ERE gjatë vitit 2011 ka vazhduar të ndjekë një formë bashkëpunimi dhe informimi periodik duke pasqyruar hap pas hapi veprimtarinë institucionale në zbatim të vendimit të Byrosë së Kuvendit Nr. 29 datë 09.02.2008 “Për ngritjen e Shërbimit të Monitorimit të institucioneve që raportojnë dhe informojnë Kuvendin”. Në këtë kuadër Këshilltarja e Kuvendit përgjegjëse për kryerjen e këtij shërbimi ka ndjekur nga afër dhe është njohur në mënyrë të hollësishme me veprimtarinë e ERE-s, si dhe ka asistuar në mbledhjet e Bordit të Komisionerëve.

ERE e ka informuar Kuvendin mbi zhvillimet korente në sektorin e energjisë, ku përveç paraqitjes në Kuvend të Raportit Vjetor, ERE ka paraqitur çdo muaj informacion mbi veprimtarinë e ERE-s, si dhe në drejtim të çështjeve të mprehta që kanë të bëjnë me Tregun e Energjisë, me hartimin e akteve nënligjore, me procesin e post-privatizimit si dhe për çmimet dhe tarifatat e energjisë elektrike.

3. Marrëdhëniet e ERE-s me METE-n

ERE ka bashkëpunuar me METE-n gjatë vitit 2011 përsa i përket zgjidhjes së çështjeve dhe sfidave të ndeshura në procesin e rregullimit të sektorit të energjisë në Shqipëri duke marrë shkas edhe nga ndryshimet e ndodhura në fund të vitit 2010 në ligjin për sektorin e energjisë elektrike. Po ashtu ERE ka kërkuar mbështetjen e METE-s edhe në kuadër të propozimit të ERE-s për ndryshimin e nenit 64 të Ligjit nr. 9072 datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, pasi në mungesë të iniciativës ligjore na ERE-s për të propozuar ndryshime kemi kërkuar dhe kemi gjetur prej METE-s mbështetje për të finalizuar propozimin e ERE-s për ndryshimin në ligj të nenit të sipërcituar. Të vazhdueshme kanë qënë gjatë gjithë vitit 2011, komunikimet me METE edhe në kuadër të trajtimit të problematikave me të cilat është përballur sektori i energjisë elektrike, të tilla si për çështjet e tregut të kapaciteteve të interkonjeksionit, dhe raportimit përkatës në Sekretariatën e Vjenës për çështjen e hapur prej tyre ndaj vendit tonë. Po ashtu gjatë gjithë vitit 2011 ERE ka mbajtur komunikim të vazhdueshëm me METE-n lidhur me mosmarrëveshjet e operatorëve të tregut në mënyrë të veçantë për marrëdhëniet midis KESH sh.a dhe CEZ Shpërndarje sh.a kryesisht për çështjet e mospagesave dhe sasisë së importit të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve nga CEZ Shpërndarje sh.a. ERE ka luajtur një rol të rëndësishëm për minimizimin e borxheve të ndërsjellta mes këtyre kompanive.

Në marrëdhëniet me METE-n, ERE ka kontribuar qoftë përmes propozimeve të dala prej saj apo përmes dhënies së opinionit për ndryshime e propozuara, qoftë dhe nëpërmjet pjesëmarrjes aktive të Grupeve ndërinstitucionale të Punës për rishikimin e Ligjit për Sektorin e Energjisë Elektrike, të Projekt- Ligjit të Energjive të Rinovueshme, ka marrë pjesë edhe në çështje të tjera që kanë të bëjnë me tregun e energjisë elektrike dhe gazit, me të licencuarit dhe me të gjitha palët e pjesëmarrëse në sektorin e energjisë në Shqipëri. Në fushën e gazit natyror më së shumti këto marrëdhënie janë fokusuar në drejtim të bashkëpunimit mbi trajtimin e projektit të gazjellësit TAP.

Në kuadrin e ngritjes dhe funksionimit të regjistrit elektronik të bizneseve ERE ka marrë pjesë në workshopet e organizuara nga METE si dhe ka dhënë kontributin e saj nëpërmjet hedhjes në këtë regjistër të akteve që ERE miraton. ERE ka qënë

anëtare e rregullt e Grupit të punës të ngritur nga METE për Plotësimin e Pyetësorit të BE-së Kapitulli mbi Energjinë.

4. Marrëdhëniet e ERE-s me Ministrinë e Integritit

Për vitin 2011 ERE ka komunikuar dhe bashkëpunuar me Ministrinë e Integritit në drejtim të përditësimit me informacion të Planit kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit për periudhën 2010-2014. Në këtë kuadër ERE ka rishikuar aktet e parashikuara në PKZMSA dhe ka dhënë kontributin e saj në drejtim të plotësimit të kërkesave që vijnë nga Direktivat e BE-së. Konkretisht në përputhje dhe në plotësim të Direktivës 54/2003, në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjisë.

5. Marrëdhëniet e ERE-s me Autoritetin e Konkurrencës

Në vijim të marrëdhënieve të ERE-s me Autoritetin e Konkurrencës bazuar në marrëdhënien e Institucionalizuar mes këtyre dy institucioneve në kuadër të Memorandumit të Mirëkuptimit të nënshkruar mes ERE-s dhe Autoritetit të Konkurrencës që prej datës 17.01.2007, gjatë vitit 2011 është bashkëpunuar për shmangien e shkeljes së konkurrencës nga operatorët, duke krijuar rregulla konkurruese në mbrojtje të interesave të konsumatoreve. ERE ka kërkuar rregullisht mendimin e Autoritetit për aktet nënligjore që lidhen me zhvillimin e tregut të energjisë përpara së të miratohen nga ERE, në procesin e llogaritjes së tarifave dhe çmimeve të energjisë elektrike, në përcaktimin e analizës së rishikimit të nivelit të humbjeve etj. ERE ka marrë pjesë në seancat që ka zhvilluar Autoriteti i Konkurrencës në kuadër të hetimeve dhe investigimeve për sektorin e energjisë elektrike duke shprehur qëndrimin e saj dhe duke sqaruar çështjet e këtij tregu si dhe marrëdhëniet kontraktuale. Po kështu ERE i ka dërguar të gjitha aktet e saj nënligjore

Autoritetit të Konkurrencës për dhënie mendimi përpara miratimit të tyre. Si dhe ka ndjekur workshopet e organizuara nga ky institucion mbi analizat statistikore. Komunikimi, shkëmbimi i informacionit dhe të dhënave ndërmjet të dy institucioneve do të vijojnë dhe në të ardhmen bazuar në një vullnet e gatishmëri të ndërsjelle.

6. Marrëdhëniet e ERE-s me Avokatin e Popullit

Këto dy institucione kanë një angazhim të ndërsjelle institucional që është mbrojtja e konsumatorëve të energjisë elektrike.

Në këtë kuadër, ERE ka mbajtur marrëdhënie të afërta institucionale me Avokatin e Popullit duke kryer dhe takime të përbashkëta në drejtim të shkëmbimit të mendimeve dhe dhënies së sqarimeve të nevojshme për cilësinë e shërbimeve të furnizimit me energji elektrike të konsumatoreve, për procesin e vendosjes së tarifave dhe çmimeve të energjisë elektrike për vitin 2011, si dhe për kontratat e furnizimit me energji elektrike të konsumatoreve. Institucioni i Avokatis të Popullit do të përfshihet gjithnjë në të gjitha procedurat dhe seancat dëgjimore që do të zhvillohen veçanërisht për tarifën e energjisë elektrike dhe kontratat e furnizimit me energji elektrike të konsumatoreve.

7. Marrëdhëniet Ndërkombëtare

Në kuadër të angazhimeve të ERE –s në planin ndërkombëtar në fokus të veprimtarisë së saj për vitin 2011 ka qënë:

- forcimi institucional,
- rritja e njohurive dhe eksperiencës së stafit të saj,
- përfaqësimi i vendit në aktivitete rajonale dhe ndërkombëtare,
- përputhja dhe harmonizimi i kuadrit ligjor dhe praktikave në ndjekje të modeleve të vendeve të BE-së, si dhe në vlerësimin e vendosjes e bashkëpunimeve të frytshme në dobi të sektorit të energjisë në vend.

ERE i ka kushtuar një rendësi të veçante mbajtjes së marrëdhënieve, bashkëpunimit, marrjes së asistencës nga organizmat ndërkombëtare si USAID, Banka Botërore, IFC, BERZH, KFW etj.

Bazuar në një memorandum mirëkuptimi mes ERE-s dhe USAID edhe gjatë këtij vitit është asistuar Rregullatori me Konsulencë në shumë drejtime ku vlen të përmendim ekspertët për çështjet e tarifave, të tregut, të mbrojtjes së konsumatorëve, te gazit natyror etj. Gjithashtu ERE ka kërkuar asistencë dhe nga organizmat e tjerë ndërkombëtare duke paraqitur kërkesa konkrete në këtë drejtim që priten të konkretizohen gjatë vitit të ardhshëm.

Gjatë vitit 2011 ERE ka marre pjese ne Forumet energjisë dhe të gazit natyror në cilësinë e vëzhguesi, aktivitete këto të zhvilluara nga BE dhe organizmat e saj, siç është dhe ACER (Agjencia për Bashkëpunim e Rregullatorëve të BE-së), CEER (Këshilli i Rregullatorëve të Evropës etj, me qëllim marrjen e informacionit dhe qënien sa më afër kërkesave të BE-së. Duke patur ne konsiderate këto qëllime, ERE ka vazhduar marrëdhëniet multilaterale me organizata ndërkombëtare si IERN (Rrjeti Botëror i Rregullatorëve të Energjisë), ERRA, MEDREG, NARUC, Sekretariati i Vjenës, Shkolla e Rregullimit e Firences etj. si dhe ka vendosur marrëdhënie bilaterale me institucione të tjera Rregullatore si motra, si dhe ka marrë pjesë në konferenca dhe aktivitete ndërkombëtare lidhur me energjinë elektrike dhe gazin natyror.

8. Aplikimi i ERE-s në Projektin IPA:

Me qëllim forcimin e kapaciteteve institucionale të rregullatorit në fushën e tarifave dhe çmimeve, licencimit dhe monitorimit të të licensuarve dhe të tregut të energjisë, hartimit të legjislacionit të duhur, ERE në gjysmën e dytë të vitit 2011, në bashkëpunim dhe me Entin Rregullator të Italisë dhe Malit të Zi ka aplikuar për projektin IPA -CBC Adriatik- qe është pra një projekt ndërkufitar mes këtyre tre vendeve të Adriatikut për një periudhë tre-vjeçare (2012-2015) me fonde të BE-së në vlerën 2.113.870 Euro. Projekti ka për synim forcimin e institucioneve Rregullatore vendeve duke ofruar mjetet e duhura rregullatore për implementimin e paketës së dytë dhe të tretë për energjinë dhe rritjen e kapaciteteve gjenerues në drejtim të modeleve të suksesshme për zhvillimin e Burimeve të Rinovueshme.

9. Marrëdhëniet Multilaterale te ERE-s:

ERE si anëtare me te drejta te plota ne Shoqatën e Enteve Rregullatore të Vendeve të Europës Juglindore dhe Euro Azisë (ERRA) merr pjesë në takimet e Asamblesë së Përgjithshme të Kryetarëve të ERRA-s, takimet e dy Komiteteve të përhershme të ERRA-s, atij të Liçensimit e Monitorimit dhe atij të Tarifave e Çmimeve, si dhe të Grupit të Punës mbi çështjet ligjore që zhvillohet në vendet anëtare të ERRA-s. ERE gjithashtu ndjek dhe trajnimet e organizuara nga ERRA, të cilat gjatë vitit 2011 kanë konsistuar në trajnimin për tregjet e energjisë dhe tarifrat, në trajnimin e stafin e ri të rregullatorëve.

ERE si anëtare e Shoqatës së Rregullatorëve të vendeve të Mesdheut për energjinë elektrike ka pjesëmarrje aktive në takimet e grupeve të punës për Energjitë e Rinovueshme dhe çështjet e gazit, si dhe takimet e Asamblesë së Përgjithshme të saj. Kjo është një mundësi e vlefshme në drejtim të njohjes së mundësive dhe potencialeve energjetike të Vendeve të Mesdheut dhe vendosjes së një klime mirëkuptimi dhe bashkëpunimi të rregullatorëve të këtyre vendeve për çështje të interesit të ndërsjelle të tyre.

ERE në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjisë gjatë vitit 2011 ka marrë pjesë aktive në Forumet e Athinës dhe aktivitetet e Komunitetit të Energjisë të organizuara nga Sekretariati i Vjenës. Ka bashkëpunuar së afërmi me këtë Sekretariat duke ndjekur takimet e rregullta të Grupeve të Punës për çështjet e konsumatoreve, të energjisë dhe tregut rajonal të energjisë, si dhe gazit natyror.

Gjithashtu ERE ka marre pjesë dhe në trajnimet dhe workshopet e organizuara nga ky Sekretariat për cilësinë e shërbimit, paketën e tretë legislative dhe modelet e tregut të energjisë dhe gazit natyror. ERE ka zhvilluar takime të veçanta në Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë në drejtim të përafrimit të legjislacionit sekondar në përputhje me Traktatin e Komunitetit të Energjisë dhe Direktivave të BE-së.

Duke përfituar nga këto aktivitete dhe eksperiencia e rregullatorëve më të përparuar evropiane synohet harmonizimi i legjislacionin, praktikat dhe procedurat me qellim krijimin e një tregu rajonal të energjisë, transparent, konkurrues, jo diskriminues dhe me akses të barabartë për të gjithë pjesëmarrësit.

10. Marrëdhëniet Bilaterale te ERE-s

Marrëdhëniet bilaterale te ERE-s për vitin 2011 kanë synuar forcimin e kapaciteteve institucionale dhe vendosjen e bashkëpunimeve të frytshme në dobi të sektorit të energjisë në vend. Në këtë kuadër ERE ka punuar në drejtim të bashkëpunimit bilateral bazuar në marrëveshjeve bilaterale, ku mund të përmendim atë të nënshkruar me Entin Rregullator Italian, me të cilin janë kryer gjatë vitit dy workshopet të ndërsjellta me qëllim shkëmbimin e eksperiencës për tarifën, legjislacionin dhe çështjet e tregut.

Janë vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me Rregullatorin e Austrisë si dhe janë zhvilluar dy takime në drejtim të shkëmbimit të eksperiencës dhe praktikave rregullatore me këtë institucion.

Është zhvilluar gjithashtu për çështjet e post-privatizimit dhe një workshop me Rregullatorin e Bullgarisë, si dhe janë mbajtur marrëdhënie të afërta dhe korrespondence me Rregullatorët e Maqedonisë, Malit të Zi, Kosovës etj.

Gjithashtu është punuar dhe janë vendosur kontaktet e para me Rregullatore të tjerë siç mund të përmendim Rregullatorin e Kanadasë, Francës, Gjermanisë etj dhe priten që këto marrëdhënie të konkretizohen në vitin në vijim.

11. Pjesëmarrja në Konferenca dhe Aktivitete Ndërkombëtare

Përsa i përket pjesëmarrjes së ERE-s në konferenca dhe aktivitete ndërkombëtare, gjatë vitit 2011 i dukshëm ka qënë interesi i ERE-s për tu njohur me eksperiencat energjitike evropiane dhe me gjerë në shkallë botërore nëpërmjet pjesëmarrjes së saj në aktivitete ndërkombëtare ku mund të përmendim Forumet Evropiane për Energjinë dhe Gazin, Konferencat Evropiane dhe të Evropës Juglindore për Energjitë të Rinovueshme, Konferencën e Investimeve për energji në vendet e Evropës Juglindore, Forumin e CransMontanës, Forumin e Mesdheut për Energjinë, Konferencat për tregjet Evropiane dhe Konferencat e organizuara për çështjet e gazit në vendet e rajonit, si dhe në workshopet e organizuara mbi rolin e rregullatorëve në çështjet e energjive të Rinovueshme, efikasitetit të energjisë dhe sigurisë së furnizimit.

Kapitulli VI

Administrimi i Burimeve Financiare dhe Burimeve Njerëzore të ERE-s

Edhe për vitin 2011 persë i takon fushës së Burimeve Njerëzore është zbatuar me përpikmëri Ligji nr. 9367 date 07.04.2005” Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” dhe Ligjit nr. 9049, date 10.04.2003” Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik”.

Janë plotësuar deklaratat e interesave private periodike/vjetore nga të 9 zyrtaret (që janë subjekt i këtij detyrimi), sipas afateve kohore të parashikuara nga ligji.

Gjithashtu kemi marrë pjesë rregullisht në trajnimet e organizuar nga ILDKP.

Në muajin shkurt u krye një kontroll nga inspektoret e ILDKP, nga ana e të cilëve nuk u konstatua asnjë shkelje ligjore.

